



Universiteti i Tiranës
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja
Departamenti i Gjuhës Angleze



KONFERENCA E 13-të NDËRKOMBËTARE

KËRKIMI SHKENCOR DHE QASJET E REJA NË
GJUHËSI, MËSIMDHËNIE, PËRKTHIM DHE
KULTURË



në kuadër të projektit
“Përmirësimi i kërkimit shkencor me kërkuesit
e rinj të Departamentit të Gjuhës Angleze”

Tiranë, 24 nëntor 2023



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



KONFERENCË SHKENCORE NDËRKOMBËTARE
“KËRKIMI SHKENCOR DHE QASJET E REJA NË
GJUHËSI, MËSIMDHËNIE, PËRKTHIM DHE KULTURË”

PËRMIRËSIMI I KËRKIMIT SHKENCOR ME KËRKUESIT E RINJ TË
DEPARTAMENTIT TË GJUHËS ANGLEZE

Key Note Speakers:

Prof. Nick Ceramella

Combining Analysis of Literary Travel Writing and Digital Photography
Focus on D. H Lawrence's *Sea and Sardinia*

Prof. Henrik Gottlieb

Building and exploring the Global Anglicism Database corpus (GLAD)

Në kuadër të Projektit “Përmirësimi i kërkimit shkencor me kërkuesit e rinj të Departamentit të Gjuhës Angleze”, me në fokus të tij kërkimin shkencor në mbështetje të kërkuesve të rinj jo vetëm të Departamentit të Gjuhës Angleze por edhe të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, do të organizohet Konferenca Shkencore Ndërkombëtare, e cila synon të sjellë risi dhe qasjet më të fundit të kërkimit në disipinat e ndryshme gjuhësore.

Ftojme studiuesit, akademikët dhe kërkuesit e rinj të disiplinave të ndryshme gjuhësore apo studimeve ndërdisiplinore, të kontribuojnë në këtë konferencë nëpërmjet punimeve të tyre origjinale. Në këtë konferencë do të zhvillohen diskutime dhe praktikat më të mira, reflektimet dhe përvojat do të bëhen pjesë e aktit të botimeve, i cili do të kontribuojë në literaturën kombëtare dhe ndërkombëtare.

Gjuhët e konferencës: Anglisht / Shqip

Adresa e emailit: konferenca.anglisht@unitir.edu.al

Data të rëndësishme:

Afati për dërgimin e abstraktit: 29 Shtator

Njoftimi për pranimin e abstraktit: 9 Tetor

Afati për dërgimin e punimit të plotë: 1 Nëntor

Grupi drejtues i Projektit: Prof. Dr. Viktor Ristani (Drejtues i projektit)

Prof. Dr. Elida Tabaku (anëtare)

Prof. Asoc. Etleva Kondi (anëtare)

PËRMIRËSIMI I KËRKIMIT ME KËRKUESIT E RINJ TË
DEPARTAMENTIT TË Gjuhës Angleze

Dr. Daniela Hasa (anëtare)

Dr. Leonora Lumezi (anëtare)

Dr. Hatixhe Sejdini (anëtare)

Komiteti shkencor:

Prof. Dr. Viktor Ristani

Prof. Dr. Elida Tabaku

Prof. Dr. Daniela Tamo

Prof. Dr. Ukë Zenel Buçpapaj

Prof. Asoc. Etleva Kondi

Prof. Asoc. Irena Pata

Prof. Asoc. Iris Klosi

Prof. Asoc. Loran Gami

Prof. Asoc. Daniela Hasa

Prof. Asoc. Rovenà Vora

Prof. Asoc. Ogerta Koruti

Dr. Leonora Lumezi

Dr. Rudina Xhillari

Dr. Hatixhe Sejdini

Dr. Albert Sheqi

Dr. Manjola Naso

Dr. Rudina Vrioni

Dr. Albana Shijaku

Dr. Elvana Shtepani

Dr. Vjola Shaba

Dr. Fatma Shijaku

Dr. Vjollca Tabaku

Komiteti organizativ:

Msc. Brunilda Kondi

Msc. Blerina Zaimi

Msc. Anxhela Bardhy

ISBN: 978-9928-279-91-0

Përmbajtja

Prof. Asoc. Dr. Rovena Vora “Elemente etno-kulturore, të historisë dhe të mendësisë popullore tek njësitë frazeologjike foljore në shqipe dhe në anglishte”.....	6
Dr. Violeta Shaba “Exploring idioms of comparison in English and Albanian - A journey into some cultural information stored in them”.....	12
Prof. Asoc. Dr. Irena Kapo (Pata) “A View on the Albanian Anglicisms of the First Half of the 20 th Century”.....	21
MSc. Ejona Demneri (Blakçori) “Përdorimi i Konektorëve në Tekstin Argumentues në Gjuhën Angleze”.....	28
Prof. Asoc. Dr. Daniela Hasa “An overview of the use of corpora for research and teaching purposes”.....	35
Dr. Rudina Xhillari, Prof. Dr. Daniela Tamo “Problem-Solving while translating from English into Albanian ‘Contribution to the Sociology of Language’ By Janet Byron”.....	42
Dr. Albert Sheqi, Prof. Dr. Viktor Ristani “Literary challenges in the translation of original metaphors: from Ismail Kadare’s ‘Ura me tri harqe’ into John Hodgson’s The Three-Arched Bridge”.....	48
Dr. Orges Selmani “Culture-bumps and a translation case of culture-related structures in free’s versions by Lea Ypi”.....	56
MSc. Vezire Krasniqi, Prof. Dr. Brikena Kadzadej “Letra, veçoritë e saj dhe përkthimi gjermanisht-shqip”.....	62
MSc. Sonila Alla, Prof. Dr. Viktor Ristani “Analytical approaches and methods to tackle and resolve translation-related problems in Emily Brontë’s novel ‘Wuthering Heights’, translated into Albanian by the renowned translator Amik Kasoruh”.....	68
Dr. Kristina Ajazi “Polisemia si problem leksikor gjatë procesit të përkthimit”.....	74
Dr. Lueta Liçi “Modele të sigurimit të cilësisë së përkthimit të instrumenteve të vlerësimit të PISA-s dhe TIMSS-it”.....	81
LL.M. Majlinda Sommer “Sfidat që dalin gjatë përkthimit të dokumentave ligjore nga gjermanishtja në shqip”.....	88
Dr. Alketa Pema (Thanasko), Prof. Asoc. Dr. Marsela Harizaj “Të përkthyerit e Uitman përmes një skeme destruktive”.....	94
MSc. Anna Maria Vasili “Përkthimi nga një këndvështrim kulturor”.....	101
Prof. Asoc. Dr. Etleva Kondi (Koni) “The impact of personality traits on EFL learning”.....	107

Michael R. Decker “Measuring the Impact of Mandatory Teacher Professional Development: A Case Study in East Africa”.....	114
Dr. Sidita Dano (Hoxhiq), Dr. Florinda Boriçi “Importance of teaching setting through the short stories of Kate Chopin for first year students in Introduction to Literature course”.....	122
Dr. Vjollca Hoxha (Tabaku) “Teacher talk in classroom interaction”.....	128
Dr. Ervin Hoxhaj “The Role of ESP in Preparing Doctors for International Medical Practice”.....	133
Kleada Agasi “Mësimdhënia gjithëpërfshirëse dhe mirëqënia e mësuesve që e përzgjedhin atë si metodë në shkollat shqiptare”.....	140
MSc. Giovanna Meçe “The Use of the Interactive Game Minecraft Adventures as a Digital Teaching Tool for Online EFL Classrooms”.....	146
MSc. Gentiana Beqiri (Bidollari) “Fostering a Genuine Affection for essay writing among students”.....	152
MSc. Ksenja Ferro “Translation as a Solution to Linguistic Interference in English Language Teaching”.....	158
MSc. Silva Hasalami “The incorporation of idioms in EFL classes”.....	165
Dr. Miranda Ostrosi, Dr. Elvana Shtepani “Elements of language used for communicating messages in PR and Advertising”.....	172
Assoc. Prof. Shailja Vasudeva, Sanju. S, Cijo Christoher. J “Significant Principles of Cultural Society in India”.....	177
MSc. Klodjana Skëndaj “Cultural and Language Awareness While Teaching English to non-Native Albanians”.....	182
Daniele Marzeddu “Making Pictures to Illustrate Sea and Sardinia Films of Sicily and Sardinia”.....	190
Dr. Albert Sheqi “Alice Walker’s The Color Purple – surviving and thriving in the toxic climate of sexual abuse and domestic violence”.....	198
MSc. Blerina Zaimi “Ëndrrat dhe realitetet e emigrimit në romanin Dritë e zbehtë mbi kodra të Kazuo Ishiguros”.....	205
Dr. Rozana Bela “Comparative translation from English into Albanian of Episode 10, Wandering Rocks, in Ulysses by James Joyce”.....	211
Dr. Kristina Sheperi “Roli i nënës në dramën e Juxhin O. Nillit dhe Trejsi Letsit”.....	219
MSc. Enkelejda Malaj “Feministic and Socialistic Themes in Thomas Hardy’s ‘Jude the Obscure’”.....	226

Prof. Asoc. Dr. Rovena Vora
Universiteti i Tiranës
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja
Departamenti i Gjuhës Angleze
rovena.vora@unitir.edu.al

Titulli: Elemente etno-kulturore, të historisë dhe të mendësisë popullore tek njësitë frazeologjike foljore në shqipe dhe në anglishte

Abstrakt

Kombinimet e fjalëve me të cilat njësitë frazeologjike hyjnë në përdorim, në radhë të parë zhvillohen dhe ndryshohen sipas sistemit të një gjuhe duke mishëruar veçantitë e saj. Si çdo njësi tjetër gjuhësore, edhe njësitë frazeologjike kanë rregullsitë e tyre dhe krijojnë gjedhe kuptimore e strukturore në përputhje me ligjet e sistemit gjuhësor. Megjithatë, për të kuptuar më mirë vlerat shënuese dhe shprehëse të njërive frazeologjike duhet të kuptojmë ndikimin që kanë kushtet jashtëgjuhësore si kultura, historia e një populli, kushtet e jetesës dhe mënyra e të menduarit në krijimin dhe përdorimin e tyre. Duke qenë se njësitë frazeologjike lidhen ngushtë me kulturën, ngjyrimi emocional është një mjet i përshtatshëm për të bërë lidhjen midis elementeve gjuhësore dhe jashtëgjuhësore. Për të ilustruar çështjet e trajtuara ne jemi mbështetur në korpusin e mbledhur për këtë qëllim me shembuj të shumtë nga vepra letrare në shqipe dhe në anglishte.

Fjalët kyçe: njësi frazeologjike, kulturë, elemente gjuhësore, elemente jashtëgjuhësore

Faktorët jashtëgjuhësorë ndikojnë në zhvillimin e dukurive të reja gjuhësore, ndryshimin e tipareve të njërive gjuhësore dhe pasurimin e tyre me elemente të reja. Ndërthurja e mjeteve gjuhësore me elemente që lidhen me etnografinë dhe kulturën e një populli pasqyrohet në shumë njësi gjuhësore, përfshirë edhe ato frazeologjike, të cilat më vonë hyjnë gjerësisht në ligjërim pasi i janë nënshtruar rregullave të sistemit të gjuhës. Gjuha, si produkt i një bashkësie, pasqyron veçantitë e saj që lidhen me zakone të ndryshme të individëve që mund të lidhen me ushqyerjen, me mënyrën e festimeve, me luftimin, me urimet në ndodhi të ndryshme etj.

Kështu, njësia frazeologjike “*prenë fjalën*” përdoret në rastet e martesave me mblesëri, kur janë vetë familjet që vendosin ose caktojnë ditën e martesës. Duke qëndruar në të njëjtin kontekst, njësia “*kthej bukë*” lidhet me zakonet kur krushqit që sapo kanë nisur një miqësi të re shkojnë për darkë tek pala tjetër e krushqisë, pra, i kthejnë vizitën. Po kështu, për traditën fetare të kurbanit në festa të ndryshme fetare apo kur nisin themelet e një shtëpie të re përdoret njësia frazeologjike “*bëri gjak*”.

Nuk asht shtëpi në mal ose në fushë, muhamedane ose kristiane, që nuk ban gjak për Shënkoll. (Jani Thomai, Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe, fq. 373)

Fjala “*gjak*” lidhet gjithashtu me fenomenin e gjakmarrjes në disa zona ku njerëzit dikur kërkonin të vinin vetë drejtësi duke iu referuar të drejtës që i jepte ligji sipas Kanunit të Lekë Dukagjinit. Ky

fenomen, që i ka të thella rrënjët, vazhdon të mbizotërojë edhe në ditët e sotme e si rrjedhim, hasen shpesh njësi të tilla frazeologjike, si “hyj në gjak” dhe “marr gjak”:

Nurija futi dorën në gji e s’di ç’kërkoi atje. Shaminë për të fshirë dirsën e ballit? Jo. Sefedini e mori vesh se ç’kërkonte dora e së bijës së Nures, po nuk u tund nga vendi, nuk vuri dorën në brez ku mbante koburen të mbushur. E shikoi i pikëlluar, qërtonjës dhe i tha:

-Ne jemi në gjak, se qëmoti një nga të mitë u zu me një nga të tutë, për punën e një çupe që e donte edhe njëri edhe tjetri. Për këtë çupë është derdhur një lumë gjaku. Kështu më ka thënë stërgjyshja kur isha i vogël.

-Ka qenë si ka thënë, unë s’dua të di. Sot dera jonë ka për të marrë gjak nga dera juaj. Do t’ju shuajmë fare, do t’ju fshijmë nga faqja e dheut.

Sa ashpër fliste e bija e Nures!

-Doni gjak, thua? Doni të na shuani fare? Përse?

-Përse e përse, ja nga koha që ka re – ja theu çupa me të qesëndisur. (Mitrush Kuteli, Tregime të zgjedhura, fq. 75)

Fryma popullore e njësive frazeologjike ndjehet në togje karakteristike të një gjuhe në të cilat shfaqen jo vetëm veçoritë e gjuhës por edhe dukuritë shoqërore kulturore. Një frymë e tillë është e theksuar tek fenomeni i besës në shoqërinë shqiptare që e dallon nga çdo shoqëri tjetër dhe që bën të pamundur gjetjen e një paraleleje në një gjuhë tjetër, qoftë edhe ballkanike:

I dhamë besën se nuk do ta prishnim po të na rrëfente vendin e haznës. I thamë se ç’të gjenim do t’i ndanim më tresh. Atij i ardhi zemra në vend: kish qenë si mish i ngordhur e zuri të bëhej gjallë si engjervia. Shkuam të tre ne Guri i prerë. Aty na rrëfeu një të gdhendur, si gjarpër, me bishtin si shigjetë drejt tumbës ku kish ngulur hurin. Aty kish edhe ca të shkruara, nën myshk. (Mitrush Kuteli, Tregime të zgjedhura, fq. 110)

Natyrisht që për të mësuar më shumë rreth origjinës së njësive frazeologjike, historive apo ngjarjeve që lidhen me krijimin e tyre është i nevojshëm një studim diakronik i kushteve në të cilat lindën këto njësi frazeologjike. Studimi diakronik i të dhënave historike – shoqërore të njësive frazeologjike shoqëruar me vëzhgime gjuhësore nxjerrin në pah jo vetëm mënyrën e formimit të njësive frazeologjike, kuptimin e tyre të motivuar, shtratin dialektor por edhe ndryshimet që kanë pësuar ato ndër vite apo shekuj. Njësitë frazeologjike dëshmojnë që në shkrimet e hershme në shqipe. Në shqipen e shkruar janë gjurmuar që tek “Meshari” i Gjon Buzukut: - *běj be* (betohem) i *běj gropën* (e zhduk); i *vjen ndoresh* (e bën mirë, me lehtësi e shkathtësi diçka).

Disa prej tyre përdoren edhe në shqipen e sotme me të njëjtën trajtë:

Po të mos dojë të vijë, bėj be për atë dhe, për atë gur e për atë bukë se ndonjë ditë do të më mbushet mendja, do të marr dyfeknë e do të zhavuloj në Vllahi a në Vullakë, ku të jetë, do ta ze për veshi e do ta sjell në mulli. (Mitrush Kuteli, Tregime të zgjedhura, fq. 44)

Të ardhka ndorësh pikë, të dredhësh atë kamzhik për shpezë të butë, o Kallamatresh!... zuri të flasë Jani ngadalë e qetë, pa i vënë veshin fare lebetisë së fëmijës. (Jakov Xoxa, Lumi i vdekur, Vëll. II, fq. 41)

Një tjetër tregues jo vetëm i origjinës së hershme por edhe i ndikimit të kulturave të huaja tek njësitë frazeologjike të gjuhës shqipe janë ato që përmbajnë një fjalë turke në përbërje të tyre. Pushtimi osman ka lënë gjurmë jo vetëm në leksikun e shqipes në tërësi por edhe në togjet frazeologjike. Kjo vërehet tek ato njësi të cilat nuk janë të huazuara nga turqishtja si kalke por janë përshtatur sipas sistemit gjuhësor në shqipe. Megjithatë, shprehje të tilla përdoren në ligjërim si elemente dialektore në nivelin e normës letrare:

*Mirëseerdhët, mirëseerdhët, o bej e falemnderit që **bëtë kabull** të urdhëroni në dyqanin tim... dhe, duke i fshirë karriken e pastruar tavolinën, e ftoi të ulet e pastaj hapi krahët, sikur me këtë kërkonte të çfajësohej që nuk po e priste dot si ia donte radha.* (Jakov Xoxa, Lumi i vdekur, Vëll. III, fq. 37-38)

*Ç’ke që ngazëllehesh kështu, o Pilo, apo se vritemi ne **e bën sehër** ti, matanë gardhit? ... i foli Koz Dunjaja, që po bridhte për në shtëpi, me shkopin në dorë e nipin pas.* (Jakov Xoxa, Lumi i vdekur, Vëll. II, fq. 42)

E paç hallall, bir, Lirikën! Edhe qumështin që i kam dhënë dhe ta ka bërë kështu, të bardhë... Po ti e **bëre hallall** vetë, xhanëm. Veç unë ta **kisha bërë haram** ... Edhe nga unë hallall! (Jakov Xoxa, Juga e bardhë, Vëll. II, fq. 271)

Në anglishte, mund të japim si ilustrim mjaft shembuj të njësive frazeologjike që kanë një origjinë të hershme dhe kanë hyrë në leksikun e gjuhës angleze vite ose shekuj më parë. Mjaft njësi frazeologjike jo vetëm që i ka përdorur në veprat e tij por janë krijime të shkrimtarit të mirënjohur William Shakespeare. Sot, këto njësi kanë hyrë në përdorim të gjerë dhe përdoren edhe nga autorë të tjerë:

“wear one’s heart upon one’s sleeve for daws to peck at” me kuptimin – ‘shfaq hapur ndjenjat’. Njësia e ka origjinën nga Otello, ku Iago dialogon:

“... ‘tis not long after

But I will wear my heart upon my sleeve for daws to peck at. (Act I, Sc. 1)

*She is, in fact, a fair specimen of an English maiden – upright fearless, and wholesome looking. What more may be in her, her intimate friends alone know, for she is not a woman **to wear her heart upon her sleeve for daws to peck at.*** (James Main Dixson, English idioms, fq. 270)

“claim one’s pound of flesh” është një njësi që e ka origjinën nga vepra e Shekspirit “Tregtari i Venedikut” që përdoret për t’i kërkuar dikujt të paguajë borxhin qoftë edhe me shumë vuajtje:

*The Sultan’s view of Germany is that he ought to seek for the help of German officers and of German financial guides, on the ground that all the other great powers **want their pound of flesh** from Turkey.* (Fortnightly Review/James M. Dixson, English idioms, fq. 192)

“screw one’s courage to the sticking place” e ka origjinën nga vepra e Shekspirit “Makbethi” me kuptimin “veproj në mënyrën e duhur dhe me guxim”:

“But screw your courage to the sticking place, and we’ll not fail.” (Macbeth, act i. scene vii. Line 60)

He either did not fear him, or had screwed his courage to the sticking place. (James Main Dixson, English idioms, fq. 215)

Të tjera njësi datojnë në kohë të ndryshme në historinë e gjuhës angleze dhe ashtu si në shqipe edhe këtu kemi ndikime nga kultura të tjera apo ndodhi të ndryshme. Madje disa prej tyre kanë pësuar ndryshime të kuptimit të tyre gjatë viteve:

“lose face” (turpërohet) daton që në vitet 1800. Koncepti dhe shprehja idiomatike vijnë nga Azia. Të humbësh dinjitetin dhe vlerësimin e të tjerëve në Lindjen e Largët përbën një shqetësim të madh.

“to give something the thumbs up” (aprovon diçka) daton në anglishte në vitet 1600 ku i referohej gjestit që bënte turma në amfiteatrot romake. Në atë kohë kuptimi i kësaj shenje ishte ndryshe nga kuptimi që ka në ditët e sotme. Ajo kishte kuptimin e refuzimit dhe kuptimi që ka sot daton në shekullin e 19-të.

“to be at someone’s elbow” (i gjendet afër dikujt me qëllimin për ta ndihmuar) daton në shekullin e 16-të.

“to win/beat one’s hands down” (fiton me lehtësi, pa shumë mundim) e ka origjinën nga garat e kuajve që në mesin e shekullit të 19-të. Kur një kalorës është i sigurtë për fitoren ai e ul kamzhikun dhe nuk e mundon kalin të vrapojë shpejt, qetësohet dhe e lë kalin të shkojë drejt vijës së finishit.

“to eat out of one’s hand” (bindet me përlësi) ka bazë metaforike dhe lidhet me mënyrën se si një kafshë e zbutur ushqehet nga dora e dikujt. Përdoret që nga fillimi i shekullit të 20-të.

Në shqipe, mjaft njësi frazeologjike me vlerë foljore reflektojnë mendësinë popullore siç vërehet edhe në shembujt e mëposhtëm:

***Mos zer ngojë** atë tjetrin! ... briti sa e pati në kokë Llazi, e, duke rrokur me vrap bishtin e çomanges, u ngrit brof në këmbë dhe e rrotulloi nja dy herë mbi kokë me kanosje. (Jakov Xoxa, Lumi i vdekur, Vëll. II, fq. 23)*

*Meqë e kemi nusen tonë, mirë, pranoj. Po shiko t’i thuash, babam, të mos na **shesë mend** me ato rregullat agroteknike... dhe i kishte tundur gishtin me kërcënim, -Të punojë si pirganase, të hajë si çobankë dhe të heshtë si lopa. (Jakov Xoxa, Juga e bardhë, Vëll. I, fq. 163)*

*Të të them të drejtën, bijë, mua **më kishte ardhur shpirti në majë të hundës**. U ktheva e i thashë: “A thua se mbreti do të na i blerë qepët? Peqe, le t’i marrë, se janë të mira për jahni, me mish dashi të majmë. (Mitrush Kuteli, Vepra letrare 3, fq. 423)*

*Nuk do të shkosh për pazar, jo, po për një punë tjetër. Nesër mund të dalë në gjyq djali i kumbares, Adili, për shkak të atyre gurëve që ngrihi nga Pojani. Ti me Vitën do të shihni shahitë e **do bëni be e rrufe** që kosovari s’ka prishur muret a ç’drej tjetër ka atje lart, po që ka marrë, si gjithë bota, gurë nga arat. (Jakov Xoxa, Lumi i vdekur, Vëll. I, fq. 214)*

*Punën e Vitës e kishte të qartë, si në pëllëmbët, andaj dhe nuk iu desh shumë të vriste trutë: mbylle brenda dhe mbaroi, **sa t’i dalë fati**... Po do ti! ... sa kishte mbyllur punën e vajzës, ja t’i shpifej tani*

çështja e Llazit. Koz Dynjaja, fqinji i tij i dhëmbshur, i kishte thënë aty pakëz më parë të kishte mendjen te djali, që diç po luante me atë dyqanxhiun e Trokthit. (Jakov Xoxa, Lumi i vdekur, Vëll. III, fq. 26)

Shtëpia e Shpiragajve zinte, dikur, një stan të tërë në të hyrë të fshatit Grizë. Megjithëse ishte ngritur më të rrëzuar të një kodre, fshihej nga sytë e botës, si për të mos e **marrë njeri mësysh**, pas një gardhi të dëndur e të lartë kallamash. (Jakov Xoxa, Lumi i vdekur, Vëll. III, fq. 14)

Një grup njësisish të veçanta të formuara sipas sistemit gjuhësor të shqipes dhe sipas mënyrës shqiptare të të menduarit janë edhe njësitë frazeologjike në formën e urimeve dhe mallkimeve:

□ Urime:

S'na la të hanim kulaçin e grunjtë, po ama, m'u bëftë kurban, edhe atij helmi iu kthye buka ime, që ia shpura sot në mëngjes te konakët, tamam si çë mallkova me gjuhën e vogël "T'u ktheftë punë e zeher" e jo si urova "t'u bëftë gjak e dhjamë"... ((Jakov Xoxa, Lumi i vdekur, Vëll. III, fq. 120)

"Kur muer vesh gjyshi se isha kah nisesha për Myzekje, në një kuvend të madh mbi bujqësinë, se atij krahu bujqësia asht e përparueme fort, qiti e m'tha: "Hej si ndrruen vaktet?... Po e **paçin hallall**, se ndrruem për mirë e ma mirë... (Jakov Xoxa, Juga e bardhë, Vëll. II, fq. 192)

□ Mallkime:

Dembela! Përsiprapë me muhabet, juve? **Harram ju qoftë** buka që ju jap! Më turpëruat! Më bëtë të mos dal faqe bote. Më bëtë të mbytem në lumë. (Jakov Xoxa, Juga e bardhë, Vëll. I, fq. 346)

Tyt, **t'u thaftë gjuha!**... Të të qaj unë ty? Unë pres të heq valle, se më je bërë nuse, kaq më je rritur e zbukuruar këto ditë!... (Jakov Xoxa, Lumi i vdekur, Vëll. I, fq. 157)

A, **m'u bëfsh kurban!** Ma paske gjetur trimin këtëj! Dhe unë thoshja se kush ma paska rritur e veselitur time mbesë kështu! (Jakov Xoxa, Lumi i vdekur, Vëll. I, fq. 159)

Mallkim! Fije filizi të ri arhondësh mos mbiftë mbi trung të lashtë! Dhe ai që e krasit, **thyeftë qafën** andej dhe gërshëra iu ngultë në zemër! (Jakov Xoxa, Lulja e kripës së butë, fq. 260)

-Ti pusho, t'kam rixha, se të nxora dhe ty përjashta, se dhe ti jabanxheshë nga Murizaj je!

-U, **më marsh të keqen e m'u bëfsh kurban!**... Unë kam pagëzuar e u kam vënë kurorë djemve kështu! ... Unë kam kockat e vjehrrit e të vjehrrës, këtu, ky më thotë jabanxheshë? Tyt! (Jakov Xoxa, Lumi i vdekur, Vëll. II, fq. 113)

-Të tjerët, gra e burra, që siç duket ua kishte zënë veshi këtë ngjarje dhe e dinin se ku do të dilte Vala, nisën të qeshin që më parë.

-U **më të raftë një pikë**, moj delenxheshkë, që këndon kështu në sy të burrave!...

-Hë, se s'të dëgjon burri ty, se e ke larg... ahu... në botën tjetër! ... dhe shënoi gruaja nga varret. (Jakov Xoxa, Lumi i vdekur, Vëll. II, fq. 119)

Përfundime

Në këtë kumtesë vumë re se pjesa më e madhe e njësive frazeologjike e kanë burimin tek gjuha e popullit. Këto shprehje pasqyrojnë veçantitë e gjuhës së një vendi, psikologjinë dhe mendësinë e një

populli që do të thotë se nuk mund të përkthehen fjalë për fjalë në një gjuhë tjetër. Ndërtimi i këtyre njësive me sende e dukuri të jetës së përditshme, motivimi i tyre nga koncepte të ndryshme metaforike dhe gjithashtu mbështetja në krahasime me dukuri të ndryshme së bashku me ndërthurjen e tyre me elemente të veçanta të sistemit të një gjuhe, siç janë përdorimi i tyre në formën e dëshirore në urime apo mallkime me fjalë ose variante dialektore, sjellin krijime njësisht të veçanta mbartëse të një apo të disa elementeve së bashku.

Bibliografi

- Dixson, J. M. (1950): *English idioms*. London & Edinburgh: Thomas Nelson & Sons Ltd.
- Kuteli, M. (1964): *Vepra letrare 3/Novela*. Tiranë: Shtëpia botuese “Naim Frashëri”.
- Kuteli, M. (1972): *Tregime të zgjedhura*. Tiranë: Shtëpia botuese “Naim Frashëri”.
- Musaraj, Sh. (1979): *Para agimit*. Tiranë: Shtëpia botuese “Naim Frashëri”.
- Stefanllari, I. (1998): *Fjalor frazeologjik anglisht-shqip*. Tiranë: Botimet enciklopedike.
- Thomai, J. (1999): *Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe*. Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë: Shtëpia botuese “Shkenca”.
- Thomai, J. (1981): *Çështje të frazeologjisë së gjuhës shqipe*. Akademia e Shkencave të RPS të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë.
- Thomai, J. (2002): *Leksikologjia e gjuhës shqipe*. Shtëpia botuese e librit universitar, Tiranë.
- Xoxa, J. (1980): *Juga e bardhë. Vëllimi I*. Tiranë: Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”.

Dr. Violeta Shaba
Universiteti i Tiranës
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja
Departamenti i Gjuhës Angleze
violeta.shaba@unitir.edu.al

Title: Exploring idioms of comparison in English and Albanian - A journey into some cultural information stored in them

Abstract

This paper examines idioms of comparison in English and Albanian. In particular, it discusses the characteristics, types and patterns of such idioms, drawing a comparison between them in both languages. Motivation of such idioms is another issue addressed in this paper. They are generally motivated by their structure, but the relevant motivating link is not always provided by the speaker's knowledge of the semantic properties of a given syntactic structure. A cultural/conventional knowledge of some kind is also required to interpret the meanings of a good number of idioms belonging to this particular set of idiomatic expressions. Special attention is paid to the cultural information we can obtain from them, the "national spirit" reflected in them, namely the specific ways of conceptualizing or experiencing reality, which is characteristic of our two very different language communities in addition to similarities encountered.

Keywords: idioms of comparison, simile, pattern, motivation, culture

Introduction

As peculiar linguistic constructions, the expressions called *idioms* or *phraseological units* in Albanian have been defined and understood differently over the course of years. According to Nunberg et al (1994:492), 'idiom' is applied to a fuzzy category defined on the one hand by ostension of prototypical examples like English *kick the bucket*, *take care of NP*, or *keep tabs on NP*, and on the other by implicit opposition to related categories like formulae, fixed phrases, collocations, clichés, sayings, proverbs, and allusions - terms which, like 'idiom' itself, inhabit the ungoverned country between lay metalanguage and the theoretical terminology of linguistics. The broad linguistic spectrum is reflected in an abundance of terms that are used to refer to this linguistic phenomenon: multi-word items (Moon:1997), fixed expressions (Carter: 1998), phraseology (Howarth: 1998), idiom (McCarthy: 1998), phraseological unit (Gläser: 1984). From the above-mentioned terms in this paper, we adopt the term *idiom*, as the most traditional and well-known one, based on the Anglo-Saxon tradition. In Albanian, the term *phraseological unit* is used instead, according to the Eastern European linguistic tradition.

Idioms of comparison

We have limited our study to idioms of comparison which form a special group (as regards motivation) among the very heterogenous set of idiomatic expressions. According to Jani Thomai, they differ from other types of idioms in the sense that they do not express a semantic change since they are based on an external comparison. As a result, the semantic contribution of the constituents that form part of these idioms is of a different nature. Similes are motivated by their structure. They are generally introduced by a comparative element, namely ‘*as*’ in the pattern *as+adjective+as+noun*¹ and ‘*like*’ in some other patterns, corresponding to the conjunction ‘*si*’ in Albanian. The conjunction ‘*sa*’ is also used to form idioms of comparison in Albanian, but in this paper, we limit the study to those introduced only by the comparative element ‘*si*’.

In general, idioms of comparison function as adjectives modifying nouns and as adverbs modifying verbs/actions. When functioning as adjectives, they are mostly used to describe people (their character, behavior, appearance, etc.), as well as things or places. Examples of such idioms abound especially in the English language, which includes even structures which are not considered idiomatic in Albanian, namely the one that follows the pattern (be)+*as+adjective+as+N/NP*. According to Thomai, they are simply stable similes whose comparative element serves to clarify the meaning of the other word (i zi si qymyr²), comparing it to another object with a noticeable and permanent feature.

Interestingly enough, some of the idioms following the pattern (*as*)+*adjective+as+noun* do have Albanian counterparts, even though they are excluded from Albanian phraseology. There are many that even evoke identical or highly similar images in addition to the equivalence in terms of meaning, for example *as black as coal* - *i zi si qymyr*, *as white as snow* - *e bardhë si bora*, *as light as a feather* - *e lehtë si (një) pupël*, *as smooth as silk* - *e butë si mëndafsh*, *as gentle as a lamb* - *i urtë/i butë si qengj*, *as sweet as honey* - *i ëmbël si mjalti*, *as stubborn as a mule* - *kokëfortë si mushkë*, *packed as sardines* - *ngjeshur si sardele*, to name but a few.

There are also examples (even among the above listed) which make use of the same nouns and/or adjectives, but in Albanian the pattern changes, i.e. no simile is used, as in *sweet as honey* - *mjaltë i/e ëmbël*³, *light as a feather* = *i/e lehtë pupël*, *pupël i/e lehtë*⁴, *as dark/black as pitch* - *i/e zi/e zezë katran*⁵, *as heavy as lead* - *plumb i/e rëndë*, *i/e rëndë plumb*⁶, *as cold as ice* - *akull i/e ftohtë*⁷. The change in the pattern might even result in a different grammatical function of the whole phrase in Albanian, as in *as slippery as an eel* - *rrëshket (shket) si ngjalë*⁸, *as stubborn as a mule* - *ngul këmbë si mushkë*⁹, *as silent as the grave* - *(hesht) (si) gur varri*¹⁰, functioning as adverbs or even verbs instead of as adjectives as in English.

There are also cases where the meaning conveyed is the same, but the lexical structure is different, as in *white as a ghost* - *i verdhë/zbehtë si meit*¹¹, *as different as chalk and cheese* -

¹ The first "as" is often omitted in everyday speech. In Albanian structures it is almost never present.

² black as coal

³ honey sweet

⁴ feather light

⁵ pitch(-like) black

⁶ lead(-like) heavy

⁷ ice cold

⁸ A different pattern employed: verb + like + noun

⁹ A different pattern employed: verb+like+noun

¹⁰ gravestone

¹¹ pale as a cadaver

(*është/ndryshoj/ndryshim*) *si nata me ditën*¹², *as fit as a fiddle/flea, as right as rain/a trivet- si kokrra e mollës*¹³.

Idioms following the pattern (be)+as+adjective+as+N/NP in English

The idioms of comparison following this pattern in English outnumber the ones introduced by ‘like’. There are over 200 examples, and the following are some of them:

In English: *as American as apple pie, as cold as charity, as cool as a cucumber, as crooked as a dog's hind leg, as dead as a doornail, as deaf as a post, as drunk as a lord, as dry as a bone, as easy as ABC, as easy as (apple) pie, as fit as a butcher's dog, as flat as a pancake, as free as a bird, as fresh as a daisy, happy as a clam, as happy as a lark, as hard as a rock, as helpless as a baby, as high as a kite, as Irish as Paddy's pig, as large as life, as long as a month of Sundays, as mad as a hatter, as mad as a March hare, as many chins as a Chinese phone book, as nervous as a whore in church, as nutty as a fruit cake, as old as the hills, as patient as Job, as plain as the nose on your face, as playful as a kitten, as pleased as Punch, as poor as a church mouse, as pretty as a picture, as proud as a peacock, as quiet as a mouse, as red as a beetroot, as regular as clockwork, as scarce as hen's teeth, as hard as nails, as slow as molasses in January, as smooth as a baby's bottom, as snug as a bug in a rug, as sober as a judge, as solid as a rock, as straight as an arrow, as strong as an ox, as thick as thieves, as thin as a rake, etc.*

Variations in the pattern: *as boring as watching paint dry, as difficult as nailing jelly to a tree, as easy as falling off a log, as easy as taking candy from a baby, as honest as the day is long, as merry as the day is long, as sure as God made little green apples, as sure as eggs is eggs, as true as the day is long etc.*

In Albanian, as mentioned before, they are excluded from phraseology and it's the ones introduced by the word ‘si’¹⁴ or some other comparative element or pattern which count as idioms.

Idioms introduced by the preposition ‘like’ in English and the conjunction ‘si’ in Albanian

These idioms function mostly as adverbs, but there are examples of them functioning as adjectives, as well, after the verb *to be* or other copular verbs. As adverbials they generally denote manner, with the second component playing a specifying, restricting, qualifying and complementary role with regard to the first one.

In English we can mention: *like a moth to a flame, (be) like a bear with a sore head, (be) like a red flag/rag to a bull, like a thief in the night, like a blind dog in the meat market, (be) like shooting fish in a barrel (fishing), (be) like a deer caught in the headlights, (be) like watching paint dry, (be) like watching grass grow, like the cat that got the cream, look like something the cat dragged in, like a hen with one chick, like a cat on a hot tin roof, like a bull at a gate, like a bull in a china shop, like a house on fire, like a dose of salts, like white on rice, like a bolt from/out of the blue, like being savaged by a dead sheep, like rearranging the deckchairs on the Titanic, like getting blood out of a stone, like a shot, like a snake in the grass, etc.*

¹² like night and day

¹³ like an apple

¹⁴ like

In Albanian: *si kali qorr, si këmbët e dhisë, si dhentë pa bari, si dhentë në vathë, si rrodhja pas gunës, si mishi me thuan/kockën, si veza në kulaç, si thika në gjalpë, si maçoku në thekër, si rruar qethur, si burri me burrin, si këmbët e gjarprit, si dhia në mes të dhenve, si dhia në gjollë, si era me shi, si kau në arë/ugar, si krimbi nën gur, si miza në mjaltë, si flaka e kashtës (si flakë kashte), si ferra nëpër këmbë, si breshka te nallbani, si kokrra e mollës, etc.*

In Albanian, the pattern (verb) + like + noun phrase, where the verb is an optional element, (constituting a micro-context), is very common. Sometimes the semantic relations between the elements of the micro-context and the idiom proper are so close that the whole phrase can be taken as an idiom. There is normally a very limited number of verbs (more often than not, there is only one option) that can be used in that pattern. We find this pattern in English, as well.

In Albanian: *mbeti si pulë e lagur, rri si hu gardhi, ruaj si sytë a ballit, humb si sëpata pa bisht, shkoj si qeni në vreshtë, kapardiset/mbahet si qeni në qerre/si gjeli/kaposhi majë plehut, ruan si qeni mishin/mëlcitë, njihet si kau balash, shkon si cjapi te kasapi, flet si e jëma a Zeqos majë thanës, u tret/humbi si kripa në ujë, u bënë si këmbët e dhisë, janë si mishi me thuan/kockën, sillet/shin si kali në lëmë, dal si rruar qethur, futet si fanti spathi, humbi si gjilpëra në kashtë, njihet/dallohet si paraja e kuqe, janë/ndryshojnë si nata me ditën, shkojnë si macja me miun, vuan/heq si gjarpri nën gur, jam/rri si mbi gjemba, del si mëzi para pelës, etc.*

In English: *take to sth like a duck to water, know sth like the back of your hand, be like a bear with a sore head, look like sth the cat dragged in, look like the cat that got the cream, work/go like a dream, be like watching paint dry, be like watching grass grow, sit or stand somewhere like a bump on a log, spread like wildfire, hurt like the dickens, go like the clappers, cling like a leech, run around like a blue-arsed fly, etc.*

There are also examples where the idiom consists of a verb (not optional) + like + N/NP: *work like a Trojan, grin like a Cheshire cat, eat like a horse, eat like a pig, sleep like a log, shake like a leaf, work like a beaver*. The ones consisting of just a noun rather than a complex noun phrase are not considered phraseological units in Albanian, but merely stable similes (*punoj si kalë¹⁵, dridhem si purtekë¹⁶, fle si qingj¹⁷, zihen si qentë¹⁸*).

What is interesting is the fact that there are many cases where we find similarities in understanding and responding to reality in both languages, which can be explained if we accept that there are some cultural universals at play. Such idioms are a testimony of collective experience or regularities in human cognition. There are idioms that share a nearly identical lexical structure and semantic structure across these two languages and evoke almost identical or very similar images, as well as idioms that are equivalents in terms of meaning but display differences on the level of mental images and lexical constituents.

1. *like a chicken with its head cut off/like a headless chicken – si pulë pa kokë¹⁹*

¹⁵ work like a horse

¹⁶ shake like a perch

¹⁷ sleep like a lamb

¹⁸ fight/quarrel like dogs

¹⁹ like a chicken without its head

2. *like a fish out of water*- *si peshku pa ujë*²⁰but also *si peshku në zall/ gjanë/në të thatë*²¹
3. *spring up like mushrooms after the rain* – *(dalin) si kërpudhat pas shiut*
4. *(fight) like cat and dog* – *(zihen/shkojnë) si macja me miun*²²
5. *like a bolt from/out of the blue* - *si vetëtimë/bubullimë/rrufe në qiell të kaltër /të kthjellët*²³
6. *like a hot knife through butter*- *si thika në gjalpë*
7. *like a lamb/lambs to the slaughter /like turkeys voting for Christmas* – *si cjapi te kasapi*²⁴, *si breshka te nallbani*
8. *like a kid in a candy store* – *si fëmijë i lumtur*²⁵
9. *like a bump on a log* – *si hu gardhi*²⁶
10. *like two peas in a pod* - *si dy pika uji*²⁷
11. *like talking to a brick wall*– *si të flaswsh me murin*

Let's have a look at the idiom '**like a lamb to the slaughter**' in English and its Albanian equivalent '**si cjapi te kasapi**'. Although both idioms convey the same meaning, they differ in terms of the lexical constituents used to form the idiom. This can be explained by the fact that the English idiom comes from the Bible, whereas the Albanian one probably from livestock farming practices, the billygoat being more popular than sheep/lambs at the time the idiom was coined. However, the religious vs non-religious reference does not hinder understanding. The religious background might be an indicator that religion plays an important role in social life in their society.

Motivation of idioms of comparison

Generally speaking, idioms of comparison, especially the ones that follow the pattern '**as+adjective+as+NP**', are mostly self-explanatory, as they are based on observable animal behaviour, everyday experience, qualities or features, natural phenomena or activities which meet truth conditions, e.g. *as blind as a bat*, *as blind as a mole*, *as gentle as a lamb*, *as black as jet*, *as clear as crystal*, *as cold as ice*, *as quick as a flash*, *as rare as hens' teeth*, *as stubborn as a mule*, *dead as a dodo*, *as busy as a bee*, *as boring as watching paint dry* etc. The same is true even for the ones introduced by '**like**', whose meanings you can guess if they are related to people's general knowledge of the surrounding world, collective experience of the world/reality, etc.: *like a kid in a candy store*, *like a fish out of water*, *spring up like mushrooms after the rain*, *like moths to a flame*, etc; *si peshku*

²⁰ like a fish without water

²¹ like a fish on the shingle/in the dry

²² fight like cat and mouse

²³ in a clear blue sky

²⁴ like a he- goat to the butcher's

²⁵ like a happy kid

²⁶ like a wooden fence post

²⁷ like two water drops

*pa ujë*²⁸, *si mizat në mjaltë*²⁹, *(rri) si hu gardhi, (humb) si gjilpëra në kashtë*³⁰, *si rrodhja pas gunës*³¹, *si qeni i lëshuar nga zinxhiri*³², *si kofini pas së vjeli (të vjelave)*³³, *si pulë e lagur*³⁴, etc.

Let's consider the idiom '*si pulë e lagur*'. It's a testament to how idioms can be shaped by simple observations of nature, daily life and animals. What is interesting about this idiom is the fact that both languages use the lexical unit 'wet hen' but the meaning conveyed is very different due to different observations of hens' demeanor. Both idioms originate from rural farm life, but in English the idiom refers to hens' reaction to tossing a bucket of water at them, which causes a flapping uproar. In Albanian, the meaning is '(remain) as if afraid, submissive, not able to react, powerless' while in English it means 'very furious'. In English it is used humorously, in Albanian it is derogatory. Both are based on a simile - in English it follows the pattern '*as....as*' ('*as mad as a wet hen*'), whereas in Albanian it is introduced by '*like*'.

In most cases, 'the left-hand side' of the comparison (the adjective in the pattern '*as....as*') refers to a property that 'the right-hand side' (NP) is known to possess, whereas the right-hand side can be interpreted as an intensifier, semantically interpreted as 'very'. However, this pattern in English does not necessarily guarantee easy interpretation of the meanings since some of these idioms also contain culture-specific elements which make it difficult to trace the link between the literal reading and the actual meaning, e.g. *black as Newgate's knocker*, *as black as the Earl of Hell's waistcoat*, *as boring as a wet weekend in Wigan*, *as full as an Alabama tick*, *as happy as Larry*, *as safe as the Bank of England* unless one possesses cultural or conventional knowledge of some kind to understand why they mean what they mean (e.g. '*as hot as Hades*' comes from Greek mythology; '*as wise as Solomon*', '*as old as the hills*' from the Bible; '*as full as an Alabama tick*' – connected with the fact that Alabama is home to ticks, '*as wise as an owl*' – symbolic motivation, '*as drunk as a lord*' – connected with a cultural/historical context). Occasionally, the simile just relies on rhyme ('*as drunk as a skunk*', '*as loose as a goose*') or alliteration ('*as busy as a bee/beaver*', '*as fit as a fiddle*').

One may also have difficulty understanding why certain idioms make use of everyday items which do not normally contribute to the meaning of the idiom. Hence, some background knowledge or historical information as to why a particular item is used to make the comparison is definitely required to make sense of the idiom. Language-specific units exist because "*every language draws semantic distinctions that other languages do not*" (Wierzbicka: 1996).

Let's take the idiom '*as black as your hat*'. Nowadays, hats come in different colours. However, for a hundred years or so most hats in Britain were black, which explains why the word *hat* is used to make the comparison.

Similarly, the idioms introduced by '*like*' denote a high degree of the quality of the action; they can be explained using corresponding adverbs accompanied by the intensifier 'very' or a similar one, as

²⁸ like a fish out of water

²⁹ like flies to honey

³⁰ (go missing) like a needle in a haystack

³¹ like a bur stuck in a shepherd's cloak

³² like a dog unleashed (lit. set free from chains)

³³ like the basket after the harvest (English equivalent: 'close the stable/barn door after the horse has bolted/gone')

³⁴ (remain/stay) like a wet hen

in: (*ruaj*) *si sytë e ballit/ si dritën e syrit* – *so much*, (*duket*) *si në pëllëmbë të dorës* – *you can see sth very well/clearly*, (*zihen*) *si macja me minë* – *fight a lot*, *si kofini pas së vjelash* – *too late* etc. The adverb phrases that correspond to these idiomatic expressions can also be used alongside: ...*flet kot*, *si e ëma e Zeqos (në) majë (të) thanës*³⁵, etc. In these cases, motivation of the idiom becomes even clearer.

Thomai argues that it's not possible to refer to the semantic function of the constituents in constructions with similes as iconic or symbolic. However, if the left-hand side of the comparison denotes an action attributed to an animal which is rooted in cultural tradition, we can assume that the constituent (animal) coincides with its symbolic meaning, which means it is culture-based. Let's take the idiom '**like a bat out of hell**' as an example. This idiom, which means "to leave a place in a great hurry", has long been used in the UK. Bats have long been associated with secret occult things, thought to have come from hell³⁶. Hence the comparison coincides with the fact that bats fly very fast and wildly, often as if panicked.

However, there are many idioms of comparison that cannot be interpreted on the basis of natural experience and/or understood based on the observance of animal behavior as is the case with '**as sly/cunning as a fox**'. The concept of the fox as crafty or deceitful-a trickster- is rooted in the culture. This symbolic meaning of the fox is conventionalized. It's the symbolic knowledge that contributes to the interpretation of the idiom - how the fox has always been perceived in/by the western culture and portrayed in fables and tales of animals.

In Albanian, we can mention '**si buka që ha**'³⁷, an idiom built around the word *bread* - a universal symbol of food. A staple food for Albanians, present on our tables every day, it appears in many idioms. In general, the word *bread* is associated with hospitality/welcome and poverty at the same time, as in '*bukë e kripë e zemër*', and human survival, as in '*për bukën e gojës*'. However, in this particular idiom, based on a simile, it speaks of certainty, which, nevertheless, speaks also of cultural identity, as well, since it reflects our eating habits/ tradition. In Albania, no meal is eaten without bread on the table. There is an idiom in English which is used to express certainty as well, but the lexical constituent used is *eggs* instead: '**sure as eggs is eggs**'. Nevertheless, it must be borne in mind that the linguistic context in which it is used may be slightly different. In English, it's used to say that you are certain that something will happen, whereas in Albanian, it is mostly used to say that you are certain or you know for certain that something is true.

Such idioms are closely connected with aspects of community life which may be completely foreign to another, for example '**si veshka në mes të dhjemit**', '**si fiku me arrën**', '**si arra me palën**'. In Albanian culture, **si veshka në mes të dhjemit**³⁸, implies wellbeing, living very well, wanting for nothing, while in another culture it may be interpreted as having a negative connotation, as *fat* is not considered healthy. There is an idiom in English that comes close to the meaning of this Albanian idiom, namely **as snug as a bug in a rug**. However, we need to be aware of the lexical context in which they are used as they call for different contexts. The Albanian idiom suggests wealth/living in

³⁵ One talks nonsense, like Zeqo's mother atop a cornelian cherry tree

³⁶ According to urban legends (Urban Dictionary)

³⁷ sure as the bread I eat, (know sth for certain) like the bread I eat

³⁸ like the kidney amidst fat

good conditions apart from comfort. It is used to say that someone’s living conditions are great, they live well, in a nice and comfortable environment. In English, it suggests being in a very comfortable position/situation, especially with reference to coziness in bed.

The idiom (*shkojnë*) *si fiku me arrën/si arra me palën*³⁹ is closely connected with eating habits of Albanians and would not make sense to non-Albanians unless one has tried eating nuts with dried figs and knows they make a great combination.

There are some other idioms which cannot be motivated on the synchronic plane, because they are neither connected with the observation of universal behaviour and/or actions, nor with conventional/symbolic knowledge, but rather with certain events, places, persons that have left a mark in the language, such as (*flas*) *si e ëma e Zeqos (në) majë (të) thanës*⁴⁰, *si Baka me Zekën*⁴¹, *si Xhaferri simiten*⁴². The use of proper nouns in such idioms (as in other idioms) makes it almost impossible to work out the meanings of these idioms since there is no link between the literal reading and the actual meaning of these idioms to help motivate them. They are non-compositional. The only way to get to the meaning is to trace it back to its source. Sometimes their interpretation depends on the general encyclopedic knowledge someone has, the information about the connection with certain literary/historical contexts.

Conclusion

Idioms of comparison, subject to analysis in this study, constitute a particular set of idioms known as idioms motivated by their structure.

As regards the form, two patterns are listed: (*as*)+*adjective*+*as*+*N/NP* and (*verb*) + *like* + *NP*. The Albanian language lists idioms following only the second pattern with very few exceptions that have to do with what is included in the realm of phraseology and what is not according to the criteria used by Albanian linguists.

Based on the analysis carried out, it was found that there are many idioms which are not so self-explanatory when it comes to understanding why they mean what they mean. The presence of culture-specific elements in some of them makes it impossible, at times, to establish a motivating link between the literal reading of the idiom and its actual meaning. To do so, some kind of conventional/cultural knowledge outside the structure must come into play, as is usually the case with other culture-bound idioms.

Cultural information regarding animals, lifestyle, history, traditions, geography, etc is conveyed by idioms in general, and idioms of comparison are no exception. A better understanding of idioms is offered by a better understanding of idioms’ cultural background. They allow us to explore the way speakers of both languages express their thoughts, views, ideas and emotions, identifying similarities and differences in doing so, as reflected in these idioms.

Bibliography

³⁹ go together like the fig and the nut/ like the nut and the dried fig

⁴⁰ talk like Zeqo’s mother atop the cornelian cherry tree, meaning ‘talk through the hat’ ie talk nonsense

⁴¹ like Baka with Zeka, meaning ‘always together’

⁴² like Xhaferri (lost) the bread roll, meaning ‘to lose it, in a befuddled state, look befuddled’

- Carter, R. (1998). *Vocabulary*. Routledge, New York (second edition) [1.1]
Some other keywords and expressions associated with an implicit of sin and forgiveness are church, chapel, sin, sinner, preacher, excommunicated, clergyman and, as mentioned above, the number *four hundred and ninety heads, etc.* There is a full house as Jabez preaches, inspiring words, breaking down his sermon into 490 identified sins. Lockwood remembers considering some of them strange since he never regarded them as sins. When Jabez reaches the “first of the seventy-first,” Lockwood jumps out of his chair and accuses Jabez of being the sinner, asking the congregation to attack him, naming “preaching too much” as his sin. Jabez retaliates by saying, “THOU ART THE MAN!” naming the ultimate sin, thinking that anything is unforgivable.

Translation analysis and assessment. Translation equivalence and translation procedures

Examining the way the translator has coped with the translated version, it is evident that in the following example, the word “Landlord” is translated into Albanian as “Pronar”. The translator has employed expansion as a translation technique. In SL, there is only one unit, whereas in TL, there are more units, respectively, “në banesën / e të zotit / të shtëpisë/ku jetoj.” The translator wanted the readers to be clear that the narrator is the tenant and he went to meet the owner of the house he has rented. If it were simply translated as: *Sapo jam kthyer nga një vizitë tek pronari im* – the word *pronari* is general. Therefore, the translator has decided to resort to meaning expansion.

<p>I have just returned from a visit to my landlord – the solitary neighbour that I shall be troubled with. (Ch.1, P. 1)</p>	<p>Sapo jam kthyer nga një vizitë tek pronari im – the solitary neighbour that I shall be troubled with. (Ch.1, P. 1)</p>
---	--

The following example illustrates the way metaphors have been preserved in the translated version. The translator has adapted the metaphor for the target reader and has provided an instance of equivalence since the collocation “a cloud of meditation” does not exist in Albanian.

<p>However, having studied for an interval, with a fist on either knee and a cloud of meditation over her ruddy countenance... (Ch. 4, P. 46)</p>	<p>Por pasi ndenji një copë herë e menduar, me grushtet e mbështetur mbi gjunjë dhe me fytyrën e skuqur e kredhur thellë në mendime, ia pat... (Ch. 4, P. 36)</p>
--	--

Furthermore, in the following example, in bold, the translator has transferred the appropriate idiomatic meaning and message of an idiomatic expression in the TL, combined with over-translation, resulting in an instance of communicative translation.

<p>All day had been flooding with rain; we could not go to church, so Joseph must needs get up a congregation in the garret; (Ch.3, P.29)</p>	<p>Ka rënë shi me grykë shtambe tërë ditën; rrugët erdhën e t’u bënë përrënj; meqë nuk pati asnjë mundësi të shkohej në kishë, Xhozefi deshi të na e bënte ai predikimin aty në hambar; (Ch.3, P.24)</p>
--	---

<p>Having no desire to be entertained by a cat-and-dog combat, I stepped forward briskly... (Ch.3, P.43)</p>	<p>Meqë s’doja të shikoja një luftim si ai mes qenit dhe maces, u futa mes tyre me hap të lehtë...</p>	<p>In the</p>
---	---	---------------

example above, in bold, the translator has transferred the appropriate idiomatic meaning and message of an idiomatic expression in the TL, combined with over-translation, resulting in an instance of communicative translation. The idiom in bold in the SL, does exist in both languages, but the translator, through employing modulation and extension, has modified and modulated the translated version through introducing the active, instead of the active voice, combined with a simile in the TL version.

<p>WHAT vain weathercocks we are! (Ch.4, P.45)</p>	<p>Jemi si erë-tregues që na lëviz era nga të dojë! (Ch.4, P.36)</p>
--	--

<p>...and thanked my stars that at length, I had lighted on a spot where it was next to impracticable... (Ch.4, P.45)</p>	<p>...dhe që falenderoja fatin që më në fund kisha gjetur një vend të veçuar... (Ch.4, P.36)</p>
--	---

Referring to the first example, In the SL, the author has introduced a metaphor, in the TL, whereas the translator has recast the sentence by producing a simile, and has reordered the words, hence omitting “What” (in capital letters, so as to strongly emphasize the message) by shifting the emphasis of the sentence in the TL. As a result, the translated version transmits the emotional effect of the SL efficiently and appropriately. In the second example, the translator has skillfully employed contextual synonymy, since stars, “the lucky star” is often associated with luck and prediction for the future. Therefore, the translator has not translated it literally as “falenderoja *yjet*”, but contextually, and communicatively.

...hoping sincerely she would prove a regular gossip, and either **rouse me to animation** or **lull me to sleep** by her talk. (Ch.4, P.45)

...duke mbajtur shpresë që të ishte një bashkëbiseduese e mirë dhe me llomotitjen e saj t’ia dilte ose **të më jepte zemër**, ose **të më përgjumte**. (Ch.4, P.36)

We all kept **as mute as mice**. (Ch.4, P.60)

Që të gjithë **e qepëm gojën**. (Ch.4, P.47)

In the first example above, the translator has created a metaphor in the TL for the first collocation **rouse me to animation**, translated as **të më jepte zemër**, contrasted, in a binary opposition, to **lull me to sleep**, translated non-figuratively, as **të më përgjumte**. In the second example above, in his efforts to transfer the effect produced by the simile in the SL, **as mute as mice**, a stronger semantic equivalent of **as quiet as a mouse**, or **as quiet as a mouse**, the translator has resorted to adaptation, as a translation technique, resulting to an idiomatic and highly figurative expression, **e qepëm gojën**, which, in this context, literally means: *We did not utter a word/shut up/kept silent!*

The following example illustrates the way Heathcliff’s ironic response is recast in the TL through more translation units, implicit of connotative values, as in the case of the translated counterpart of the English “**Delightful company!**”, respectively: **Lëre mos e pyet!**, further supported and extended with **E bukur shoqëri!**, combined with the emphatic change of word order in the TL, which could be further emphasized and extended as “**Të bukur shoqëri më paske!**” (our suggested version). Further emphasizing the ironic tone, the translator, through extension and semantic elaboration, has produced two exclamatory statements, constituting separate translation units and units of thought, as compared to the only two words in the SL.

‘And for me, too,’ I replied. ‘I’ll walk in the yard till daylight, and then I’ll be off; and you need not dread a repetition of my intrusion. I’m now quite cured of seeking pleasure in society, be it country or town. A sensible man ought to find **sufficient company in himself**.’ (Ch.3, P.39-40)

“Edhe mua!”, iu përgjigja. “Do të shëtis nëpër oborr derisa të gdhijë, pastaj do të iki dhe mos kini hall se mos e përsëris më këtë furje. Tashmë jam shëruar nga dëshira e papërmbajtur për të gjetur kudo argëtim mes shoqërisë, qoftë edhe në fshat. Një njeriu me mend duhet **t’i mjaftojë shoqëria e vetvetes**.” (Ch.3, P.32)

‘**Delightful company!**’ muttered Heathcliff. (P.40)

“**Lëre mos e pyet! E bukur shoqëri!**” foli Hithklifi.

Conclusions

Understanding the author’s intention and his special use of language, in addition to understanding the different linguistic and stylistic devices employed to convey special effects, constitute the primary task for the literary translator/s. Likewise, it is interesting for the translation analyst to identify some of these lexically/grammatically/stylistically bound difficulties and analyze the different procedures employed to overcome such difficulties. Our examples of translation analysis attempt to identify the ways of overcoming the relevant translation difficulties and resolving the various translation problems.

Our research on translation quality assessment focuses on identifying instances of equivalence, not only at the micro-level but also at the macro-level, essentially. Linguistic analysis, translation equivalence, and translation procedures have been theoretically, analytically, and practically supported by introducing and analysing several translation examples extracted from Emily Brontë’s novel “Wuthering Heights”, translated into Albanian by the renowned translator Amik Kasoruho. The translator takes due account of the macro-context and decides to provide the respective equivalent translation/s. The method of analysis employing keywording, in addition to the other methods of discourse and critical discourse analysis, is very interesting and challenging in the process of analyzing a novel and its translation in any language. The focus of our analysis has been principally on translation procedures, such as transposition, modulation, equivalence, adaptation, transference, contextual synonymy, extension, etc.

Bibliography

- Babb, Valerie., (2017), *A History of the African American Novel*, Cambridge University Press.
- Bassnett, S. (1980/1991) *Translation Studies*, London and New York: Routledge, 2nd ed.
- Bassnett, S. (2002) *Translation Studies*, London and New York: Routledge, 3rd ed.
- Catford, J. C. (1965) *A Linguistic Theory of Translation*, Oxford: Oxford University Press.
- Brontë, E., “*Lartësi të Stuhishme*”, shqipëroi Amik Kasoruho, Gutenberg”, Tiranë: 2010.
- Brontë, E., “Wuthering Heights”, electronic copy, scanned and proofed by David Price
- Hatim, B. and Munday, J. (2004) *Translation An Advanced Resource ook*, London and New York: Routledge.
- House, J (1997) *Translation Quality Assessment: A Model Revisited*. Tübingen: Narr.
- Newmark, P. (1988) *A Textbook of Translation*, New York and London: Prentice Hall.
- Nida, E. A. (1964) *Towards a Science of Translating*. Leiden: E. J. Brill.
- Nida, E. A. and C. Taber (1969) *The Theory and Practice of Translation*, Leiden: Brill.
- Ristani, V. (2010) *Kontribut në Studimet Përkthimore gjatë viteve ‘90*, Monografi, Shtëpia Botuese GEER, Tiranë.
- Steiner, G. (1975/1998) *After Babel: Aspects of Language and Translation*, London, Oxford and New York: Oxford University Press, 3rd edn.
- Venuti, L. (1995) *The translator’s invisibility*. New York: Routledge
- Vinay, J. P. and J. Darbelnet (1958/1995) *Stylistique comparée du français et de l’anglais. Méthode de traduction*, Paris: Didier, trans. and ed. J. C. Sager and M.-J. Hamel (1995) as *Comparative Stylistics of French and English: A Methodology for Translation*, Amsterdam and Philadelphia: John Benjamins.(ed.) (2000), pp. 113–18.

Dr. Kristina Ajazi
Universiteti i Tiranës
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja
Departamenti i Gjuhës Angleze
kristina.ajazi@unitir.edu.al

Titulli: Polisemia si problem leksikor gjatë procesit të përkthimit

Abstrakt

Gjatë viteve të fundit, një numër gjithnjë e më i madh gjuhëtarësh janë bërë të vetëdijshëm se kuptimi është në qendër të gjuhës dhe duhet të merret parasysh në çdo nivel të analizës gjuhësore, nga fonetika tek pragmatika madje edhe tek studimet mbi ligjërimin. Një problem me të cilin përballen përkthyesit gjatë procesit të përkthimit është ndër të tjera ai i polisemisë. Polisemia në përkufizimin e saj më të thjeshtë, është një fjalë e cila ka shumë kuptime. Kur një fjalë polisemike shfaqet në një tekst të caktuar, përkthyesi duhet të vendosë se cili është kuptimi i saktë i fjalës në kontekstin në të cilin përdoret fjala. Përgjatë viteve, studiuesit janë përpjekur të përcaktojnë shkallën e lirisë që ka përkthyesi në përcjelljen e kuptimit nga teksti burimor drejt tekstit të synuar. Sigurisht që për të zgjidhur paqartësinë që vjen si rezultat i dy apo më shumë kuptimeve të fjalëve, përkthyesi duhet të marrë parasysh kontekstin. Ky punim synon të analizojë pikërisht problemet dhe sfidat që hasen gjatë këtij procesi.

Fjalët kyç: Polisemia, Përkthimi, Fjalë polisemike, Konteksti

Hyrje

Polisemia apo fjalët me shumë kuptime përbëjnë një nga sfidat më të mëdha për studiuesit e gjuhëve të ndryshme. Sa më pak specifik të jetë konteksti ku janë përdorur këto fjalë aq më i paqartë do të jetë kuptimi i tyre dhe si rrjedhojë edhe më e vështirë puna e përkthyesit. Përgjatë viteve të fundit, studiues të ndryshëm të fushës së përkthimit kanë shpenzuar shumë kohë dhe kanë bërë shumë përpjekje për të diskutuar shkallën e lirisë që ka përkthyesi në përcjelljen e kuptimit të tekstit burimor në gjuhën e synuar.

Ndoshta përkthimi do të ishte shumë më i thjeshtë nëse çdo fjalë do të kishte vetëm një kuptim e si rrjedhojë, vetëm një përkthim të mundshëm. Sigurisht që nuk është kështu në botën ku jetojmë. Fjalët kanë kuptime të shumëfishta, dhe kjo është ajo që ne e quajmë polisemi. Në të njëjtën mënyrë një koncept mund të shprehet duke përdorur fjalë të ndryshme (ato që ne i quajmë sinonime), një fjalë mund të shoqërohet me koncepte ose kuptime të shumta.

Gjate përkthimit sidomos atij me shkrim, kur ndeshemi me fjalë polisemike është shumë i vështirë përkthimi i tyre jashtë një konteksti të caktuar. Themë gjatë përkthimit me shkrim sepse gjatë komunikimit, procesi është më i thjeshtë pasi edhe vetë ambienti në të cilin gjendemi shërben si kontekst.

Gjetja e përkthimit të duhur për një fjalë polisemike quhet zbardhje e kuptimit të fjalës.

Cfarë është polisemia? Polisemia si fenomen gjuhësor.

Shumë përkufizime i janë dhënë konceptit të polisemisë. Ullman (1967) e përkufizon poliseminë si një "situatë" në të cilën e njëjta fjalë ka dy ose më shumë kuptime të ndryshme. Ai shton se polisemia është një tipar themelor i të folurit njerëzor që mund të lindë në shumë mënyra.

Nida (1969), nga ana tjetër, nuk e konsideron poliseminë të jetë një problem vendimtar për përkthyesin, pasi kuptimet e ndryshme të një fjale të vetme janë rrallë në konkurrencë, sepse ata jo vetëm që kanë shënues/kufinj relativisht të mirëpërcaktuar që ndihmojnë në dallimin e kuptimeve, por shpesh ato janë aq të ndryshme sa të mos konkurrojnë me njëri-tjetrin për të njëjtën fushë semantike.

Sipas Crystal (1980), polisemia është një term i përdorur në analizën semantike për t'iu referuar një elementi leksikor që ka një sërë kuptimesh të ndryshme.

Shumë studiues të tjerë besojnë se polisemia është e lidhur ngushtë me homoniminë dhe ndodh kur një fjalë ka më shumë se një kuptim. Nisur nga këto, polisemia mund të përkufizohet si një rast në të cilin një fjalë e vetme ka shumë kuptime; secili prej këtyre kuptimeve duhet të mësohet veçmas për t'u kuptuar.

Në gjuhën angleze fjala "Light" mund të nënkuptojë: 1. një burim fizik drite, (turn on the light) 2. një nuancë të lehtë të ngjyrës në fjalë (light beige) ose 3. faktin që një objekt apo dikush nuk është i rëndë në peshë (light as a feather).

Një tjetër shembull mund të ishte folja "serve" në secilën nga fjalitë e mëposhtme folja ka kuptime të ndryshme:

1. He served in the military. (kreu shërbimin ushtarak)
2. He served several years of imprisonment. (vuajti disa vite burgim)
3. You have served me well during this project. (më ke ndihmuar)
4. Free food was served during the party. (ofroj ushqim)

Të gjitha fjalitë përdorin të njëjtën folje "serve", gjithsesi në çdo fjali mbart një kuptim të ndryshëm dhe si rrjedhojë edhe përkthimi i saj është ndryshe.

Pra, polisemia është një nga problemet kryesore që hasin studiuesit apo përkthyesit, të cilët ndonjëherë preferojnë t'i referohen asaj si "paqartësi/ambiguity". Gjithsesi pyetja duket e thjeshtë: të gjithë e dinë se një fjalë mund të ketë disa kuptime. Megjithatë, një përkufizim i tillë është në mënyrë të dukshme çorientues. Studiuesit e gjuhës e dinë se sa e vështirë është të përcaktosh numrin e kuptimeve të një fjale, t'i përcaktosh ato, apo të thuash ku mbaron njëra dhe ku fillon tjetra. Në fakt, për të qenë në gjendje për t'iu përgjigjur këtyre pyetjeve kërkon "marrëveshje paraprake" për atë që kuptohet me fjalën "kuptim" në krahasim me fjalën "domethënie" - gjë që nuk është aspak e thjeshtë.

Studimi i polisemisë i parë nga qasja diakronike konsiderohet si zhvillim dhe ndryshim i strukturës semantike të fjalës: një fjalë mund të ruajë kuptimet e mëparshme dhe në të njëjtën kohë zhvillon kuptime të reja. Studimi diakronik i polisemisë shqyrton ndërvarësinë dhe lidhjen që ekziston ndërmjet kuptimeve individuale të një fjale polisemantike, cilat janë kuptimet primare dhe prejardhëse dhe si ato lidhen me njëra-tjetrën.

Semantika leksikore sot merret shumë me poliseminë e cila nuk konsiderohet më si një “anomali”, por më tepër si një tipar i brendshëm dhe thelbësor i të gjitha gjuhëve natyrore. Për më tepër, studimi i polisemisë ka marrë një rëndësi të re në fushën e përkthimit automatik të gjuhëve natyrore: është një nocion kyç për kuptimin automatik të gjuhës.

Studiuesit e semantikës dhe linguistikës të gjithë bien dakord në disa pika:

- paqartësia (Ambiguity) rrallëherë përbën problem në ligjërim, për vetë faktin se njerëzit, në një mënyrë apo një tjetër, falë elementeve kontekstuale, ia dalin të zbardhin kuptimin e përmbajtjes, problemi kryesor ende mbetet tek të përkthyerit automatik;
- nuk ka asnjë mënyrë të thjeshtë apo formulë magjike për të identifikuar kuptimet (domethëniet) e ndryshme të një fjale;
- ndryshimi midis homonimisë nga njëra anë dhe polisemisë nga ana tjetër duhet menduar në termat e një vazhdimësie dhe jo të një dikotomie.

Duke qenë se fjalët polisemike janë një nga shkaqet kryesore të paqartësisë, disa studiues si Aristoteli kanë qenë kritikë ndaj saj, duke thënë se fjalët e paqarta përdoren kryesisht për të ngatërruar dëgjuesin. Që atëherë, filozofët e kanë quajtur poliseminë një mungesë apo varfëri të gjuhës dhe si një pengesë kryesore për komunikimin. Të gjitha këto pikëpamje u hodhën poshtë nga Breal (1911), sipas të cilit paqartësia ishte një tregues i epërsisë së një gjuhe. Zgjerimi i strukturës semantike të fjalës, nuk është gjë tjetër vecse pasurimi i fjalorit dhe një nga mënyrat e brendshme të rritjes shprehëse dhe komunikuese të gjuhës.

Mund të thuhet se polisemia është një nga konceptet që e bën shumë më të lehtë komunikimin. Pa poliseminë dhe koncepte të tjera gjuhësore që mundësojnë lidhjen dhe ndryshimin e kuptimit të fjalëve dhe përdorimin abstrakt të gjuhës, komunikimi do të kufizohej ndjeshëm sepse folësit do të duhej të përdornin fjalë specifike për çdo koncept individual. Është e pamundur të përcaktohet numri i fjalëve që do të nevojiteshin për të përdorur çdo fjalë në një kuptim unik.

Polisemia dhe homonimia

Një nocion i lidhur ngushtë me poliseminë është edhe homonimia. Duke iu referuar përkufizimeve të mësipërme, polisemia është një term që i referohet situatave ku fjala e njëjtë ka dy ose më shumë kuptime të ndryshme, por të lidhura mes tyre. Koncepti i polisemisë është mjaft i ndërlikuar sepse është e vështirë të përcaktohet numri i kuptimeve të një fjale polisemike. Nga ana tjetër, si vështirësi tjetër paraqitet shpesh dallimi i fjalëve polisemike nga homonimet, me anë të të cilave shprehen kuptime të ndryshme të palidhura mes veti për një formë të vetme të fjalës. Për të bërë një dallim mes tyre disa herë mund të mbështetemi në faktin se homonimet në fjalor paraqiten veçmas ose kanë hyrje të veçanta, ndërsa fjalët polisemike paraqiten vetëm me një hyrje. Megjithatë, jo të gjitha rastet janë

kaq të qarta, dhe si rezultat, shpesh paraqitet paqartësi gjuhësore. Një kriter për dallimin e shprehjeve polisemike dhe homonimike është marrëdhënia historike ose konceptuale midis fjalëve: Fjalët që kanë të njëjtën origjinë historike ose lidhen konceptualisht quhen fjale polisemike, këtu mund të përmendim edhe faktin se ndërsa fjalët polisemike kanë një dhe vetëm një prejardhje etimologjike, homonimet nuk janë të lidhura etimologjikisht.

Homonimia ndryshon nga polisemia dhe paqartësia në mënyrën se si përfshin fjalë me kuptime të palidhura edhe pse ato janë të njëjta në strukturë, dhe homonimet zakonisht janë fjalë që i përkasin kategorive të ndryshme të fjalëve. Një shembull i homonimeve është fjala në anglisht “Book” (libri) si emër, që do të thotë "një lidhje letrash që përmbajnë një tekst për t'u lexuar" dhe “Book” si folje, që do të thotë "të bësh një rezervim". Ndryshe nga polisemia ku fjalët kanë kuptime të lidhura në një masë të caktuar, homonimet kanë kuptime krejtësisht të palidhura.

Në shembullin e mëposhtëm të dy dukuritë shfaqen së bashku:

- They passed the port at midnight.

Kjo fjali është e paqartë si rrjedhojë e pranisë së homonimisë dhe polisemisë: te fjala port kemi rastin e homonimisë: (1) port = port detar/liman (2) port = verë e fortë portugeze (shkurt për Oporto) dhe folja “passed” e cila është polisemike pasi mund të përkthehet “kaloj” ose “pasoj, ofroj”. Si rrjedhojë fjalia mund të përkthehet në dy mënyra: 1. Ata kaluan portin në mesnatë. 2. Ata ofruan verë në mesnatë.

Polisemia dhe vështirësitë që paraqet gjatë procesit të përkthimit.

Kur bëhet fjalë për përkthimin, fjalët polisemike mund të jenë një sfidë e vërtetë. Përkthyesi duhet të kuptojë kontekstin në të cilin përdoret një fjalë dhe të zgjedhë kuptimin e duhur në gjuhën e synuar. Kjo kërkon një kuptim të thellë të të dy gjuhëve, si dhe aftësinë për të analizuar dhe interpretuar me saktësi tekstin origjinal. Në disa raste, një fjalë në gjuhën burimore mund të mos ketë ekuivalente të drejtpërdrejta në gjuhën e synuar. Në situata të tilla, përkthyesit mund t'i duhet të gjejë mënyra alternative për të përcjellë kuptimin e synuar duke përdorur fjalë ose fraza alternative që kanë të njëjtin thelb. P.sh: folja “Break” (Thyej)

- He broke the glass. (theu xhamin)
- She broke the world record. (theu rekordin botëror)
- She will break the news soon. (Do të shpërndajë lajmin)
- Do not break your promise! (Mos e shkel premtimin)
- Break a leg! (idiom) (Paç fat)

Apo në rastin kur përdoret si emër: You may take your break.(përkthimi i së cilës në këtë rast do ishte “pushim”

Një tjetër shembull do të ishte fjala “Sound” kuptimi kryesor i së cilës është “tingull” por në gjuhën angleze ka një sërë kuptimesh të tjera si psh:

- I like the sound of birds. (Më pëlqen kënga/cicërima e zogjve)
- Thank you for your sound advice! (Këshillë e mirë/me vlerë)
- How does a sound sleep help us? (Një gjumë i mirë/i thellë)

- A sound mind in a sound body! (Mendje e shëndoshë në trup të shëndoshë)

Polisemia ndodh në nivelin e fjalës. Kur dikush thotë se “The Head of the department will be visiting our office”, të gjithë e kuptojnë se kuptimi i fjalës “Head” është përgjegjës i departamentit dhe jo koka si pjesë e trupit. Fjalori i Oksfordit ofron më shumë se 10 kuptime të dallueshme të kësaj fjale, si pjesa e sipërme e trupit e ndarë nga pjesa tjetër e trupit nga qafa, si pjesa e përparme ose e sipërme e diçkaje, një person përgjegjës për diçka (head of department), etj. Ne jemi në gjendje të dallojmë ekuivalentin logjik nga të gjitha kuptimet e tjera të mundshme në bazë të kontekstit të bisedës.

□ *Bar*

Nga anglishtja mund të përmendim fjalë polisemike si bar, që mund të përdoret në “Bar of soap” që në shqip do të ishte “Kallëp sapuni” dhe përdoret gjithashtu për t'u referuar vendi ku mund të konsumosh kryesisht pije.

□ *Smart*

Smart "I zgjuar" mund të përdoret për të përshkruar dikë që është i zgjuar ose që është veshur mirë, dhe në mënyrë të kuar. Kur bëhet fjalë për përkthimin e fjalës “smart”, kuptimi i saktë i saj duhet të kontrollohet paraprakisht. Të dy kuptimet i referohen cilësive njerëzore, por janë mjaft të ndryshme, njëra është e lidhur me personalitetin dhe tjetra e lidhur me pamjen fizike.

□ *Pupil*

Fjala “pupil” në varësi të kontekstit mund t'i referohet një studenti/nxënësi ose zonës rrethore të zezë në qendër të syrit.

Nga ana tjetër, paqartësia (ambiguity), ose thjesht paqartësia e kuptimit, lind në nivelin e fjalisë dhe mund të zgjidhet duke marrë parasysh kontekstin. Nëse dikush thotë “You heard it right. Bill is running. Fjalja nuk e sqaron saktë kuptimin i cili në varësi të një konteksti më të gjerë mund të ishte: Bill po vrapon. (po stërvitet) ndërsa kuptimi i dytë do të ishte: Bill po kandidon për një post të caktuar.

Gries (2015) gjithashtu përmendi se polisemia është një formë e paqartësisë sepse një fjalë përfshin të paktën dy kuptime dhe ato janë të lidhura me njëra-tjetrën. Le të analizojmë shembullin si më poshtë:

I emptied the glass (‘container’).

I drank a glass (‘contents of the container’).

Zbraza gotën (‘enë’).

Piva një gotë (‘përmbajtja e enës’).

Në fjalinë e parë fjala “gotë” është një enë; në fjalinë e dytë, “gotë” i referohet përmbajtjes. Janë gjëra krejtësisht të ndryshme. Megjithëse ato pasqyrojnë një shkallë të lartë paqartësie, ato janë polisemike.

Polisemia dhe konteksti

Një aspekt tjetër i rëndësishëm në lidhje poliseminë dhe sfidat që ndeshën në përkthimin e fjalëve polisemike është edhe konteksti.

Widdowson (2000) e përkufizon kontekstin si "ato aspekte apo rrethana të përdorimit aktual të gjuhës që konsiderohen të rëndësishme për kuptimin". Ndërsa Cook (1999) tregon se konteksti mund të përdoret në kuptimin e tij të gjerë dhe të ngushtë: "Në kuptimin e ngushtë, konteksti i referohet faktorëve jashtë tekstit e marrë në shqyrtim. Në kuptimin e gjerë, konteksti i referohet njohurive të këtyre faktorëve ndonjëherë të referuara si bashkëtekst." Bazuar në studime të ndryshme ekzistojnë tre lloje të kontekstit:

Konteksti gjuhësor: i referohet kontekstit brenda ligjërit, domethënë marrëdhënies midis fjalëve, frazave, fjalive, madje edhe paragrafëve. Sipas Naziha (2009) "Kur një fjalë me kuptime të ndryshme ndryshon kuptim në varësi të grupit të fjalëve në të cilin ajo gjendet." Për shembull, fjala "qafë" ka disa kuptime krejt të ndryshme nga njëra-tjetra në varësi të fjalës pasuese. Prandaj, konteksti gjuhësor është mjaft i rëndësishëm dhe i ndërlikuar dhe përkthyesit duhet të jenë të vetëdijshëm për kontekstin në të cilin shfaqet një njësi leksikore në mënyrë që të transferojnë saktë kuptimin nga gjuha burimore në gjuhën e synuar.

Konteksti Situativ/Rastësor: luan një rol të rëndësishëm për të arritur kuptimin e një shprehjeje apo fjale. Ai gjithmonë i referohet veçorive përkatëse të situatës në të cilën një tekst ka kuptim, mjedisit, kohës dhe vendit, etj në të cilin zhvillohet ligjërimi, si dhe marrëdhëniet ndërmjet pjesëmarrësve. Prandaj, përkthyesi duhet të marrë parasysh kontekstin e situatës në mënyrë që të gjejë ekuivalencën e pranueshme në gjuhën e synuar.

Konteksti kulturor: i referohet historisë, kulturës, zakoneve dhe vlerave të një grupi shoqëror në të cilin ndodh bashkëbisedimi. Konteksti kulturor është i rëndësishëm për procesin e arsyetimit të ligjëruësve. Gjithsesi duhet të merret parasysh se kontekstet kulturore kanë të bëjnë me vlerat dhe besimet që gjithësecili ndryshe nga kontekstet sociale të cilat kanë të bëjnë me rregullat dhe pritshmëritë që të gjithë në shoqëri duhet të ndjekin.

Bazuar në sa më sipër konteksti luan një rol vendimtar, jo vetëm për të sqaruar paqartësitë e mundshme, por edhe në përkthim; procesi i përkthimit bëhet edhe më i vështirë nëse nuk mbështetemi në kontekst.

Përfundime

Problemet e përkthimit janë të shumta në të gjitha nivelet dhe kjo është ajo që e bën atë një sipërmarrje të vështirë. Ka probleme gjuhësore dhe probleme kulturore.

Përkthimi luan një rol vendimtar në transmetimin e kuptimeve, lehtëson komunikimin midis njerëzve dhe ndihmon të kuptuarit e gjuhëve të ndryshme, si dhe në shkëmbimin e njohurive midis dy kulturave të ndryshme, por nga ana tjetër përkthyesi duhet të jetë i sigurt se ka zgjedhur "fjalën" apo "kuptimin e duhur", e në këtë rast e vetmja gjë që do t'i ndihmojë është "konteksti", veçanërisht me fjalët që kanë më shumë se një kuptim.

Studimi i polisemisë mund t'i ndihmojë përkthyesit, duke u dhënë atyre udhëzime të caktuara, se si të zgjedhin fjalët dhe si të përdorin kontekstin për të zgjidhur paqartësinë e fjalëve polisemike. Siç theksuan Fauconnier dhe Turner (2003), shumica e polisemisë është me të vërtetë e padukshme. Por bëhet e dukshme për përkthyesin, i cili në shumicën e rasteve detyrohet të gjejë një zgjidhje gjatë

gjatë përkthimit. Ndaj është shumë e rëndësishme që përkthyesi të kuptojë mënyrën se si zhvillohet polisemia dhe se sa ndikon në ligjërim. Fakti që konteksti mund të përcaktojë kuptimin specifik të një fjale polisemike ilustron natyrën dinamikë të gjuhës.

Bibliografi

- Bréal, M. 1911 *Semantics: studies in the science of meaning*. Heinemann.
- Crystal, David (1980). *A First Dictionary of Linguistics and Phonetics*. Oxford: Basil Blackwell Ltd.
- Cook, G. (1999). *Discourse and Literature: the Interplay of Form and Mind*. Oxford: University Press.
- Fauconnier, G. & Turner, M. (2003). *The Way We Think*. New York: Basic Books.
- Ghazala, H. (1995). *Translation as Problems and Solutions: A Course Book for University Students and Trainee Translators*. Malta: ELGA.
- Gries, S. Th. (2015). Polysemy. In E. Dabrowska & D. Divjak (Eds.), *Handbook of cognitive linguistics* (pp. 472- 490). Berlin, Germany: De Gruyter Mouton.
<https://doi.org/10.1515/9783110292022-023>
- Naziha, H. (2009). *The role of context in translating polysemy: A case study first year Master*.
- Nida, E. A., & Taber, C. R. (1982). *The Theory and Practice of Translation*. Leiden: E.J. Brill. (Original work published 1969)
- Widdowson, H. G. (2000). *Linguistics*. Shanghai: Foreign Language Education Press, 2000
- Ullman, S. (1962). *Semantics: An Introduction to the Science of Meaning*. Oxford: Basil Blackwell.
- Collins English Dictionary 1986
https://www.oxfordlearnersdictionaries.com/definition/english/head_1?q=head

Dr. Luella Liçi

Universiteti i Tiranës

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

Departamenti i Gjuhës Angleze

luella_lichi@yahoo.com

Titulli: Modele të sigurimit të cilësisë së përkthimit të instrumenteve të vlerësimit të PISA-s dhe TIMSS-it

Përmbledhje

PISA dhe TIMSS, dy programe ndërkombëtare të vlerësimit të arritjeve të nxënësve, kanë zhvilluar kornizën e politikave të përkthimit për të përballuar sfidat e cilësisë së përkthimit të instrumenteve të vlerësimit. Në këtë referim prezantohen rezultatet e kërkimit të kryer për modelet e sigurimit të cilësisë së përkthimit të testeve dhe të pyetësorëve të PISA-s dhe TIMSS-it. Kërkimi u jep përgjigje dy pyetjeve kërkimore: Çfarë kontributi kanë dhënë PISA dhe TIMSS në zhvillimin e modeleve të sigurimit të cilësisë së përkthimit? Cilat modele dhe procedura të sigurimit të cilësisë së përkthimit janë përdorur për të arritur barasvlerën e përkthimit të instrumenteve ndërkombëtare të vlerësimit të PISA-s dhe të TIMSS-it? Kërkimi është mbështetur në disa burime: në dokumentacionin e PISA-s dhe të TIMSS-it, në kërkimet e kryera në fushë, në kërkimin e kryer nga ana ime për modelet dhe procedurat e përkthimit, të përshtatjes dhe të verifikimit të cilësisë së përkthimit të testeve dhe pyetësorëve të PISA-s dhe TIMSS-it në gjuhën shqipe, në përvojën time si verifikuese ndërkombëtare e cilësisë së përkthimit. Kërkimi gjeti se PISA dhe TIMSS kanë zhvilluar më tej teorinë dhe praktikën e cilësisë së përkthimit; kanë eksperimentuar modele të përkthimit; kanë përpunuar dhe përdorur modelin e përshtatshmërisë së përkthimit dhe modele të metrikës së gabimeve; kanë ndërtuar modele të dokumentimit të përkthimit, të përshtatjes dhe të verifikimit; kanë krijuar një sistem të verifikimit të përkthimit.

Fjalë kyçe: politikë e përkthimit, model i përkthimit, verifikim i cilësisë së përkthimit, metrikë e gabimeve

Hyrje

Objekt i kërkimit të paraqitur në këtë referim janë modelet e sigurimit të cilësisë së përkthimit të instrumenteve të vlerësimit të PISA-s dhe TIMSS-it. Kërkimi u përqendrua në analizën e përvojës së PISA-s dhe të TIMSS-it për sigurimin e cilësisë së përkthimit të instrumenteve të vlerësimit që të shërbejë më pas si një pikë reference për t'i dhënë përgjigje pyetjeve kërkimore që lidhen me ndikimin e procedurave të përkthimit, të përshtatjes dhe të verifikimit të instrumenteve ndërkombëtare të PISA-s dhe TIMSS-it në sigurimin e barasvlerës së përkthimit të versionit të gjuhës shqipe.

Çështja e marrë në studim është e rëndësishme për një sërë arsyesh. Bazuar në dokumentet e prodhuara nga PISA (2000, 2003, 2006, 2009, 2012, 2015, 2018), TIMSS (1995, 1999, 2003, 2007, 2015, 2019), si: udhëzimet për përkthim dhe përshtatje, raportet teknike, standardet teknike, mund të vërehet se domosdoshmëria e cilësisë së lartë të përkthimit dhe procedurat rigoroze të verifikimit të përkthimit të testeve, pyetësorëve dhe manualeve përcaktohen nga një sërë faktorësh dhe kërkesash,

si: rritja e numrit të gjuhëve në të cilat përkthehen instrumentet e vlerësimit; administrimi i instrumenteve të vlerësimit në sisteme të ndryshme arsimore në mbarë botën; kërkesa për të siguruar barasvlerën e instrumenteve të vlerësimit, veçanërisht barasvlerën kuptimore; kërkesa për të siguruar testimet të vlefshme midis vendeve; kërkesa për të siguruar krahasueshmërinë e të dhënave të vlerësimit ndërmjet vendeve; kërkesa për të mbajtur të njëjta kudo përpjekjet mendore të nxënësve; kërkesa për të shmangur ngarkesën më të madhe njohëse të nxënësve, duke siguruar që nxënësit të mos i nevojitet më shumë kujtesë pune për të deshifruar dhe kuptuar informacionin e dhënë.

Shqyrtimi i literaturës

Një numër i pakët shkrimesh përmbajnë analiza të aspekteve të ndryshme të përvojës së PISA-s dhe e TIMSS-it për sigurimin e cilësisë së përkthimit. Këto shkrime paraqesin aspekte të zhvillimeve, të arritjeve dhe të sfidave të sigurimit të cilësisë së përkthimit nga këto dy studime ndërkombëtare.

Ferrer (2011), cituar nga Korsnakova, P. & Dept, S (2020) ka vënë në dukje se IEA⁴⁷ ka zbatuar procedura të ndryshme përkthimi me kalimin e kohës dhe ka ndjekur tre hapa të kujdesshëm midis të cilëve procedura rigorozë për përkthimin e dyfishtë të testeve në gjuhët e ndryshme të vendeve pjesëmarrëse. Martin etj. (1999) dhe Korsnakova etj. (2020) kanë pranuar se cilësia e studimeve të IEA varet nga saktësia e përkthimeve të instrumenteve (testet, pyetësorët dhe manualët) nga versioni burimor ndërkombëtar në versionet kombëtare. Maxwell (1996) ka raportuar se “Për shkak të rrezikut të qenësishëm të gabimit ose pabarazisë në përkthime, vlefshmëria e përkthimit ishte një problem që në fillimet e TIMSS-it”.

Duke analizuar qasjet e përshtatjes së përdorura nga IEA, Korsnakova dhe Dept, (2020) raportojnë se studimet e IEA-së kanë adoptuar qasjen e decentralizuar, sipas së cilës Qendrat Kombëtare janë përgjegjëse për përkthimin dhe përshtatjen e instrumenteve në gjuhën (t) e tyre të mësimin dhe aktivitetet e mbuluara në dokumente përfshijnë: 1) përkthimin dhe/ose përshtatjen e instrumenteve të studimit; 2) dokumentimin e përshtatjeve kombëtare të bëra në instrumentet e studimit; 3) verifikimet ndërkombëtare (përkthimi, përshtatja dhe faqosja); dhe 4) finalizimin e instrumenteve kombëtare për administrim.

Dept (2013) trajton përkthyeshmërinë si një procedurë për sigurimin e cilësisë së pyetësorëve përpara finalizimit dhe dërgimit të instrumenteve vendeve pjesëmarrëse në studim. Sipas tij, kjo procedurë ka vlerë në procesin e përmirësimit të cilësisë. Grisay (2003) analizon procedurat e përkthimit në PISA 2000 duke u ndalur në mënyrë të veçantë në modelin e përkthimit nga dy burime paralele ndërkombëtare, si një model eksperimental. Ajo argumenton avantazhet e këtij modeli krahasuar me përkthimin e dyfishtë.

Martin etj. (1999) vunë në dukje se verifikimi i instrumenteve të përkthyer në gjuhët e vendeve pjesëmarrëse perceptohet si një masë që siguron krahasueshmërinë e të dhënave të mbledhura nga performanca e arritjeve nga vende dhe kultura të ndryshme, duke mos ndryshuar kuptimin dhe nivelin e vështirësisë së testeve nga versioni ndërkombëtar. Dept etj. (2010) përshkruajnë zhvillimet e fundit në verifikimin e procedurave të përdorura për të monitoruar cilësinë e versioneve kombëtare të testeve të përkthyer/përshtatura në tre studime ndërkombëtare dhe argumentuan përdorimin e një mjeti

⁴⁷ IEA (International Association for the Evaluation of Educational Achievement)

monitorimi të vetëm për të dokumentuar të gjithë ciklin e përgatitjes së çdo versioni gjuhësor të testeve.

Rezultate të kërkimit

Politika e cilësisë së përkthimit të PISA-s dhe të TIMSS-it

Për të siguruar cilësinë e përkthimit, PISA dhe TIMSS kanë zhvilluar kornizën e politikave të përkthimit që përmban qëllime, parime, standarde dhe procedura. Politika e cilësisë së përkthimit është ndërtuar mbi pesë koncepte bazë: vlerësimi i cilësisë, vlerësimi i përkthyeshmërisë, sigurimi i cilësisë, kontrolli i cilësisë dhe monitorimi i cilësisë. Duke shqyrtuar politikën e cilësisë së përkthimit të zbatuar nga PISA dhe TIMSS, mund të vërehet se ajo mbështetet në konsideratat teorike të studiuesve të ndryshëm të fushës së përkthimit, në metodologjit, tipologji dhe rekomandime të lidhura me përkthimin, barasvlerën e përkthimit, përshtatjen dhe verifikimin.

Nga këndvështrimi i përkthimit, procesi i sigurimit të cilësisë garanton barasvlerën e përkthimit, tregon se përkthimi është bërë në mënyrë të saktë dhe teksti i përkthyer mund të transmetojë informacion në mënyrë të ngjashme me dokumentin burimor. Të gjitha procedurat e sigurimit të cilësisë zbatohen gjatë përgatitjes së instrumenteve, pilotimit, studimit kryesor dhe përfundimit të studimit. Standardizimi i procedurave të përkthimit, përshtatjes dhe verifikimit është pranuar si mënyra më e përshtatshme që mundëson përmbushjen e cilësisë së përkthimit (PISA, 2018; TIMSS, 2020). Prosesi i përkthimit është konceptuar për të garantuar standardizimin e instrumenteve në të gjitha vendet.

Kështu, të dy programet kanë artikuluar qartë qëllimin e procedurave të përkthimit, përshtatjes dhe verifikimit që përmban elementin kyç të përbashkët: ruajtjen e standardeve të cilësisë, sigurimin e barasvlerës së kuptimit dhe vështirësisë kuptimore duke bërë njëkohësisht përshtatje kombëtare, por duke ruajtur krahasueshmërinë ndërkombëtare. Duke krahasuar kornizën e përkthimit dhe të përshtatjes së këtyre dy vlerësimeve ndërkombëtare, mund të vërehet se ato kanë grupe standardesh, rregullash dhe rekomandimesh që janë të përcaktuara qartë, praktike dhe të dobishme dhe që përmirësohen herë pas here. Kjo u vërejt më parë nga Dept, etj. (2010).

PISA dhe TIMSS kanë zhvilluar dhe zbatuar një sistem verifikimi të përkthimit. Kërkimi zbuloi se verifikimi i përkthimit është një aktivitet i institucionalizuar, i standardizuar, i strukturuar dhe i dokumentuar. Prosesi i verifikimit përfshin: kontrollin e saktësisë gjuhësore të përkthimit dhe të përshtatjes së testeve dhe të pyetësorëve; dokumentimin e çdo devijimi të versioneve kombëtare nga ato ndërkombëtare; sugjerimin e përkthimeve/përshtatjeve të tjera që e përmirësojnë saktësinë dhe krahasueshmërinë e versioneve kombëtare. Prosesi i verifikimit të përkthimit të PISA-s dhe të TIMSS-it rezultoi të jetë një mekanizëm thelbësor për sigurimin e cilësisë. Verifikimi i përkthimit është përgjegjësi e qendrave të kontrollit të cilësisë gjuhësore që bashkëpunojnë me PISA dhe TIMSS. Kontrolli i cilësisë gjuhësore si një element i politikës së sigurimit të cilësisë të përkthimit të PISA-s dhe të TIMSS-it synon të vlerësojë saktësinë e përkthimit, justifikimin dhe përshtatshmërinë e çdo përshtatjeje kulturore dhe krahasueshmërinë e paraqitjes së instrumenteve të vlerësimit. Mbështetur në këtë qëllim, PISA dhe TIMSS kanë përpunuar metodologjinë e metrikës së gabimeve, duke synuar praktikisht të identifikojnë gabimet e përkthimit nga ato të thjeshtat deri te ato më të vështirat dhe të përmirësojnë cilësinë.

Duke analizuar veprimtarinë e PISA-s dhe të TIMSS-it në fushën e politikës së sigurimit të cilësisë, kemi arritur në këto përfundime kryesore:

- PISA dhe TIMSS kanë zhvilluar kornizën e politikës së përkthimit që përmban qëllime, parime, standarde dhe procedura.
- PISA dhe TIMSS kanë zhvilluar një metodologji të avancuar përkthimi.
- PISA dhe TIMSS kanë zbatuar parimet bazë të cilësisë së përkthimit, si: vlerësimi i përkthyeshmërisë; sigurimi i cilësisë; kontrolli i cilësisë; monitorimi i cilësisë, duke i pasuruar ato me përvojën e përkthimeve arsimore.
- Duke analizuar dokumentet e përkthimit dhe të përshtatjes, të përdorura nga PISA dhe TIMSS, u vu re se udhëzimet e përkthimit dhe të përshtatjes së PISA-s janë më gjithëpërfshirëse, ndërsa të TIMSS-it janë më të shkurtëra dhe më të përgjithshme.
- Bazuar në shkëmbimin e përvojave dhe gjetjeve të studimeve të tyre, PISA dhe TIMSS po kalojnë nga politika të ndryshme përkthimi në politika të ngjashme.

Modele dhe procedura të përkthimit, përshtatjes dhe verifikimit të cilësisë së instrumenteve të vlerësimit të PISA-s dhe TIMSS-it

PISA dhe TIMSS kanë përpunuar dhe përdorur modele dhe procedura të përkthimit, përshtatjes dhe verifikimit të cilësisë së përkthimit, të cilat janë një vlerë e shtuar në fushën e sigurimit të cilësisë së përkthimit.

PISA përdor katër modele për sigurimin e cilësisë së përkthimit të testeve, pyetësorëve dhe manualeve.

1. Modeli i përkthimit të dy versioneve paralele burimore ndërkombëtare nga gjuha angleze dhe gjuha frënge të cilat bashkohen në një version kombëtar. Përveç kësaj, bëhet dhe një verifikim i pavarur i barasvlerës midis versionit në anglisht dhe frëngjisht duke përdorur të njëjtat procedura verifikimi si për verifikimin e të gjitha versioneve të tjera kombëtare.
2. Modeli i përkthimit të dyfishtë të versionit ndërkombëtar në gjuhën angleze nga dy përkthyes dhe prodhimi i një versioni kombëtar nga një person i tretë, duke bërë edhe kontrollin e kryqëzuar me versionin në gjuhën frënge.
3. Modeli i tretë ofron mundësinë e përkthimit të dyfishtë të versionit burimor ndërkombëtar në gjuhën angleze nga dy përkthyes dhe krijimin e versionit kombëtar nga një person i tretë.
4. Modeli i përgatitjes së versionit burimor të instrumenteve përmes vlerësimit të përkthyeshmërisë. Vlerësimi i përkthyeshmërisë qëndron në paraqitjen e varianteve të pyetjeve të reja para një grupi gjuhëtarësh me përvojë që mbulojnë një gamë të gjerë grupesh gjuhësore dhe ndihmon për të identifikuar dhe përshkruar sfidat e përkthimit dhe të përshtatjes me të cilat mund të përballen përkthyesit nëse nuk do të ndërmerren veprime parandaluese. Pas identifikimit të problemeve të mundshme hartohet raporti i përkthyeshmërisë e më pas vendoset nëse pyetje të caktuara duhen ndryshuar apo hequr fare nga testi apo pyetësori.

PISA ka rekomanduar përdorimin e modelit të parë të përkthimit, por ka pranuar edhe përdorimin e modelit të dytë dhe të tretë. Avantazhet e modelit të parë janë disa dhe ato janë paraqitur mjaft qartë nga Grisay (2003). Përvoja e përkthimit të instrumenteve të vlerësimit të PISA (2000) në Shqipëri me modelin e parë, sipas Liçi (2022), dëshmon dobinë e rekomandimit të Grisay.

TIMSS përdor modelin e përkthimit të një versioni ndërkombëtar nga gjuha angleze dhe shqyrtimin e tij nga një redaktor. Ndërsa përkthimin e dyfishtë e përdor për rastet e përshtatjes. Qendra Ndërkombëtare e Studimeve TIMSS & PIRLS përgatit versionet ndërkombëtare të instrumenteve të vlerësimit që përdor TIMSS në gjuhën angleze. Pas publikimit të versioneve burimore ndërkombëtare, të gjitha vendeve pjesëmarrëse u kërkohet të përkthejnë dhe/ose të përshtatin versionet ndërkombëtare në gjuhën(t) e tyre. Në mënyrë që të sigurohet barasvlera e instrumenteve kombëtare të përkthyer me versionet ndërkombëtare, ekspertët gjuhësorë dhe vlerësuesit bëjnë rishikime të shumta bazuar në versionin burimor ndërkombëtar në gjuhën angleze.

Përshtatja është përdorur si një proces që siguron cilësinë. Duke qenë se tekstet e testeve dhe pyetësorët e PISA-s dhe TIMSS-it kanë origjinë të ndryshme dhe ato mund të krijojnë situata të disfavorshme për nxënësit e vendeve dhe kulturave të ndryshme, është parë e nevojshme që disa fjalë, shprehje, simbole apo koncepte të caktuara të përshtaten nga vetë vendi që i administron këto instrumente në mënyrë që ato të jenë sa më familjare për personat që do marrin pjesë në studim. Në rastin e TIMSS-it, pas fazës së përkthimit dhe të përshtatjes, IEA bën të mundur që materialet e përkthyer dhe të përshtatura të secilit vend t'i nënshtrohen verifikimit të përkthimit, kryesisht, në nivel kombëtar.

Gjatë administrimit të studimit të PISA-s, verifikimi i materialeve të përkthyer kryhet nga një ekip ndërkombëtar i pavarur verifikuesish, ekspertë të cApStAn⁴⁸. PISA përdor modelin e Metrikës Shumëdimensionale të Cilësisë (MQM). Bazuar në këtë model, PISA përdor 14 kategori të ndërhyrjeve për verifikimin ndërkombëtar të cilësisë së përkthimit. TIMSS ka zbatuar metodologjinë metrike të gabimeve bazuar në “llojin e kodeve” dhe “kodet e saktësisë”. Kodet e përdorura gjatë procesit të verifikimit janë krijuar për të ndihmuar në krijimin e një cilësie dhe krahasueshmërie të materialeve të përkthyer/përshtatura dhe mundësojnë një proces të standardizuar të verifikimit në të gjitha vendet pjesëmarrëse. Raportet teknike të PISA 2003, 2006, 2009, 2012 dhe TIMSS 2015, 2029 dëshmojnë se verifikuesit kanë identifikuar gabime që do të kishin ndikuar seriozisht rezultatet e testimit.

Duke qenë se cilësia e përkthimit është një çështje komplekse, PISA dhe TIMSS po përballen me disa sfida që lidhen me bashkëpunimin midis të gjithë aktorëve të përfshirë në cilësinë e përkthimit; me sigurimin dhe ruajtjen e barasvlerës së përkthimit dhe me dixhitalizimin e procesit të sigurimit të cilësisë së përkthimit.

Kërkimi arriti në këto përfundime lidhur me metodologjinë e sigurimit të cilësisë së përkthimit të zbatuar nga PISA dhe TIMSS.

- PISA dhe TIMSS kanë disa përvoja të ndryshme në lidhje me metodologjinë e përkthimit, përshtatjes dhe të verifikimit të cilësisë së përkthimit.
- PISA ka zhvilluar më tej teorinë dhe praktikën e cilësisë së përkthimit duke eksperimentuar modelin e përkthimit nga dy versione burimore paralele ndërkombëtare.
- PISA dhe TIMSS kanë përpunuar modelin e përshtatshmërisë së përkthimit.
- PISA dhe TIMSS kanë kontribuar në ndërtimin e modeleve të dokumentimit të përkthimit, përshtatjes dhe të verifikimit.

⁴⁸ Ofrues i shërbimit gjuhësor të profilit të lartë

- PISA dhe TIMSS përdorimin metrika të ndryshme të matjes së gabimeve. Por, nga viti 2007 pjesërisht dhe 2011 kryesisht, TIMSS është në bashkëpunim me cAPStAn dhe duke qenë nën ndikimin e kësaj kompanie të kontrollit të cilësisë gjuhësore po përdor një metodologji të përzier metrike të gabimeve.
- Procesi i verifikimit të PISA-s dhe të TIMSS-it është një aktivitet i institucionalizuar dhe i strukturuar.

Përmbyllje

Nëpërmjet politikave dhe procedurave të vlerësimit të cilësisë së përkthimit, PISA dhe TIMSS kanë synuar të arrijnë barasvlerën e përkthimit në përputhje me specifikimet e cilësisë. Pavarësisht dallimeve ndërmjet sistemit të sigurimit të cilësisë së përkthimit të PISA-s dhe TIMSS-it, procedurat e tyre të përkthimit, të përshtatjes dhe të verifikimit kanë qenë të suksesshme dhe kanë përmirësuar cilësinë e përkthimit të instrumenteve ndërkombëtare të vlerësimit në arsim, gjë që ka mundësuar të dhëna të krahasueshme të testeve dhe rezultate të vlefshme vlerësimi.

Vlen të theksohet se PISA dhe TIMSS po japin kontribut të rëndësishëm në fushën e përkthimit duke e pasuruar teorinë dhe praktikën e sigurimit të cilësisë së përkthimit me politika dhe metodologji të cilat mund të përdoren jo vetëm në përkthimet arsimore, por edhe në përkthime të fushave të tjera.

Bibliografia

- Dept, S., Ferrari, A., & Wäyrynen, L. (2010). Procedures in Three Multilingual Assessments: A Plea for an Integrated Translation and Adaptation Monitoring Tool. In: Harkness, J. et al., ed., *Survey Methods in Multinational, Multiregional and Multicultural Contexts*. John Wiley & Sons, Hoboken, NJ, f.157-173.
- Dept, S., Ferrari, A., & Wäyrynen, L. (2010). Developments in Translation Verification Procedures in Three Multilingual Assessments: A Plea for an Integrated Translation and Adaptation. In: Harkness, J. et al., ed., *Survey Methods in Multinational, Multiregional and Multicultural Contexts*. John Wiley & Sons, Hoboken, NJ, f.157-173.
<https://doi.org/10.1002/9780470609927.ch9>
- Dept, S. *Translatability Assessment of Draft Questionnaire Items*. 5th Conference of the European Survey Research Association (ESRA), Ljubljana, July 16, 2013.
- Grisay, A. (2003). Translation procedures in OECD/PISA 2000 international assessment, *Language Testing*, 20 (2), f. 225-240.
- Instrument Translation and Layout Verification for TIMSS 2019.
- Korsnakova, P., Dept, S. & Ebbs, D. (2020). Translation: The Preparation of National Language Versions of Assessment Instruments. In: Wagenaker, H. (ed). *Reliability and Validity of International Large-Scale Assessment*. IEA Research for Education. f. 85-110.
https://doi.org/10.1007/978-3-030-53081-5_6
- Liçi, L. (2022). *Probleme të barasvlefshmërisë së përkthimit të testeve ndërkombëtare të arritjeve në gjuhën shqipe*, f. 219.
- Martin, M. O., Rust, K., & Adams, R. J. (Eds.). (1999). *Technical standards for IEA studies*. Amsterdam, the Netherlands: IEA, f.43. Retrieved from <https://www.iea.nl/publications/iea-reference/technical-standards-iea-studies>.

- Maxwell, B. (1996) “Translation and Cultural Adaptation of the Survey Instruments” in M.O. Martin and D.L. Kelly (eds.), Third International Mathematics and Science Study (TIMSS) Technical Report, Volume I: Design and Development. f. 8-1. Chestnut Hill, MA: Boston College.
- PISA 2012 *Translator’s User Guide to The Open Language Tool (OLT)*.
- PISA 2018 *Technical Report* Chapter 2.
- PISA 2018. Translation and adaptation guidelines. Produced by cApStAn and Béatrice Halleux under the supervision of ETS, Core A and Core D Contractors, f.1.
- PISA. *Translation and Verification Report 2012*. Field trial. (August, 2011)
- TIMSS. (2020). Instrument translation and Layout Verification for TIMSS 2019. In: Martin, O.M., Davier von M., & Mullis, S.V. I., ed., *Methods, and procedures: TIMSS 2019 Technical report*. TIMSS & PIRLS International Study Centre, f. 5.3.
- TIMSS. Methods and Procedures: TIMSS 2019. Technical Report.
Translatability Assessment of Draft Questionnaire Items 5th Conference of the European Survey Research Association (ESRA), Ljubljana, July 16, 2013.

Majlinda Sommer LL.M., Göttingen

Titulli: Sfidat që dalin gjatë përkthimit të dokumentave ligjore nga gjermanishtja në shqip.

Abstrakt

Në këtë punim do të përpiqem të hedh dritë mbi sfidat gjuhësore dhe kulturore gjatë përkthimit të teksteve juridike nga gjermanishtja në shqip, duke u mbështetur në literature juridike, literature nga fusha e përkthimit, gjuhësisë dhe përvoja ime si përkthyes në drejtësinë gjermane. Gjuha juridike dallohet nga ajo standarde në disa pika thelbësore, të cilat do t'i paraqes përmbledhtas në këtë punim. Sistemet ligjore të vendeve të ndryshme ndryshojnë shumë dhe po ashtu dokumentacioni i vecante ligjor nga ku si bazë për këtë analizë janë dy kontrata shitjeje njëra që praktikohet në Shqipëri dhe tjetra në Gjermani që paraqesin edhe dy tradita juridike të ndryshme dhe shpesh bëhen burim i keqkuptimeve dhe gabimeve (p.sh. në kuptimin e koncepteve pasuri dhe posedim). (Pürner, 2003, fq. 8) Dy kontratat tregojnë gjithashtu se gjuha juridike nuk duhet parë e izoluar, por duhet parë në sfondin e dallimeve të qarta në traditën juridike dhe kulturën juridike. Këto dallime përfshijnë aspekte të tilla elementare si zakone të ndryshme në lidhje me dokumentacionin e shkruar. Përkthimet kërkojnë gjithashtu një shkallë të lartë saktësie dhe lejojnë pak fleksibilitet në zgjedhjen e fjalëve. Ky punim synon nga njëra anë që gjyqtarët, të cilët shpallin vendimet në emër të popullit (Weidel, 2023, fq.1-5), duhet ta bëjnë këtë në një gjuhë deri diku të kuptueshme për popullin dhe nga ana tjetër, tradita e shkruar juridike e Shqipërisë është e paplotë në disa vende (Stoppel, 2003, fq. 345-346), dhe këtu është e rëndësishme që të mbyllet boshllëqet në të ardhmen. Së fundi duke u nisur nga njohuritë e mia në këtë fushë dhe përvoja do të jap disa rekomandime për shmangien e këtyre problematikave dhe realizimin e një komunikimi të arrirë në këtë fushë.

Fjalë kyçe: sfidë, përkthim, gjuhë juridike, kulturë juridike, kuptueshmëri, gjermanisht, shqip.

Hyrje

Mësimi i gjuhëve është i vështirë, përkthimi i tyre është një proces kompleks. Përkthimi i teksteve juridike paraqet vështirësi, sepse dallohet nga gjuha standarde dhe në përkthimin e teksteve juridike nuk mjafton vetëm njohja e mirë e gjuhës gjermane e shqipe, por përkthyesi duhet ta njohë mirë fushën juridike dhe terminologjinë e përdorur në të. Sa i vështirë është fakulteti i drejtësisë në Gjermani e tregojnë dhe statistikat: ku 30 % e studentëve të juridikut në këtë vend e ndërpresin shkollën. (Fischer, 2022, fq. 85)

Në fillim të studimeve në Universitetin e Göttingenit u këshilluam nga një profesor i të Drejtës Publike që një student i mirë në drejtësi duhet të lexonte të paktën 100 faqe në ditë literaturë juridike për t'u përshtatur me terminologjinë juridike.

Gjuha ligjore

Sipas (Weidl, 2023, fq.1-5), një nga tiparet më të habitshme të gjuhës juridike janë kuptimet e fjalëve që devijojnë nga gjuha standarde, disa prej të cilave janë relike të zakoneve gjuhësore të kohëve të shkuara.

Kështu mbiemri „billig“ “i lirë” në përdorimin e përditshëm i referohet çmimit të ulët të një produkti, por në gjuhën juridike përgjithësisht pranohet se korrespondon me kuptimin natyror të drejtësisë „billige Strafe“ dënim i përshtatshëm, pra në kontekstin juridik ka kuptimin “e përshtatshëm”.

Ndoshta gjuha juridike në dallim me atë të përditshmen është më hermetike, konservatore në ndryshime (Fischer 2022, fq. 88), prandaj kemi përdorimin e vazhdueshëm të termave të vjetëruar (“fernmündlich” në vend të “telefonisch” me telefon; “Abschrift” në vend të “Kopie” që do të thotë kopje).

Po ashtu për t’u theksuar është tendenca si në gjuhën standarde dhe në këtë juridike madje më e theksuar për të formuar emra të përbërë (Komposita), të cilat janë bërë objekt i humorit nga Mark Twain. (LeMaster & Wilson, 1993, fq. 57) Emrat e përbërë kanë një ngarkesë më të madhe semantike dhe përdorimi i tyre shmang fjalitë e nënrenditura shpjeguese. Nëse kemi fjali më të gjata, kemi vështirësi në gjetjen e referuesve të kallzuesit dhe të kryefjalës dhe në kuptimin siç duhet të rrjedhës së mendimit.

Ajo që vihet re gjithashtu është një grumbullim ndërtimesh gjinore pasive, të ndërthurura me përcjellore nga ku fjalia prek kufijtë e kuptueshmërisë dhe rrjedhimisht përkthyeshmërisë (Weidl, 2023, fq. 1-5). Kush përfiton nga mos të kuptuarit? Përderisa gjyqtarët i shpallin vendimet në emër të popullit, duhet që ti shpallin ato në një gjuhë të kuptueshme për popullin. (Weidl, 2023, fq.1-5)

“Pengesat gjuhësore ndërmjet juristëve dhe personave pa njohje në fushën juridike mund të dëmtojnë zbulimin e së vërtetës”(Weidel, 2023, fq.1-5) nga njëra anë. Nga ana tjetër, kuptueshmëria nxit pranimin. (Weidl, 2023, fq. 1-5)

Në këtë drejtim, materialet që pasqyrojnë administrimin e drejtësisë dhe shpjegojnë gjuhën ligjore janë të mirëseardhura, si ato të ish-gjyqtarit federal Thomas Fischer .(Fischer, 2022)

“Shumica e njerëzve në Gjermani nuk e dinë se si dhe pse funksionon e drejta”. (Fischer, 2022 fq. 91)

Tradita juridike si pjesë e gjuhës dhe ligjit.

Gjuha shqipe për një kohë të gjatë kishte një shkallë të ulët të shkrim-leximit. Në vitin 1939 ishin 90 % e shqiptarëve analfabetë(Stoppel, 1993, fq. 244). Gjuha shqipe ishte më shumë një gjuhë popullore me tradita të së drejtës zakonore të transmetuara gojarisht, në ndryshim nga sundimi i huaj osman shumëshekullor, kryesisht turqishtfolës. (Stoppel, 2003, fq. 345)

Vetëm në vitin 1887 u hap shkolla e parë në gjuhën shqipe. Përveç kësaj, gjuha shqipe ishte e ndarë në disa dialekte. Shqipja nuk përjetoj bashkim të hershëm ose të paktën harmonizim si në gjermanishten e re të hershme përmes Biblës Luter të vitit 1522. Përveç kësaj, pati një rezistencë të konsiderueshme ndaj shkrimit në vetvete. (Diner, 2010, fq. 107-144) Në Perandorinë Osmane u prezantua shtypja e librave 300 vjet më vonë. (Clogg, 1979, fq. 67)

Megjithëse shkalla e shkrim-leximit u përmirësua ndjeshëm gjatë sundimit komunist, orientimi ideologjik i dhënies së drejtësisë dhe heqja e avokatëve nuk e përmirësoi besimin në sistemin ligjor të shtetit. (Stoppel, 1993, fq. 248-249), (Stoppel, 2003 fq. 346)

Përveç kësaj, kanë kaluar vetëm 33 vjet nga përmbyjsja e sistemit dhe për shumë vite ka pasur shumë vështirësi si në organizimin e shtetit ashtu edhe në sistemin gjyqësor, dhe shumë institucione kanë ende vështirësi në formatimin e ligjeve dhe zbatimin e tyre.

Pavarësisht nga të gjitha ndryshimet politike dhe ndryshimet e sistemit, ka pasur një traditë të pandërprerë të pronës private në Evropën Perëndimore të paktën që nga Mesjeta e Lashtë (Stoppel, 1993, fq. 243), si një forcë shtytëse thelbësore për zhvillimin e sistemit ligjor. (Origo, 1986, fq.119)

Reformat në sektorin fetar i kanë forcuar dhe jo dobësuar këto tradita të hershme kapitaliste. (Weber, 1995, fq. 333) Reformacioni dhe gjuha e shkruar përforcuan njëra-tjetrën, në kundërshtim me këtë, Perandoria Osmane e pengoi shkrimin. (Clogg, 1979, fq. 67) Vetëm pas themelimit të shtetit në vitin 1912 u bënë disa përpjekje për krijimin e kadastrave dhe organizimin e strukturave të pronësisë. Faza e sundimit komunist e solli këtë në ngërç. Që nga ndryshimi i sistemit në vitin 1990, disa harta kadastrale kanë konkurruar me njëra-tjetrën, duke e bërë më të vështirë njohjen e pronës private dhe duke i hapur derën korrupsionit.

“Ligji nuk është autonom, është një nënfushë në kontekstin më të gjerë të një kulture dhe nuk mund të kuptohet pa komponentët e tjerë të saj”. (Hattenhauer, 1980, fq.183)

Përqasja shqip-gjermanisht e dy kontratave të shitjes

Një kontratë tipike për blerje apartamenti nga Shqipëria përbëhet nga tri faqe, një shembull kontrate e krahasueshme në Gjermani ka të paktën 14 faqe.

Gjatë përqasjes së të dy kontratave do të konstatojmë si më poshtë:

[Tabelen 1 ketu.] [Legjende: Krahasimi ne strukturat baze te dy kontratave shitjeje]

-Versionit shqip i mungon harmonizimi i përmbajtjes ligjore kombëtare në përputhje me tekstet ligjore të Bashkimit Europian në përgjithësi dhe Gjermanisë në veçanti. Kështu masat e sigurisë për të mbrojtur blerësit dhe shitësit, janë në një sfond të zbehtë.

-Përmendet çmimi i blerjes, por mungojnë detajet në lidhje me pagesën. Në vend të kësaj, ekziston një shënim se pagesa është bërë *“para redaktimit të kësaj kontrate dhe jashtë kësaj zyre noteriale”* dhe *“të dyja palët deklaruan se nuk kishin pretendime të mëtejshme në lidhje me çmimin dhe mënyrën e pagesës”*.

-Mungon informacioni për çdo rezervim në regjistrin e kadastrës, p.sh „Rezervimi për të siguruar kërkesën për kalimin e pronësisë“ njoftimi i datës së caktuar ose një llogari ruajtjeje noteriale. Nëse prona është aktualisht bosh apo e marrë me qira dhe cilat të drejta dhe detyrime lindin nga një qira e mundshme, mbeten të papërmendura, gjithashtu dhe shpjegimet e bashkësisë së pronarëve.

Struktura e një kontrate ne gjermanisht është e perpiluar ne § (Paragrafe), ndryshe nga kontrata ne shqip qe është e nendare ne (Nene). Ne terminologjine juridike gjermane fjala Artikel (Neni), perdoret vetem ne numerimin e Grundgesetz (Ligji baze gjerman dhe kushtetutat e Landeve).

Ne kontraten ne gjermanisht shihet qe jane shume paragrafe ku perkthyesi duhet ta kuptoje permbajtjen e tekstit shume mire dhe sfida është ne korrektesen e perkthimit dhe gjetjen precize te fjaleve, ku mundesia ne fleksibilitetin per zgjedhjen e fjaleve është shume e pakte.

Perkthyesi eshte ne tension te vazhdueshem ne lidhje me afatin per dorezimin e dokumentit.

“Por gjuha duhet të zbulojë atë që është e dobishme dhe e dëmshme, si dhe çfarë është e drejtë dhe e padrejtë”. (Aristoteles, Politik, I,2 fq.1)

Propozime për ndryshime

Jo vetem qe sistemet juridike nuk jane unike, por ato gjithashtu jane gjithmone ne zhvillim. Kjo nenkupton qe ne perfundim te afatit kohor te perkthimit, ligjet qe ishin ne fuqi nje jave apo muaj me pare mund te mos jene me te zbatueshme, qe do te thote qe perkthyesit ligjor duhet te jene vazhdimisht te perditesuar per zhvillimet me te reja (Lingual Consultancy Services, 2023, fq.1).

Por nga ana tjetere eksperiencat e reja qe sjellin zvizimin ne transparence dhe luftojne informalitetin ne ekonomine e tregut duhen te jene te mirepritura ne Shqiperi.

Një ndryshim që duhet bërë, është ndalimi i pagesave me para në dorë. Këtu kemi një dallim thelbësor me Gjermaninë apo vendet e BE. Në Gjermani, pasuritë e paluajtshme nuk mund të paguhen me para kesh, ar, argjend, diamante ose kriptomoneda. Noteri duhet të sigurojë që të sigurohen dëshmitë e duhura të bërjes së pagesës pa para. Ajo që është e habitshme është se sa kohë ka që është në fuqi kjo rregullore, domethënë vetëm që nga prilli 2023.

Në praktikën e pagesës kesh në tregun e pasurive të paluajtshme ka patur shumë vite kritika, ndonjëherë të ashpra, veçanërisht nga njësitë speciale italiane antimafia. (Zydra, 2019, fq.1) (Knight, 2023, fq.1)

Gjermania ka një një ndryshim rrënjësor në praktikën aktuale të vendosur, pavarësisht shqetësimeve të izoluara kushtetuese të shprehura. (Thelen, 2023, fq.1) Ky është një shembull i qartë i presionit për ndryshim që vjen me anëtarësimin në një kuadër të madh ligjor siç është Bashkimi Evropian. Edhe shteti më i madh anëtar nuk mund t'i rezistojë këtij presioni për ndryshim në planin afatgjatë.

Rrjedhimisht, shembulli te kontrata e blerjes e sipërpërmendur përmban deklarata mbi Ligjin për pastrimin e parave.

Keqkuptime dhe boshllëqe

Termet nga fusha e së drejtës dhe e së drejtës krahasuese, gjuhësia e aplikuar, studimet e përkthimit, dhe terminologjia synojnë të kontribuojnë në përpunimin shkencor të përkthimit të teksteve juridike dhe të mundësojnë njohuri të thelluara.

Për shkak se në kontratën shqip ka boshllëqe në gjuhën juridike, në praktikën juridike mund të hasësh gjithashtu keqkuptimin dhe mund të gabosh në përkthim (p.sh. në të kuptuarit ndoshta të koncepteve të shkruara „Besitz“ (posedim) dhe „Eigentum“ pronë. (Pürner, 2003 fq. VIII)

Termi juridik „Auflassen“ (deklarim i ndërsjelltë i qëllimit) i referohet një marrëdhënie juridike midis dy personave (fizikë ose juridikë) në një kontratë shitje në pasuritë e paluajtshme. Ndërsa në gjuhën e përditshme, do të thotë „auflassen“ lë hapur (p.sh lë derën hapur).

Praktika ligjore duket se ende të paktën pjesërisht karakterizohet nga marrëveshje verbale që mbeten të pashkruara dhe që mungojnë në kontratë (kontrata e shitjes shqip). Shkrimet juridike të Shqipërisë

janë të paplota në disa vende. (Stoppel, 2003, fq.345-346) Dhe këtu është e rëndësishme të mbyllet boshllëqet në të ardhmen.

Ajo që konstatohet në këtë përjasje të dy kontratave janë edhe boshllëqet në fushën lëndore. Zhvillimi ekonomik social pasqyrohet nga njëra anë në zhvillimin e gjuhës juridike dhe nga ana tjetër në kuptimin dhe transmetimin e saj. Ndjehet mungesa e besimit qytetar në shtet për sigurinë e pronës. Apo ndoshta është e vështirë të vendoset besimi në institucione pas 500 vjetësh të sundimit të huajt?

Mungesa e dokumentacionit të shkruar për pikat thelbësore do të thotë se është e vështirë për të huajt të kenë akses në prona në Shqipëri. Në të ardhmen, është e rëndësishme të zëvendësohet besimi në klan (familje të gjerë) me besimin në veprimet e qeverisë. (Stoppel, 1993, 244)

Këshilla

Duke u bazuar në njohuritë dhe përvojën time, do të përpiqem të jap disa këshilla se si mund të shmangen këto probleme dhe të arrihet një komunikim i suksesshëm në këtë fushë.

- Përvetësimi si duhet i të dyja gjuhëve standarte (shqipe dhe gjermane), si dhe njohja shumë mirë e fushës juridike, terminologjisë së saj.
- Harmonizim të dokumentacionit ligjor individual kombëtar shqiptar në përputhje me tekstet ligjore të Bashkimit Europian duke mundësuar lidhjet ekonomike me të ngushta nëpërmjet vendeve dhe në rastin konkret Shqipëri- Gjermani .
- Mbledhjen e praktikave në fushën e përkthimit të teksteve juridike dhe shëndërrimin e tyre në një urë komunikimi ndërmjet dy gjuhëve.

Përfundimet

Një përkthyes duhet të marrë shumë përgjegjësi për të transmetuar gjuhën, që nuk do të thotë që vetëm ta njohë atë po të ketë dhe kualifikimin e duhur, dhe të jetë në kontakt të përditshëm me leximin.

Sikurse nga krahasimi që u bë në kontratat e shitjes (Gjermanisht -shqip) shihet që një kontratë gjermane krahas numrit të faqeve (ku përmbledhen §20-paragrafe) ka vështirësi në përkthim dhe përkthyesi duhet të ketë njohuri të thelluara për të përket terminologjisë juridike gjermane.

Një përkthyes ligjor duhet të jete në kualifikim mëtejshëm në fushën juridike në mënyrë që të jetë në gjendje të përkthejë tekstet ligjore në mënyrë të përshtatshme, saktë dhe pa gabime. Përkthyesit duhet të kenë parasysh zhvillimin ende jo të plotë të ndërgjegjësimit ligjor publik në shoqërinë civile shqiptare. Në të njëjtën kohë, çdo përkthim i mirë kontribuon në zhvillimin e mëtejshëm të ndërgjegjësimit ligjor publik.

Bibliografi

Boase-Beier, Jean., Fisher, Lina., Furukawa, Hiroko., *The Palgrave Handbook of Literary Translation*, Palgrave Macmillan, 2018.

Aristoteles: <https://www.projekt-gutenberg.org/aristote/politik/chap002.html>, shikuar më 10.11.2023.

Clogg, Richard. „An Attempt to Revive Turkish Printing in Istanbul in 1779“, ne: *International Journal of Middle East Studies*, Bd. 10, Nr. 1 (1979).

- Diner, Dan. Schrift und Sprache. Über die sakrale Abweisung des Buchdrucks. ne: Diner, Dan. Versiegelte Zeit. Über den Stillstand in der islamischen Welt. Berlin: Ullstein 2010.
- Fischer, T. Recht haben. München: Droemer 2022.
- Halili, D. Rechtswörterbuch Deutsch-Albanisch Albanisch Deutsch /Fjalor juridik gjermanisht-shqip, shqip-gjermanisht . Hamburg: Buske 2003.
- Hattenhauer:1980:183 cituar në: Marin S, Kultur und (Rechts)sprache.
- Knight, B. (2023, 05/06/2023). Why the mafia loves Germany. Deutsche Welle. Retrieved abgerufen 12.11.2023 from <https://p.dw.com/p/4QvëY>.
- Kontratë shitje gjermanisht (shembull).
<https://notar-bober.de/wp-content/uploads/2021/01/Merkblatt-Kaufvertrag.pdf>
- Kontratë shitje shqip, shikuar më datë 15.09.2023.
https://www.google.de/url?sa=t&rct=j&q=&esrc=s&source=web&cd=&ved=2ahUKEwilncK_JËCAxËK5KQKHb0MAVoQFnoECCMQAQ&url=https%3A%2F%2Fexit.al%2Fëp-content%2Fuploads%2F2019%2F01%2FVangjel-Prela-kontrate-blerje-Ap.-Durres.pdf&usg=AOvVaë1viëieGVN368JZGqbb0g-X&opi=89978449
- LeMaster, J. R.; Wilson, James D., eds. (1993). "The Awful German Language". The Mark Twain Encyclopedia. Routledge.
- Origo, Iris. The Merchant of Prato: Francesco Di Marco Datini, 1335-1410: Francesco Maria Di Marco Datini, 1335-1410. Editor: David R. Godine Publisher Inc; Reprint Edition (1. Juni 1986) ISBN-10: 0879235969.
- Pürner 2003 në: Halili, D. Rechtswörterbuch Deutsch-Albanisch Albanisch Deutsch/ Fjalor juridik gjermanisht-shqip, shqip-gjermanisht. Hamburg: Buske 2003.
- Stoppel, Wolfgang. Rechtssystem. në: Grothusen, KD. Südosteuropa-Handbuch, Vol.7, Albanien. Göttingen: Vandenhoeck & Ruprecht 1993.
- Stoppel, Wolfgang. Das albanische Recht im Überblick. ne: Halili, D. Rechtswörterbuch Deutsch-Albanisch Albanisch Deutsch/ Fjalor juridik gjermanisht-shqip, shqip-gjermanisht. Hamburg: Buske 2003.
- Thelen, Martin Barzahlungsverbot bei Immobilienkäufen: Ein Verstoß gegen den Gleichheitsgrundsatz? . Ne: Legal Tribune Online, 27.03.2023 , https://www.lto.de/persistent/a_id/51407/ (shikuar më datë: 27.10.2023).
- Zydra, Markus Darum fühlen sich Geldwäscher ne Deutschland wohl. Süddeutsche Zeitung vom 26.10.2019. (marrë me datë: 27.10.2023).
- Weber, M. (1995). Die protestantische Ethik und der Geist des Kapitalismus. In M. Sukale (Ed.), Max Weber. Schriften zur Soziologie. Reclam.
- Weidl, Katharina: Geht es nicht einfacher? Warum Juristen kompliziert schreiben. Frankfurt: Frankfurter Allgemeine Zeitung. 23.05.2023.
- The top 5 Challenges of Translating Legal Documents (and How to Overcome Them!)
Posted on January 17, 2023
By Lingual Consultancy Services <https://lingualconsultancy.com/blog/top-5-challenges-of-translating-legal-documents> accessed December 12, 2023

Dr. Alketa Pema (Thanasko)

Universiteti i Tiranës

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

Departamenti i Gjuhës Angleze

alketa.pema@unitir.edu.al

Prof. Assoc. Dr. Marsela Harizaj

Logos University, Tirana

marselahaarizaj@yahoo.com

Titulli: Të përkthyerit e Uitman përmes një skeme destruktive (Translating Whitman through a Deconstructive Theory)

Abstrakt

Me anën e këtij punimi synojmë të shpjegojmë një skemë dekonstruktive (SIQ) për përkthimin e poezisë, dhe me pas të analizojmë efektin e kësaj skeme në përkthimin në shqip të disa poezive të Uolt Uitman-it. SIQ konsiderohet si një skemë që ndihmon përkthimin, ku kuptimi shihet si një efekt tekstual i pashtershëm, i cili me shpjegimin e tij teorik synon të ndërjegjësojë përkthyesin për kontrollin që duhet të ushtrojë mbi shkallën e aplikimit të rrathëve interpretative dhe rrjedhimisht mbi **rikrijimin** e këtyre rrathëve interpretativë gjatë procesit të përkthimit. Pra, SIQ duhet kuptuar si një skemë përkthimore që duke u bazuar mbi teorinë dekonstruktive, e konsideron kuptimin si efekt tekstual dhe madje edhe pas kalimit ndërgjuhësor pafundësia e efekteve tekstuale të poezisë origjinale dhe përkthimit që i korrespondon mund të përputhen në rreze të gjërë apo të ngushtë. Për më tepër metoda përpiket të rritë ndërjegjësimin e përkthyesit për kontrollin që duhet të ketë mbi shkallën e qarkimit të pafundësisë interpretative gjatë procesit të të përkthyerit.

Fjalë kyç: interpretim, kuptim, pafundësi kuptimesh, poezi, trope.

Hyrje

Të përkthyerit e poezise dhe vecanerisht ai i vargjeve të lira përbën një sfidë të veçantë për vetë faktin se këto vargje paraqiten njëkohësisht si forma me strikte e vargut dhe ndoshta si forma që pranon gjithçka e sidoqoftë. Vargu i lirë konsiderohet si tepër rigoroz, pasi arsyeja fillestare e ekzistencës së tij ishte pamundësia për imitim: thellësia e magjisë së poetit paraqitet në konfiguracione leksikore e lineare që nuk kanë një zanafillë strukturore dhe nuk e kërkojnë atë varësi. Vargje të tilla bëhen të qenësishme vetëm në çastin e krijimit, ose të leximit të tyre.

Duke qenë se poezia mbështetet në shumë mjete kuptim-krijuese (secila prej të cilave në një mënyrë a në një tjetër, lidhet me nocionet e Derrida-s “të gjurmës” dhe “diferencës”) përkthyesi që përdor SIQ përballet me nevojën për të vendosur një hierarki të preokupimeve përkthimore, dhe do të manifestojë prioritetet në dhënien e interpretimeve gjate një përkthimi. Në të njëjtën kohë, kjo hierarki përmban edhe idenë e sakrificës, duke qenë se ruajtja e tipareve tekstuale që shpie në një pafundësi efektsh kuptimore, shumë shpesh do të cojë në humbje të efekteve kuptimore tekstuale diku tjetër (në një nivel tjetër). Do të mbetet në dorën e përkthyesve dhe lexuesve të versionit të përkthyer të

gjykojnë nëse SIQ përbën një mjet përkthimi efikas, apo të dobishëm nga ana procedurale për të bërë hartën e metodave dhe hapave që duhen ndërmarrë gjatë procesit të përkthimit.

SIQ i ka rrënjët thellë tek Dekonstruksioni. Duke qenë se Dekonstruksioni përbën një sistem filozofik gjithëpërfshirës, për të qenë praktikë dhe konçiz, duhet që të përqendrohem ekskluzivisht tek efekti i postulateve të dekonstruksionit mbi përkthimin. Me fjalë të tjera, ky studim nuk ka si objekt një ekspozitë filozofike, por ai synon që mbi një sistem filozofik ekzistues, atë të Zhak Derrida-s, të shpjegojë proceset e përkthimit dhe supozimet konceptuale të përkthyesit që ne shqyrtojmë. Një tjetër autor, të cilit do ti referohemi në artikull, megjithëse jo aq sa Derridas, është Lawrence Venuti. Nacionet e tij të një qasjeje të së njohurës dhe të panjohurës (Foreignizing e domesticating) në përkthim (Venuti, 2004) do të diskutohen për të shpjeguar SIQ. Dhe në fund do të diskutohet teoria e Umberto Eco-s (Eco, 2006) mbi semiozën infinite të bashku me komentet e tij mbi postulatet semiotike të Pierce-it.

SIQ në praktikë

Deri tani, ky studim ka qenë kryesisht induktiv: sikurse është theksuar dhe më parë, metodat SIQ dhe PZM s’janë gjë tjetër veçse formulimet e proceseve dhe supozimeve prej së jashtmi që çojnë në produkte specifike të përkthimit. Tani që veçantitë teorike e operative që qëndrojnë nën këto produkte të përkthimit, janë diskutuar plotësisht, është e mundur të përmbysim qëndrimin deskriptiv të ndjekur deri në këtë pikë në mënyrë që të vlerësojmë tiparet dhe problemet e përkthimit në shqip të poezive të Uitman-it. Duke u përpjekur të organizojmë krahasimet e bëra, do të krahasohen fragmente të vogla të poezive të ndryshme, që reflektojnë efektin e SIQ në aspekte të ndryshme, ose më saktë efektin e PZM-së.




Figura 1 Paraqitja grafike fig.1 (Davis, 2001)

Efektet e PZM mbi konfigurimin poetik formal

Nocioni i Konfigurimit Poetik Formal përdoret për të nënkuptuar vlerën tradicionale e historike, shkallën e përsëritjes dhe vlerësimin kolektiv të rimës e metrikës në traditën poetike të një gjuhe a kulture të veçantë. Sikurse u shpjegua edhe më lart, metoda PZM favorizon krijimin e një “ure interpretative që bën që lexuesit e KK₂ të kenë akses ndaj interpretimeve të veçanta të KK₁, të cilat rezultojnë nga një traditë poetike unike. Kështu, në vend që të kërkojmë ndryshimin apo mutacionin e tipareve formale poetike të poezisë origjinale për ta bërë të përshtatshme me pritshmërinë e udhëhequr nga KK₂ të lexuesit të gjuhës së përkthyer, metoda PZM përpiqet të përsëritë këto tipare sa më tepër të jetë e mundur, duke e detyruar lexuesin e gjuhës së përkthyer ta rikonsiderojë poezinë në terma të ndryshëm nga ato të traditës së vet poetike, duke çuar kështu në pasurimin reciprok të KK₂ e KK₁. Vini re poezinë "*When Lilacs Last in the Dooryard Bloom'd*" (*Kur çeli jargavani vjet ne oborr te porta*) dhe përkthimin që i korrespondon në shqip, duke ndjekur metodën PZM: pj.11

*O what shall I hang on the chamber walls?
And what shall the pictures be that I hang on the walls,
To adorn the burial-house of him I love?*

*Tani ç 'të var në muret e qivurit?
Ç' tablo të zografisura mbi muret
Për të stolisur shtëpinë mortore t'atij që e dua?*

Për publikun shqiptar, të mësuar me një formë të ndryshme të poezisë (me rime e metër të përcaktuar) kjo zor se do të pranohej si poezi me vlera. Do të nevojitej një i mësuar sistematik me llojin e ri të poezisë së Uitmanit përmes përkthimit mjeshtror, shqipërimin të Luarasit.

Për të riprodhuar metrikën e muzikalitetin e rrjedhshëm të poezisë origjinale, përkthimi duhet të bëjë ndryshime të një natyre tjetër: (përzgjedhjen e fjalëve, sinonimeve). Në përgjithësi, shembuj të një riprodhimi strikt të tipareve gjatë procesit të përkthimit do të çojnë domosdoshmërisht në koinçidenca interpretative midis pafundësisë interpretative të origjinalit dhe përkthimit. Ose ndryshe, ndryshime të çdo lloji do të rezultojnë në mundësi semiotike të Kornizës Kulturore. Dmth, natyra për të ruajtur tiparet e huaja të konfiguracionit poetik e versionit të përkthyer- që përsërit formën në varg të lirë dhe metrikën-bën të mundur rritjen e numrit të interpretimeve në infinit. Sidoqoftë, ajo përpiqet për të ruajtur formën poetike të origjinalit i bën të nevojshme disa ndryshime në aspekte të tjera, më të dukshme në zëvendësimin e fjalës dhe shtimin apo heqjen e një fjale tjetër. Ky ndryshim çon në divergjencë në pafundësinë interpretative. Nuk mund të thuhet se zgjedhja e Uitman-it ka qenë e rastësishme, duke qenë se kjo poezi është shkruar me një qëllim të veçantë, në një kohë të mirëpërcaktuar në kulturën amerikane. Por, sikurse thuhet nga Derrida (Derrida, 1967/1978),” subjekti i të shkruarit nuk ekziston nëse nëpërmjet tij nënkuptojmë ekzistencën vetmitare të autorit. Subjekti i të shkruarit është një sistem lidhjesh midis shtresave. Meqë mendimi dekonstruktiv sugjeron se figura e autorit nuk ka vlerë në qëllimet interpretative, mund të nënkuptohet se përkthyesi e ka konsideruar çdo term që presupozon një prezencë hyjnore, pavarësisht nga përkatesia fetare, si të kënaqshme për të rikrijuar efektet kuptimore të poezisë origjinale në përkthimin e tij.

Këto vërejtje mjaftojnë për të qartësuar një fakt të rëndësishëm për SIQ: shumica e perpjekjeve për të riprodhuar efektet kuptimore të poezisë origjinale në një nivel të caktuar – p.sh. në atë po të formës

poetike – përmes metodës PZM do të rezultojë në një qarkim të cilësive të pafundësisë interpretative në një nivel tjetër në përcjelljen e versionit të përkthyer të poezisë.

Efekti i PZM në aspektin morfologjik e etimologjik

Në këtë pikë, lexuesi nuk duhet të befasohej nga fakti se Dekonstruksioni sfidon dhe ripërpunon të menduarit tradicional. Një koncept dekonstruktiv që do të ishte interesant është nocioni i “termave shpërbërës “.”Ta shpërbësh“një fjalë nënkupton ta shohësh atë nga të gjitha prespektivat e mundshme, duke e ndarë në një njësi të brendshme kuptimplote-jo domosdoshmërisht në morfema - duke pikasur gjurmët dhe jehonat që ajo ka mbi fjalë të tjera, duke e shtrydhur deri sa të dalin të gjitha nuancat në një analizë që tregon gjithë efektet kuptimore të saj në kohë. Sidoqoftë, sikurse thuhet nga Kathleen Davis, ”Ne mund të shpërbëjmë konceptet në mënyrë që të depërtojnë tek potenciali i ndryshimit të përfaqësuar apo përjashtuar prej tyre (Davis, 2001). Duke qenë se potenciali i ndryshimit-dhe potenciali interpretativ - i një fjale qëndron tek forma e saj, tek morfologjia e etimologjia e saj, mund të pohojmë se ruajtja e tipareve morfologjike e etimologjike të njësisë leksikore gjatë procesit të përkthimit – deri në atë masë sa që fjalët e poezisë origjinale dhe asaj të përkthyer që po analizojmë, mund të themi se i gjejmë brenda të njëjtit sistem protolinguistik- e rrit mundësinë e pafundësisë interpretative midis poezisë origjinale dha asaj të përkthyer. Le të diskutojmë disa vargje nga poezia “**To think of time**” pjesa 4 dhe përkthimin e saj në shqip:

*He was a good fellow, free-mouth'd, quick-temper'd, not bad-looking,
Ready with life or death for a friend, fond of women, gambled,
ate hearty, drank hearty,*

*Qe burrë i mirë, gojëçliruar e gjaknxehtë,
Gjuhërrëmbyer, i dukur, i zoti në punë, shakaxhi,
Prekej e zemërohej, gati të linte dhe kokën për një mik,
i pëlqenin gratë, lozte kumar, hante e pinte me qejf;*

*Ishte njeri i mirë, fliste lirshëm, nxehej shpejt, nuk ishte i keq për t’u parë,
I zoti në jetë, i zgjuar, i ndjeshëm ndaj shpërfilljes,
Mikun nuk e linte në baltë në ditë me diell, as në ditë me shi, i kishte në qejf gratë, luante bixhoz,
hante me gjithë shpirt, pinte me gjithë shpirt,*

Dy përkthimet e ndryshme në gjuhën shqipe dëshmojnë për morinë e interpretimeve të mundshme të fjalëve në gjuhën shqipe. Sigurisht nuk është e mundur të ruhen të gjitha tiparet morfologjike e etimologjike të gjithë fjalëve brenda poezise, veçanërisht kur kemi për të përkthyer poezitë në varg të lirë të Uitmanit. Pra, metoda PZM e detyron përkthyesin që të përqëndrohet tek aspekti morfologjik e etimologjik i njësisë specifike leksikore, dekonstruksionin (shpërbërjen) e të cilave e konsideron si thelbësore për të evidentuar përputhshmërinë më të madhe të mundshme midis pafundësisë interpretative të poezisë origjinale e asaj të përkthyer. Gjithmonë duke u mbështetur tek diagnoza që ka ndjekur përkthyesi, qoftë me ndërgegjeje, qoftë pa ndërgegjeje- metoda PZM dhe postulatet e saj dekonstruktive, mund të nënkuptohet se përkthyesi konsideron të rëndësishme të riprodhojë tiparet morfologjike e etimologjike të fjalëve të sipër përmendura. Duke patur parasysh bazën teorike të SIQ,

ky preokupim për përputhshmerinë morfologjike e etimologjike midis njësive leksikore të origjinalit me të përkthimit, duhet kuptuar si një mekanizëm nëpërmjet të cilit shpërbërja e disa fjalëve në secilën poezi do të shumëfishojë shanset e krijimit të pafundësisë interpretative, të cilat nuk mund të arrihen nga përdorimi i sinonimeve, dhe as nga termat ekuivalente funksionale, dhe aq më pak nga ndonjë metodë tjetër. Në përpjekjet për të ruajtur këto tipare dalin dy probleme: nga njëra anë ato që rrjedhin nga tendencat e theksit të fjalës dhe mundësitë për rimë të fjalëve të ngjashme morfologjikisht në secilën gjuhë; nga ana tjetër, ato të gjatësisë dhe pozicionit sintaksor që e njëjta pjesë ligjërate ka brenda modelit të fjalisë të secilës gjuhë.

Duket se disa nga fjalët marrin nuanca të ndryshme nga ato që kanë në anglisht, ndoshta të ndikuara nga interpretimi individual i përkthyesit si dhe nga nevoja për të ruajtur theksin e ritmin brenda vargut. Pra në përfundim, SIQ dhe metoda PZM sakrifikojnë një faktor që çon në arritjen e pafundësisë interpretative për të ruajtur një tjetër faktor.

Efekti i PZM në aspektin sintaksor

Analiza e strukturës sintaksore të metodës PZM do të tregojë se SIQ- të paktën kur aplikohet tek përkthimi i poezive që diskutojmë –shpie në krijimin e një hierarkie preokupimesh përkthimore, ku tiparet morfologjike, etimologjike, sintaksore e figurat letrare (tropesh) duket se varen nga konfiguracioni poetik formal. Ne do të fokusohemi tek sintaksa. Kështu për të përkthyer në vargje të “Leaves of Grass” do të duhet të bëjmë një ri-renditje sintaksore të vargjeve origjinale.

Vargjet në anglisht ndjekin strukturën sintaksore: “kryefjala+kallëzuesi+kundrinori”, kurse në gjuhën shqipe ajo bëhet: “kallëzuësi+kundrinori” diktuar kjo nga rregullat e gjuhës shqipe. E njëjta mund të thuhet edhe për përkthimin e gerhudit në gjuhën shqipe, dhe ndryshimet sintaksore që ajo sjell, sikurse janë ilustruar në pjesë të tjera të punimit.

Me fjalë të tjera, pikënisja e vargut, korniza ku duhet kuptuar vargu pasardhës - është zhvendosur duke bërë që lexuesi i versionit të përkthyer të poezisë ta interpretojë mesazhin e saj nga një tjetër këndvështrim (Halliday, 1985). Megjithëse është e tipit funksional, kjo vërejtje përputhet me konceptin dekonstruktiv të “kuptimit si efekt tekstual”. Ideja e qarkimit interpretative- dhe për rrjedhojë një ripërpunim interpretativ duke u nisur nga një këndvështrim i KK₂- shfaqet serisht këtu, sepse roli sintaksor i frazave në një poezi gjithashtu luan rol në krijimin e pafundësisë interpretative të KK₁. Mund të kuptohet se përkthyesi konsideron si më të rëndësishme ruajtjen e formës në varg të lirë sesa ruajtjen e shpërndarjes sintaksore të frazave përbërëse. Riformulim sintaksor vërejmë edhe në vargjet e mëposhtme:

Duke konsideruar prioritetet në përkthim, përkthyesi duhet të vendosë nëse do të ruajë njërin apo tjetrin element, çka përbën një tjetër provë që reflekton paradoksin qendror në SIQ dhe metodën PZM të saj: çdo përpjekje për të ruajtur pafundësinë interpretative do të thotë në mënyrë të padiskutueshme “qarkim të pafundësisë interpretative”.

Efekti i PZM mbi tropet (figurat letrare).

Mënyra se si trajtohen tropet gjatë procesit të përkthimit kur aplikohet metoda PZM kushtëzohet edhe nga përsëritja e konfiguracionit formal poetik. Përgjithësisht, mund të thuhet se disa trope ose figura

letrare lejojnë një zëvendësim më të drejtpërdrejtë sesa të tjerat, në varësi të tipit të mekanizmit gjuhësor nëpërmjet të cilit ato përfaqësojnë një përdorim figurativ apo jo-direkt të gjuhës. Më parë treguam se sintaksa priret të pësojë ndryshime të mëdha gjatë procesit të përkthimit, së paku kur ndjek hierarkinë e prokupimeve përkthimore të përdorura në përkthimin e poezive. Për pasojë, tropet që mbështeten mbi renditjen sintaksore të fjalëve, padyshim që do të modifikohen në versionin e përkthyer të poezisë.

Tropet semantike si: personifikimi, oksimoroni, metafora, hiperbola, nuk sjellin shumë ndryshime në SIQ, çka favorizon riprodhimin fjalë për fjalë të tyre si dhe rrjedhimisht elementin e huaj të KK2. Tropet fonologjike rrallëherë riprodhohen pa sakrificë, pa sakrifikuar interpretimet e veçanta dhe pa shpërbërjen e fjalëve, sikurse kemi parë tek *Bini! Bini! Daulle!* Tropet fonologjike janë më të ndërlikuarat në metodën e PZM, veçanërisht kur hierarkia e preokupimeve të përkthyesit e vendos theksin si tek aspektet poetike formale ashtu edhe tek tropet semantike.

Përfundime

Sikurse u shpjegua më lart, *Dekonstruksioni* cilësohet si një mënyrë shumë e veçantë e të kuptuarit dhe të filozofuarit, premisat teorike të së cilës marrin vlera në të gjitha disiplinat, duke përfshirë edhe përkthimin. SIQ atëhere duhet kuptuar si një skemë përkthimore që duke u bazuar mbi teorinë dekonstruktive, e konsideron kuptimin si efekt tekstual dhe madje edhe pas kalimit ndërgjuhësor pafundësia e efekteve tekstuale të një poezise origjinale dhe përkthimit që i korrespondon mund të përputhen në rreze të gjërë apo të ngushtë. Për më tepër, metoda PZM e SIQ, përpiqet të rritë ndërgjegjësimin e përkthyesit për kontrollin që duhet të ketë mbi shkallën e qarkimit të pafundësisë interpretative gjatë procesit të të përkthyerit. Duke qenë se poezia mbështetet në shumë mjete kuptim-krijuese (secila prej të cilave në një mënyrë a në një tjetër lidhet me nocionet e Derrida-s (Derrida, 1972 b/1981). “të gjurmës” dhe “diferencës”) përkthyesi që përdor SIQ përballet me nevojën për të vendosur një hierarki të preokupimeve përkthimore, dhe do të manifestojë prioritetet në dhënie e interpretimeve në një projekt të caktuar përkthimi. Në të njëjtën kohë, kjo hierarki përmban edhe idenë e sakrificës, duke qenë se ruajtja e tipareve tekstuale që shpie në një pafundësi efektsh kuptimore, shumë shpesh do të çojë në humbje të efekteve kuptimore tekstuale diku tjetër (në një nivel tjetër).

Së fundmi, mund të konkludojmë se në të gjitha rastet, një përkthim ku përdoret SIQ dhe metoda PZM, do të ruajë elementin e huaj, ose për të përdorur termin e Venuti-it (Venuti, 2004), “tëhujëzimi”. Sikurse theksuam edhe më lart, kjo veçanti e SIQ, të shpie në pasurimin reciprok të KK1 e KK2. Do të mbetet në dorën e përkthyesve dhe lexuesve të versionit të përkthyer të gjykojnë nëse SIQ përbën një mjet përkthimi efikas, të dëshirueshëm, apo të dobishëm nga ana procedurale për të bërë hartën e metodave dhe hapave që duhen ndërmarrë gjatë procesit të përkthimit të poezisë.

Bibliografi

- Derrida, Jacques 1967/1978. *L'Écriture et la différence*. Paris: Editions de Seuil; tr. Alan Bass as *Writing and Difference*. University of Chicago Press:226-227
- Davis, Kathleen. 2001. *Deconstruction and translation*. Manchester: St. Jerome.
- Eco, Umberto. *Të thuash gati të njëjtën gjë*. Përvoja përkthimi. Përkth. M. Ymeri, A. Ylli, Dituria, Tiranë. 2006
- Halliday, M.A.K. 1985. *An introduction to functional Grammar*. Great Britain; Edward Arnold.
- Venuti, Lawrence. 2004. *The translator's invisibility*. Shanghai Foreign Language Education Press.

Anna Maria Vasili, Kandidat Doktorant

Universiteti i Tiranës

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

Departamenti i Gjuhës Angleze

anna.maria@unitir.edu.al

Titulli: Përkthimi nga një këndvështrim kulturor

Abstrakt

Në kuadër të globalizimit, po theksohet gjithnjë e më tepër rëndësia e përkthimit dhe e komunikimit ndërkulturor. Përkthimi është jo vetëm procesi i transmetimit të informacionit nga një gjuhë në një tjetër, por edhe mjet i rëndësishëm për komunikim midis kulturave të ndryshme. Për të siguruar transmetimin e saktë të informacionit, në përkthim duhen marrë parasysh edhe dallimet midis kulturave të ndryshme. Vëmendja e shtuar në rëndësinë e kulturës në përkthim e shpreh përkthyesin jo thjesht si transferues fjalësh apo fjalish, por edhe si ndërmjetës kulturor. Saktësia e përkthimit në komunikimin ndërkulturor është një element parësor në shkëmbimin e mesazheve midis dy ose më shumë kulturave. Komunikimi ndërmjet kulturave të ndryshme është një mënyrë e mirë për të nxitur zhvillimin e përkthimit. Përkthimi kërkon jo vetëm përkushtim e vëmendje, por edhe kulturë të përgjithshme, e si rikrijim, kërkon dhe shumë mjeshtri. Përkthyesit përballen vazhdimisht me problemin e trajtimit të elementëve kulturorë në një tekst burimor dhe si të gjejnë teknikën më të përshtatshme për t'i përcjellë me sukses këto elementë në gjuhën e synuar. Theksoj, se përkthimi nga një gjuhë e cila nuk është gjuha e parë e përkthyesit, dhe arritja e ekuivalencës konceptuale midis gjuhëve është gjithmonë një sfidë.

Fjalë kyçe: komunikim ndërkulturor, përkthim ndërkulturor, gjuha burimore, gjuha e synuar, ndërmjetës kulturor

Përkthimi është aktiviteti që përfshin në mënyrë të pashmangshme të paktën dy gjuhë dhe dy tradita kulturore. Shpeshherë, përkthyesit përballen me problemin e trajtimit të aspekteve kulturore në gjuhën burimore ose tekstin burimor për të gjetur teknikën më të përshtatshme në përcjelljen e këtyre aspekteve në gjuhën e synuar ose tekstin e synuar. Këto probleme mund të ndryshojnë në varësi të hendekut kulturor dhe gjuhësor midis dy ose më shumë gjuhëve. Nga këndvështrimi i komunikimit ndërkulturor, përkthimi është produkti kulturor i veprës origjinale së përkthyer. Pra në çdo kuptim, përkthimi është një veprimtari kulturore.

Bota jonë tashmë është kthyer në një fshat global. Dekadat e fundit kanë dëshmuar një zhvillim të jashtëzakonshëm në shkencë dhe teknologji duke bërë që komunikimi ndërkombëtar të bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm. Përkthyesit duhet të jenë në një linjë me kulturën e gjuhës së synuar, në mënyrë që të kenë funksion më të mirë komunikues dhe të arrijnë qëllimin ideal.

Gjatë përkthimit, përkthyesit duhet të njohin kuptimin kulturor të fjalëve të kulturës specifike, përveç kuptimit të tyre parësor, pasi është i ndryshëm shpjegimi i fjalëve të njëjta te njerëzit me kulturë të

ndryshme, për shkak të dallimeve në gjuhë, kulturë, politikë dhe zakone. Për efekt shembulli dhe ilustrimi, këtu mund të përmendim dy ngjyra (Olesen, 2013) të cilat në pjesë të ndryshme të botës kanë kuptime të ndryshme:

Ngjyra e kuqe:

- Në kulturën kineze, përfaqëson mbarësinë dhe gëzimin. Në Kinë, ngjyra e kuqe simbolizon fatin dhe lumturinë (një arsye përse përdoret në restorantet kineze në SHBA). Është gjithashtu ngjyra e Vitit të Ri Kinez;
- Në kulturën perëndimore dhe në Lindjen e Mesme, zakonisht nënkupton rrezik dhe paralajmërim;
- Në vendet e ish-Bllokut të Evropës Lindore, mund të ngjallë ende asociacione me komunizmin.

Ngjyra e verdhë:

- Në Afrikë, simbolizon pasurinë dhe statusin shoqëror;
- Në Lindjen e Mesme, simbolizon zinë;
- Në Egjipt, është një ngjyrë e trishtë;
- Në Japoni, është një ngjyrë mbretërore që lidhet edhe me trimërinë e begatinë;
- Në Tajlandë, simbolika kryesore është fati;
- Në Kinë, kjo ngjyrë shpesh lidhet me pornografinë;
- Në Amerikën e Veriut dhe Evropë, nënkuptohet dielli dhe moti i mirë;
- Në Gjermani dhe Francë është një ngjyrë xhelozie dhe zilie.

Nëse këto dallime kulturore, e shumë të tjera nuk merren parasysh në përkthim, mund të çojnë në keqkuptime apo në mesazhe të papërshtatshme.

Çdo gjuhë ka shumë informacione të nënkuptuara të cilat vendasit mund t'i perceptojnë pa shumë vështirësi. Megjithatë, asnjë marrës i një përkthimi nuk mund të jetë plotësisht i informuar për informacionin bazë në gjuhën burimore, dhe rrjedhimisht të jetë në gjendje të kuptojë dhe vlerësojë mesazhin që njihet vetëm nga konteksti kulturor. Si rezultat, kur një përkthim fjalë për fjalë është i pamjaftueshëm për të shprehur informacionin e fshehur ose funksionin e mesazhit origjinal, një shpjegim është i nevojshëm. Përkthimi nga gjuha në gjuhë është në fakt përkthim nga kultura në kulturë (Bassnett, 1991), ndaj dhe Susan Bassnett beson se përkthimi duhet të bëhet brenda një kuadri kulturor.

Përkthimi si komunikim ndërkulturor, duhet të realizohet si në bazë gjuhësore, ashtu edhe në atë kulturore. Në një leksion "*Mbi metodat e ndryshme të përkthimit*", (Bartscht, Trans.), Friedrich Schleiermacher tha: "ka vetëm dy mënyra përkthimi, ose përkthyesi e lë të qetë autorin sa më shumë që të jetë e mundur dhe e lëviz lexuesin drejt tij; ose e lë lexuesin të qetë sa më shumë që të jetë e mundur dhe e shtyn autorin drejt tij". Ai mendon se një përkthyes duhet të qëndrojë besnik ndaj

originalit dhe të mos e bëjë më të lehtë për lexuesin, pra besnikëria duhet të jetë faktori më i rëndësishëm në një përkthim.

Koncepti i kulturës është thelbësor në përkthim, edhe pse ka mendime të ndryshme nëse gjuha është pjesë e kulturës apo jo, dy konceptet e kulturës dhe gjuhës nuk mund të ndahen. Në vitin 1964, Nida diskutoi për problemet e ngjashmërisë në përkthim (Nida, 1964), duke i dhënë të njëjtën rëndësi dallimeve gjuhësore, si dhe atyre kulturore midis gjuhës burimore dhe gjuhës së synuar. Ai arriti në përfundimin se dallimet midis kulturave mund t'i shkaktojnë përkthyesit vështirësi më të mëdha sesa ndryshimet në strukturën gjuhësore. Sipas tij, nënkuptimet kulturore në përkthim janë shumë të rëndësishme, ashtu sikurse dhe problemet leksikore. Përkufizimi i Nidës për ekuivalencën formale dhe dinamike merr në konsideratë nënkuptimet kulturore në përkthim.

Ekuivalenca formale ndihmon që përkthimi të mbetet sa më afër tekstit origjinal, pa shtuar ide apo mendime të përkthyesit gjatë përkthimit. Forma dhe përmbajtja riprodhohen në mënyrën më besnike të mundshme dhe lexuesi i gjuhës së synuar mund të arrijë të kuptojë zakonet, mënyrën e të menduarit, etj. Problemi me këtë formë përkthimi është se hamendësohet një shkallë e moderuar familjariteti me temën nga lexuesi.

Ndërsa, në ekuivalencën dinamike gjuha origjinale përkthehet "mendim për mendim" dhe jo "fjalë për fjalë", si në ekuivalencën formale. Ekuivalenca dinamike përfshin marrjen e çdo fjalie ose mendimi nga teksti origjinal dhe përkthimin e saj në një fjali të gjuhës së synuar që përcjell të njëjtin kuptim, por nuk përdor domosdoshmërisht fjalët ose shprehjet e sakta të origjinalit.

Pra, përmirëson lexueshmërinë duke riformuluar fjali që mund të jenë konfuze kur përkthehen fjalë për fjalë, por që ruajnë njëfarë besnikërie ndaj tekstit origjinal në vend që të krijojnë një perifrazim të plotë. Për shkak se ekuivalenca dinamike sakrifikon deri diku besnikërinë ndaj tekstit origjinal për të arritur një përkthim më të natyrshëm, ajo është krijuar për t'u përdorur kur lexueshmëria e përkthimit është më e rëndësishme se sa ruajtja e formulimit origjinal.

Në vitin 1988, Newmark e përkufizoi kulturën (Newmark, 1988) si mënyrë jetese për një komunitet që përdor një gjuhë të caktuar si mjet shprehjeje, që çdo grup gjuhësor të ketë veçoritë e veta specifike kulturore.

Gjithashtu, Newmark propozoi dy metoda të kundërta: transferimin dhe analizën përbërëse. Sipas tij, transferimi jep "ngjyrë lokale", duke mbajtur emra dhe koncepte kulturore. Edhe pse duke e vënë theksin te kultura, ai pohoi se kjo metodë mund të shkaktojë probleme për lexuesit në përgjithësi dhe të kufizojë të kuptuarit e disa aspekteve. Rëndësia e procesit të përkthimit në komunikim e shtyu Newmark-un të propozonte analizën përbërëse të cilën ai e përshkroi si procedurën më të saktë të përkthimit, e cila tejkalon kulturën dhe nxjerr në pah mesazhin. Disa strategji të prezantuara nga Newmark të cilat mund të tejkalojnë hendeqet kulturore janë:

- *Transferimi* është procesi i transferimit të një fjale të gjuhës burimore në një tekst të gjuhës së synuar, duke përfshirë transliterimin. Shembull:

Anglisht	Shqip
The Times	Tajms
The Courier	Kurier

- Ekuivalenti kulturor* është zëvendësimi i një fjale kulturore në gjuhën burimore me një fjalë tjetër në gjuhën e synuar. Shembull:

Anglisht	Shqip
- ‘Why, if he came only to be silent, grave, and indifferent,’ said she, ‘did he come at all?’ (Austen, 1995)	- “Në kishte ndër mend të rrinte serioz e indiferent si gur varri, pse erdhi?” – e pyeste ajo veten. (Karafili-Steiner, 2007)
- Once or twice, she could discern a faint blush; but in general Charlotte wisely did not hear.	- Tek-tuk edhe i kapi syri ndonjë skuqje të lehtë, por në përgjithësi Sharlota tregohej e zgjuar dhe e bënte një sy qorr e një vesh shurdh.

- Modulimi* ndryshon formën e tekstit duke prezantuar një ndryshim ose këndvështrim semantik. Shembull:

Anglisht	Shqip
- My nice friends will not hear of my returning home till I am better.	- Miqtë e mi të dashur nuk duan të më lënë të kthehem në shtëpi, derisa të marr veten.

- Kompensimi* është humbja e kuptimit në një pjesë të fjalisë kompensohet në një pjesë tjetër. Shembull:

Anglisht	Shqip
- This was invitation enough.	- Kjo përgjigje qe një ftesë e mjaftueshme.

- Perifrazimi* shpjegon me detaje elementët në gjuhën e synuar. Shembull:

Anglisht	Shqip
- To have his errors made public might ruin him forever.	- Po t’i nxjerrim të palarat e së kaluarës, ndoshta e rrënojmë njëherë e përgjithmonë. Ku i dihet?

Në vitin 2004, Nico Wiersema në esenë e tij “*Globalizimi dhe përkthimi*” (Wiersema, 2004) thekson se përdorimi i anglishtes si gjuhë globale është një trend i rëndësishëm në komunikimin botëror. Globalizimi është i lidhur edhe me fushën e Studimeve të Përkthimit. Konteksti shpjegon kulturën dhe adoptimi (jo domosdoshmërisht duke përshtatur) një përzgjedhje fjalësh pasuron tekstin e synuar, e bën atë më ekzotik, e si pasojë edhe më interesant për ata që duan të mësojnë më shumë rreth kulturës në fjalë. Si përfundim, këto fjalë të reja mund të gjejnë rrugën e tyre në fjalorët e gjuhëve të synuara.

Sipas tij, përkthyesi ka tre opsione për përkthimin e elementeve kulturorë:

- Adoptimi i fjalës së huaj pa asnjë shpjegim;
- Adoptimi i fjalës së huaj me shpjegime të gjera;
- Rishkrimi i tekstit për ta bërë atë më të kuptueshëm për audiencën në gjuhën e synuar.

Ai gjithashtu deklaroi se kulturat po afrohen gjithnjë e më shumë dhe kjo është diçka që ai beson se përkthyesit duhet ta kenë parasysh. Sipas mendimit të tij duke hyrë në elemente kulturore të gjuhës së tekstit burimor:

- Teksti do të lexohet më rrjedhshëm (pa ndalesa);
- Teksti mbetet më ekzotik, më i huaj;
Ekonomisti Xh. K. Galbreith e ka përshkruar mërgimin si “veprimin më të lashtë kundër skamjes” (Galbraith, 1979, f. 7). Skamja përbën një nga faktorët kryesorë që i detyron njerëzit të largohen nga vendi i tyre. Me shpresën se do të gjejnë diçka më të mirë, shumë marrin udhën e mërgimit pa e ditur ç’i pret dhe realiteti ka treguar se jeta si emigrant është e mbushur me lloj-lloj të papriturash. Fillimisht, ata që emigrojnë gjenden në një ambient të ri, përballen me shokun kulturor e me vështirësitë e një gjuhe të huaj. Më pas, vijnë vetmia, paragjykimet, veçimi dhe malli për çfarë është lënë pas. Por, nuk mbaron me kaq. Si pasojë e ndarjes, fëmijët ftohen me prindërit dhe mungesa e dashurisë mund të lërë vraga aq të thella sa mbase nuk do të shërohen kurrë. Edhe kur fëmijët merren me vete, të fillosh nga e para në një vend të ri nuk është aspak e lehtë. Megjithatë, njerëzit vazhdojnë të shpresojnë se jeta diku tjetër mund të jetë më e mirë, se mundësitë mund të jenë më të shumta.

Tema e emigrimit në *Dritë e zbehtë mbi kodra*

Në kohën kur rrëfen ngjarjet, Ecukoja, personazhi kryesor i romanit, jeton në Angli. Arsyet e largimit nga vendi i saj nuk thuhet, gjithsesi historia e Saçikos hedh dritë mbi të pathënat e saj. Asaj i kujtohet kur një ditë kjo e fundit i tha:

“—Ja pra, Etsuko [...] së shpejti, kam për të ikur nga Japonia. Nuk më dukesh edhe aq e befusuar.

—Jam e befusuar që ç’ke me të. Madje më vjen shumë mirë nëse kjo është pikërisht ajo që kërkoje. Po nuk mendon se mund të hasësh... ndonjë vështirësi?

—Vështirësi?

—Dua të them... do të shkosh në një vend tjetër, me tjetër gjuhë e zakone të panjohura.

—E kuptoj merakun tënd, Etsuko. Po, sinqerisht, nuk mendoj se ka arsye për t’u trembur. Kam dëgjuar të flitet kaq shumë për Amerikën, saqë tanimë nuk më duket vend plotësisht i huaj.” (Ishiguro, 1982/2021, f. 50)

Saçikoja do që të shkojë në Amerikë sepse Japonia e pasluftës së dytë botërore nuk ka çfarë t’i ofrojë. Pamjet e zymta të rrënojave, kujtimet e freskëta të humbjes së njerëzve të dashur dhe traumat e lëna nga përbindëshi luftë të përndjekin ngado. Saçikoja sjell ndër mend bombardimet në Tokio, si jetuan nëpër tunele a shtëpi të rrënuara dhe përreth të zinte syri veç gërmadha. I kujtohet një grua që vrau veten pasi kishte mbytur foshnjën në lumë, skenë që e pa edhe Marikoja dhe s’i shqitet nga mendja. Nëpër gazeta gjëmonin lajmet për vrasjet e fëmijëve që po alarmonin Nagasakin. Në fillim një djalë, pastaj një vajzë e vogël qenë gjetur të rrahur për vdekje, një viktimë e tretë që ishte një tjetër vajzë e vogël u gjet e varur në pemë. Zonja Fuxhivara, e njohura e Ecukos dhe punëdhënësjja e Saçikos, ka humbur të shoqin dhe pesë fëmijë në luftë; Ecukoja të dashurin dhe familjen; Saçikoja ka humbur të shoqin. “Çdokush në rrëfimin e Ecukos është prekur, në një mënyrë a një tjetër, nga tragjedia e luftës a e Bombës [...]” (Baillie & Matthews, 2009, f. 47) Ndaj, për të shpëtuar nga makthi i luftës, më mirë të marrësh arratinë.

Në kujtimet e saj, Ecukoja kthehet pas në verën e vitit 1952, kohë kur është shtatzënë me Keikon dhe jeton në Nagasaki. Duke qenë se e ka fëmijën e parë, Ecukon e mbërthen frika nëse do të jetë nënë e mirë për vajzën e saj. Në atë kohë njeh Saçikon që ka një vajzë dhjetëvjeçare, Marikon, dhe që, sipas rrëfimit të Ecukos, e lë pas dore të bijën ngaqë rend pas të dashurit të saj amerikan, Frenkut. Shpeshherë Marikoja ngelet vetëm, ose nën kujdesin e Ecukos kur e ëma i kërkon të kujdeset për të. Nga çfarë i thotë Saçikoja, Ecukoja mëson se Frenku është kryekëput moskokëçarës dhe i papërgjegjshëm, se i lë paratë klubeve dhe pi pa hesap. Sido që Saçikoja i di mirë të gjitha këto, prapë vendos të emigrojë me të në Amerikë, me shpresën se Frenku nuk do ta lërë në baltë kësaj here dhe se do ta heqë nga kushtet e fëlliqura ku jeton. Nga fjalët që i thotë Ecukos, duket mjaft e bindur se ka marrë vendimin e duhur:

“Nuk e ke idenë sa e çliruar do të ndihem kur të largohem nga ky vend i shpëlarë [...] E kuptoj shumë mirë çfarë po mendon, Etsuko. Po të siguroj që e ke gabim. S’ka për të më lënë në mes të katër udhëve kësaj here. Do të jetë këtu nesër me makinën e vet, që në mëngjes herët. Nuk po gëzohesh për mua?” (Ishiguro, 1982/2021, f. 200) [...] “Edhe Marikoja do të jetë e lumtur atje. Është shumë më mirë për një vajzë të rritet në Amerikë sesa në Japoni. Do të ketë mundësi të bëjë çfarë të dojë në jetë. Mund

të bëhet afariste. Këto gjëra janë më të lehta për t’u realizuar në Amerikë, Etsuko. Japonia nuk është vend për një vajzë. E ç’mund të presë nga jeta Marikoja këtu?” (Ishiguro, 1982/2021, f. 208)

Saçikoja e ka provuar në kurriz se jeta si grua në Japoni është tejet ndrydhëse. Sipas mentalitetit të ngurtë patriarkal, gruaja e ka vendin brenda mureve të shtëpisë: t’i shërbejë burrit, të rritë fëmijët, të bëjë punët e shtëpisë, të jetë e nënshtruar dhe kaq. Ëndrrat për një arsimim të mirë, një punë prestigjioze dhe një karrierë mund t’i ëndërrojnë vetëm burrat dhe prindërit mund të krenohen veç me ta. Gratë jo vetëm që nuk inkurajohen, por edhe përfliten nga shoqëria po qe se nuk përmbushin rolin që u është dhënë. Ky mentalitet mbytës e shtypës, në mënyrë ironike, pasqyrohet në fjalët e kushërirës së Saçikos, Jasuko-sanit, se “nuk është mirë për një grua të jetojë pa drejtimin e një burri.” (Ishiguro, 1982/2021, f. 197) Saçikoja s’kishte rrugë tjetër por të jetonte nën drejtimin e të shoqit, më mirë të themi, nën hijen dhe tekat e të shoqit kur ai ishte gjallë. S’mund të mësonte anglisht dhe të gjithë librat e anglishtes iu hoqën me forcë. Kjo sepse i shoqi ishte “shumë i rreptë e shumë patriot”. (Ishiguro, 1982/2021, f. 132) Ëndrrat e Saçikos ishin të destinuara të kyçeshin në sirtar për aq kohë sa shtrinte kthetrat shoqëria patriarkale. Kjo ide përforcohet edhe nga një incident tjetër në roman. Zhiroja, burri i Ecukos asokohe, tregon për një kolegun e vet, Hanadën, që thotë se do ta rrahë të shoqen me shkop golfi po nuk iu bind të votojë për partinë që përkrah ai. Megjithatë, duket se gjërat po ndryshojnë disi edhe në Japoni dhe ajo gradualisht po përqafton normat e Perëndimit.

Në vorbullën e kësaj klime ndryshimesh, vjen mundësia që Saçikoja të shpëtojë nga Japonia ‘e shpëlarë’. Përpos gjithçkaje, ajo gjithmonë ka pasur shpirt të lirë, madje që e re ka ëndërruar të shkonte në Amerikë për t’u bërë aktore filmash. Atje do të ketë mundësi të mira edhe për vajzën e saj. Por, Marikoja nuk mendon si e ëma. Ajo nuk e honeps Frenkun, gjë që duket nga fakti se e quan “derr i fëlliqur” (Ishiguro, 1982/2021, f. 102), aq më tepër ta ketë për baba, të jetojë me të nën të njëjtën çati dhe në një ambient krejt të ri. Një fëmijë i traumatizuar si Marikoja që, një më dy, i fanitet gruaja që mbyti foshnjën e vet në lumë dhe, përpos kësaj, “shfaq sjellje anti-sociale dhe mbyllje në vetvete në një shkallë alarmuese” (Shaffer, 1998, f. 18) do të ndihej e huaj në vendin e saj, e jo më në dhë të huaj. Megjithatë, Saçikoja duket e verbër ndaj këtij realiteti. Ajo do që të shkojë në Amerikë dhe s’ka gjë që t’ia prishë mendjen.

Fundi i tyre nuk thuhet, por ajo që del në pah nga linja kryesore e rrëfimit është se jeta e Saçikos dhe e Marikos ngjajnë shumë me atë të Ecukos dhe të Keikos. Pajtohem me mendimin e kritikut Uai-çu Sim, i cili shprehet se “në retrospektivë, kuptojmë që rrëfimi i Ecukos ka qenë gjatë gjithë kohës për veten e saj”. (Sim, 2010, f. 31) Ecukoja dhe Saçikoja kanë përjetuar të njëjtat gjëra në jetë. Të dyja kanë humbur njerëzit e familjes në luftë dhe pasi ngelin fillikat, të dyja strehohen nga mirëbërës; në rastin e Saçikos nga xhaxhai dhe në rastin e Ecukos nga Ogata-sani që më pas e merr nuse për djalin e tij, Zhiron, dhe kështu ajo bëhet “nuse lufte”. (Akiyoshi, 2020) Pra, të dyja kanë vuajtur pasojat e luftës dhe të dyja kanë pasur martesë të palumtura. Siç u përmend më lart, Saçikos i mungonte liria që të përmbushte ëndrrat e saj për të pasur një karrierë e për të qenë e pavarur dhe e njëjta gjë shihet edhe tek Ecukoja. Sado që hiqet e lumtur me Zhiron në sy të të tjerëve, realiteti tregon se Zhiroja është një tjetër rast tipik i një burri neglizhent. Ai kalon aq kohë me të shoqen sa për të ngrënë vaktin e mëngjesit ndërkohë që lexon gazetën, dhe, atëherë kur rri në shtëpi, fton kolegë të punës dhe sillet si padron me Ecukon duke i dhënë urdhra që t’u bëjë respektin, vetë i ulur për shtatë palë qejfe. Kuptohet çfarë bashkëshorti mund të jetë edhe nga ajo që thonë vartësit për të: “I kemi vënë nofkën

‘Faraoni’ birit tuaj, pasi ne të tjerëve na detyron të punojmë si skllëvër, kurse vetë nuk luan as gishtin.” (Ishiguro, 1982/2021, f.72-73) Ecukoja ndrydhet deri në atë pikë sa harron çfarë dëshirash ka pasur, madje që ka pasur edhe një pasion: violinën. Nuk mund ta jetojë jetën si do të donte nën tutelën e një bashkëshorti që ‘e bullizon të shoqen’. (Shaffer, 1998, f. 13)

Edhe fëmijët e Ecukos dhe Saçikos kanë gjëra të përbashkëta. Marikoja dhe Keikoja kanë natyra të vështira dhe rebele, nuk u pëlqen të shoqërohen me të tjerët, por në të njëjtën kohë janë edhe të brishta. Nëse Saçikoja dhe Marikoja janë pjellë e imagjinatës së Ecukos apo njerëz realë, këtë s’mund ta themi me siguri. Sido që të jetë, ajo që bie në sy është se ato janë *doppelgänger* të Ecukos dhe Keikos. “Saçikoja dhe Marikoja shërbejnë si pasqyrë, madje si kurban, mbi të cilat Ecukoja projekton, ose përmes të cilave kanalizon ankthin për identitetin e saj dhe për veprimet e saj si grua dhe si nënë. Përfundimisht, ato shërbejnë edhe si agjentë që ajo të shkëputet tërësisht nga e shkuara dhe nga roli i saj konvencional në shoqëri.” (Baillie & Matthews, 2009, f. 49)

Kur Saçikoja vjen fillimisht në Nagasaki, një nga fqinjët e përflet duke i thënë tjetrës se e kishte përshëndetur Saçikon, por e sapoardhura i kishte lënë përshtypjen si e ftohtë, e madje mendjemadhe. Por Ecukoja vëren: “Asnjëherë nuk kisha dashur të tregohesha e ftohtë, por duhet ta pranoj që nuk isha munduar fare të jepja tjetër përshtypje. Në atë periudhë të jetës sime nuk doja të përzihesha me askënd.” (Ishiguro, 1982/2021, f. 12) Nga rrëfimi në vetën e tretë për Saçikon, Ecukoja kalon në vetën e parë, duke folur për veten. Pra, bëhet e qartë që Saçikoja është vetë Ecukoja. Në një rast tjetër, Ecukos i kujtohet kur shkoi për shëtitje në Inasa me Saçikon dhe Marikon dhe morën teleferikun për të parë pamjen nga maja e kodrës. Më vonë thotë: “Keikoja qe aq e lumtur. Morëm teleferikun.” (Ishiguro, 1982/2021, f. 223) Kur Marikoja rebelohet ndaj së ëmës ngaqë nuk do të shkojë në Amerikë me Frenkun, Ecukoja i shkon nga pas që t’i mbushë mendjen duke i thënë:

“I ke hyrë shumë në zemër e do të jetë për ty një baba i dytë. Do ta shohësh që gjithçka do të vejë për mbarë, të premtoj. [...] Megjithatë, —vazhdo[i],—nëse nuk të pëlqen atje, mund të kthehemi pas. [...] Po nuk të pëlqeu, do të kthehemi menjëherë. Po të paktën ta provojmë njëherë. Jam e sigurt që do të na pëlqejë.” (Ishiguro, 1982/2021, f. 211)

Edhe pse fillimisht flet për Marikon, Ecukoja përhumbet dhe përfundon duke folur për Keikon. “Kjo shfaqje e Keikos në vend të Marikos na kap në befasi, sepse teksti nuk na përgatit për të.” (Sim, 2010, f. 31) Duke projektuar veten te Saçikoja dhe Keikon te Marikoja, Ecukoja e ka më të lehtë të kthehet në të shkuarën dhe të flasë për disa gjëra që e mendojnë, të përtypë dhimbjen dhe ndjenjat e fajit.

“Në estetikën e teorisë së tij të receptimit, Zhorzh Pule përshkruan një proces gjatë së cilit njerëzit ndahen në dy unë të dallueshëm ndërsa lexojnë ose rilexojnë pjesë të një ngjarjeje domethënëse. [...] Dallimi i Pulesë mes unit që i jeton përvojat dhe unit ‘tjetër’ që i interpreton ato përvoja, siguron një model të dobishëm për të kuptuar rolin e dyzuar të Ecukos në rrëfimin e saj. Në fakt, ajo përbëhet nga dy pjesët që përshkruan Puleja: shkëputja e Ecukos nga uni i angështuar është një përpjekje për të gjetur ngushëllim për unin tjetër.” (Wong, 2005, f. 28)

Siç u përmend në fillim, Ecukoja i rrëfen ngjarjet kur është në Angli. Aty nga viti 1959, ajo rend pas zotit Sheringam, që më pas bëhet burri i saj, duke marrë me vete Keikon shtatë vjeçare. Kështu, lë pas Zhiron, burrin e saj të parë dhe të atin e Keikos, për të filluar një jetë të re dhe për të krijuar një identitet të ri.

A iu plotësuan ëndrrat? U martua me një gazetar anglez që, sipas Ecukos, kishte shkruar artikuj mbresëlënës për Japoninë, por njohuria e tij për këtë vend prekte vetëm majën e ajsbergut. Edhe pse i dha Ecukos një mbiemër të ri, ai kurrë nuk arriti të kuptonte plotësisht zakonet dhe kulturën e saj. Madje, thellë-thellë kishte paragjykime “ndaj racës japoneze sepse ‘edhe pse nuk e thoshte hapur, linte të kuptohej që Keikoja e kishte trashëguar personalitetin nga t’et’”. (Ishiguro, 1982/2021, f.113; Tan, 2023, f. 63) Përpos kësaj, bënte dallime mes Nikit dhe Keikos. Nikin e mbante afër, kurse Keikos nuk i kushtonte vëmendje. Sipas Uai-çu Simit, Nikit dhe Keikos “u është dhënë emfazë e figurshme si metonime për ‘Perëndimin’ dhe ‘Japoninë’”. (Sim, 2010, f. 29) Njëra ishte e shoqërueshme, e pavarur dhe plot dëshirë për jetën, ndërsa tjetra e tërhequr, e palumtur dhe përfundon në vetëvrasje. Zoti Sheringam e lidhte tipin e saj me Japoninë, sikur të ishte Japonia fajtoreshë për temperamentin e saj të vështirë. Në fakt, është e vërtetë që Keikoja mbeti fund e krye japoneze. Ajo nuk u përshtat dot me jetën në Angli e as nuk pati marrëdhënie të mira me njerëz dhe gjysmë-motrën e vet. Ky shembull dëshmon për dëmin që u sjell emigrimi familjeve dhe hendeqet që krijohen kur fëmijët nuk rriten në të njëjtën kulturë. Pa ngrohtësinë e të atit dhe marrëdhënien e fortë me të ëmën dhe gjysmë-motrën, Keikoja nuk e gjeti forcën të përshtatej. Gjërat shkuan aq keq sa ajo u mbyll në vetvete, s’këmbente fjalë me njeri, s’dilte thujse fare nga dhoma, aq sa edhe ushqimin ia linin pas dere. Qëndroi e veçuar nga familja për mbi gjashtë vjet dhe, në një moment, kur jetonte vetëm në Mançester, i dha fund jetës. U gjend vetëm ca ditë më pas dhe gazetat raportuan se ishte japoneze dhe vari veten në dhomën e saj, çka ia shton dhimbjen Ecukos, e cila shprehet se “[a]nglezëve u pëlqen të besojnë që raca jonë ka një instinkt të lindur për vetëvrasje [...]” (Ishiguro, 1982/2021, f. 8)

Me fjalën ‘anglezëve’ nënkuptohet që edhe Ecukoja nuk u bë dot njësh me kulturën e vendit ku vajti. Nuk u integrua për ta quajtur veten angleze dhe jo e huaja mes tyre. Ngjan se ajo vazhdon të jetojë mes paragjykimeve, e vetme dhe tashmë e ve në një fshat të Anglisë dhe, edhe pas kaq vitesh, ajo nuk ka krijuar shoqëri aty. Siç ishte në margjinat e shoqërisë në Japoni, ashtu vazhdon të jetë edhe sot e kësaj dite në Angli. Por tanimë atë e bren edhe faji për vendimin që mori e kjo duket kur i thotë Nikit: “E dija shumë mirë që Keikoja nuk do të qe e lumtur këtu. E prapësepapë, vendosja ta sillja me vete.” (Ishiguro, 1982/2021, f. 215) Tekefundit, “tradita e vjetër japoneze nuk ishte aspak e keqe”, (Ishiguro, 1982/2021, f. 222) ç’arsye kishte për të ikur? Ecukoja e di se, mes shumë keqardhjeve e pengjeve, do ta ndjekë nga pas edhe malli për kulturën dhe vendin e vet.

Përfundim

Siç e pamë në romanin *Dritë e zbehtë mbi kodra*, Ishiguro e trajton emigrimin si një dukuri që shkakton humbje dhe nostalgji. Ecukoja dhe Saçikoja, marrin vendimin të emigrojnë për një jetë më të mirë sepse duan të harrojnë tmerret e luftës, të shpëputen nga një mentalitet patriarkal mbytës e ndrydhës dhe të realizojnë ëndrrat që i kishin mbajtur në sirtar për një kohë të gjatë. Këtë sakrificë e bëjnë edhe për vajzat e tyre, me shpresën se shanset për to do të jenë më të shumta në Perëndim.

Nga ana tjetër, realiteti i emigrimit është mjaft i hidhur. Shpesh, çon në prishje të familjes, si në rastin e Ecukos. Ajo e merr me vete vajzën e saj me mendimin se po i jep mundësi që Nagasaki nuk do t’ia jepte kurrë. Por, harron se kështu po e ndan nga i ati. Për më tepër, përshtatja me vendin e ri mund të mos ndodhë kurrë. Keikoja nuk arrin të përshtatet as me familjen e re, as me vendin e ri, gjë që sjell pasoja tragjike për të. Edhe vetë Ecukoja që shpresonte për një jetë më të mirë, mbetet e vetme, e huaj

në një kulturë që s'u bë kurrë e saja, e përmalluar për vendlindjen dhe e trazuar nga ndjenjat e fajit. Ajo që shohim në romanin *Dritë e zbehtë mbi kodra* pasqyron jetën e shumë emigrantëve sot. Ndaj, vendimi për të emigruar duhet peshuar mirë që të shmangen pasojat.

Bibliografia

- Akiyoshi, S. (2020). How to Employ Nagasaki: Kazuo Ishiguro's *A Pale View of Hills* (1982). *IAFOR Journal of Literature & Librarianship*, 9(2), 69–80. <https://doi.org/10.22492/ijl.9.2.04>.
- Baillie, J., & Matthews, S. (2009). *History, Memory and the Construction of Gender in Kazuo Ishiguro's A Pale View of Hills*. Në Sean Matthews dhe Sebastian Groes (eds.), *Kazuo ishiguro: Contemporary Critical Perspectives*. Continuum International Publishing Group. London-New York.
- Galbraith, J. K. (1979). *The Nature of Mass Poverty*. Cambridge, Mass. : Harvard University Press.
- Ishiguro, K. (2021). *Dritë e zbehtë mbi kodra* (përkth. nga G. Kasemi). Botime Pegi, Tiranë. (Vepra origjinale e botuar më 1982.)
- Sim, W. C. (2010). *Kazuo Ishiguro*. Routledge.
- Shaffer, B. W. (1998) *Understanding Kazuo Ishiguro*, University of South Carolina Press, South Carolina.
- Tan, J. (2023) *Immigration and Emigration in Ishiguro*, *The Cambridge Companion to Kazuo Ishiguro*, ed. Andrew Bennett, Cambridge University Press.
- Wong, C. F. (2005) *Kazuo Ishiguro*, Northcote House Publishers Ltd., United Kingdom.

Dr. Rozana Bela
University of Tirana
Faculty of Foreign Languages
English Department
rozana.bela@unitir.edu.al

Title: Comparative translation from English into Albanian of Episode 10, Wandering Rocks, in Ulysses by James Joyce

Abstract

In this paper we will give a study of Episode 10, ‘‘Wandering Rocks’’ in ‘‘Ulysses’’, by James Joyce. Through comparative translation from English into Albanian of the novel, based on the literary explication, we will answer such questions as ‘‘ How are the logical connections organized?’’, ‘‘How are the logical connections in syntactical systems factorized?’’, and ‘‘ How are the logical connections realized in the form of a text?’’. We will emphasize the nature of: the cognitive meaning and the way it has been expressed; interactive meaning and its expression through the system of states, and the meaning of the discourse and its expression through the system of topics. We will make use of analytical approach and comparative approach. The analytical approach will be realized through the deep and detailed examples provided by the source text and target text, in order to define the translator’s strategies, which have made possible the construction of the translation model. In addition, the comparative method will be used to penetrate the core of the two planes of defects: language texts as a whole, and texts as a reflection of culture. Consequently, we will see the differences between the two linguistic codes (Albanian-English) and the embodiment of their respective cultures.

Keywords: English-Albanian Translation, Ulysses, Episode 10, Wandering Rocks, Translation Procedures

Summary and Analysis of Episode 10 ‘‘Wandering Rocks’’

This episode begins at 2:55 p.m. and ends at 4:00 p.m. It describes the wanderings of several characters from *Ulysses* around the streets of Dublin, and thus it forms a mini-odyssey, a microcosm of Joyce's novel. The chapter consists of 19 short episodes which mirror the overall 18-part structure of *Ulysses* (early critics usually described "The Wandering Rocks" as consisting of 18 parts and a final *coda*, the description of the viceregal cavalcade). Coming as it does after the first nine sections of *Ulysses* (traditionally accepted to be the first "half" of the novel), "The Wandering Rocks" is a kind of interlude — much like the comic entrance of Buck Mulligan during Stephen Dedalus's discussion of Shakespeare in "Scylla and Charybdis" — before Joyce begins the second "half" of the novel.

The chapter is almost perfectly balanced: the meanderings of Father Conmee, S. J., the amiable, patronizing former rector of Clongowes (who once saved Stephen from a painful punishment in *A Portrait*) begin the episode, and the cavalcade of the amiable, patronizing William Humble Ward, Second Earl of Dudley as he travels to open the Mirus Bazaar ends the chapter. The two men represent

Ireland's bondage to two key foreign powers — the Roman Catholic Church and Britain — and all of the smaller odysseys in the episode are directly related to these two major structuring devices. Also, it is in the middle section (the tenth section) of "The Wandering Rocks" that Bloom rents *Sweets of Sin* for Molly. Finally, this near-central chapter of *Ulysses* is tied together by scores of motifs, gestures, thoughts, and cross-references. Joyce apparently wrote "The Wandering Rocks" with a map of Dublin before him, and modern Joyceans take great delight in *timing* the various wanderings of the participants, one critic going so far as to limp along the Dublin streets, miming the one-legged sailor; he discovered that Joyce was unusually accurate in his time sequences.

Parallels with Homer's *Odyssey* are especially clear in this chapter. In Homer, Circe told Odysseus that to return home he must sail either through the large, moving ("wandering") rocks or else he must pass between Scylla and Charybdis. Because only the mythological Jason of the Argonauts had succeeded in negotiating the rocks, Odysseus chose to battle Charybdis, the whirlpool, and Scylla, the six-headed monster.

Joyce's use of contrast is most effective in the fifth section of "The Wandering Rocks." Here, Boylan tells the girl from Thornton's to put a bottle of wine (meant to warm up Molly before his visit) in the bottom of the bag of fruit and to deliver it at once to "an invalid." Not content with the upcoming visit, however, he flirts with the clerk; he looks down into her blouse, and Joyce records for the reader the only unspoken thoughts of Boylan that we are told of in the whole of *Ulysses*: "A young pullet." Yet while the aggressive, sexually indefatigable Boylan contrasts with the sensitive, passive Bloom (who is getting his sexual pleasure vicariously in this section by glancing through pornography), it is Bloom, the "throwaway," who may at last triumph. Joyce makes it clear that Boylan is a mere stud: He reduces everything to sex, and to him women are less than human.

In "The Wandering Rocks," Joyce uses his "false clues" and his ironic contrasts or juxtapositionings to express a human theme, and his art becomes a means of creating a grand Chaucerian pilgrimage. As do many great artists, Joyce accepts people largely as they are, and "The Wandering Rocks" forms his panorama of Dublin's city dwellers with all their warts. The point of view in "The Wandering Rocks" is naturalism tinged with compassion. For example, though Father Conmee may be a bit condescending, he does truly care for people, in particular about those outside of the Catholic faith who may die in "invincible ignorance" and never gain heaven; he may like "cheerful decorum," but he is nonetheless concerned about the plight of the "African mission" and about the dark souls of natives who will never receive "baptism of water . . ." And Father Conmee can only bless the one-legged sailor because, by the rules of his order, he has taken a vow of poverty; he does not have money to spare for the beggar. As another example of Joyce's attitude toward Dubliners, note that in the ninth section, M'Coy's "putdown" of Lenehan is deftly carried out and, because of its understatement, it realistically portrays the reactions of a jokester who fails and his slightly stiff listener.

Joyce, with great artistry, provides the antidote to possible sentimentality by his depiction of Haines, Mulligan, and (later) Master Patrick Dignam, son of the deceased. The priggish Haines has decided that Stephen suffers from a "fixed idea," an obsession; Mulligan plays along with his facile companion, telling him that it was the Church that ruined Stephen's mind with its doctrine of hellfire.

Haines agrees, then ruminates that the ancient Celtic tradition does not admit of an afterlife of punishment. The obnoxious little Patrick Dignam tries as hard as he can to feel some compassion for his dead father, but he can think seriously only that he may get his name in the paper, that he will have a vacation from school, and that he might be lionized by his classmates for a time. And, despite everything, he just cannot get his obstreperous shirt collar to stay down!

Translation procedures, strategies and methods used in translating “Wandering Rocks”

Translation has been used to bring written or spoken SL (source language) texts to equivalent written or spoken TL (target language) texts. One of the major purposes of translation is to transfer and reproduce various religious, literary, scientific, and philosophical texts in another language, making them available to wider readers.

Although translating is an ancient practice, it is only less than thirty years that it has been formally and systematically studied in a non-evaluative way. André Lefevere, a well-known expert in translation, proposed to adopt the expression Translation Studies to refer to the discipline pertaining to the issues of the production and description of translations⁵⁶ in 1978, at a symposium on literature and translation.

However, this does not mean that theories did not exist before this date or that the end products of this practice were not analyzed. They were realized in pedagogic perspective and evaluative perspective.

On the other hand, if language were just a classification for a set of general or universal concepts, it would be easy to translate from a source language to a target language; furthermore, under the circumstances the process of learning a second language would be much easier than it actually is. According to Culler (1976) languages are not nomenclatures and the concepts of one language may differ radically from those of another, since each language articulates or organizes the world differently, and languages do not simply name categories; they articulate their own (Culler, J. 1976: p.21-2). What Culler (1976) writes is that one of the troublesome problems of translation is the disparity among languages. The bigger the gap between the SL and the TL, the more difficult the transfer of message from the former to the latter will be. The difference between an SL text and a TL text and the variation in their cultural background make the process of translating a real challenge.

The translator Ildir Hazizi has made use of technical and organizational procedures while translating ‘Ulysses’ and specifically ‘Wandering Rocks’. As far as technical procedures are concerned, we can mention the following steps as depicted by Nida (1964):

- a. analysis of the source and target languages;
- b. a thorough study of the source language text before making attempts translate it;
- c. Making judgments of the semantic and syntactic approximations. (Nida, 1964: pp.241-45)

⁵⁶ For a history of the discipline: Susan BASSNETT, *Translation Studies*, London, Routledge, 1991.

Undergoing the technical procedures is in a way or another obligatory to any translator as they have to know very well both the source and target languages. A translator must study thoroughly both languages and has to make judgements of the semantic and syntactic approximations otherwise the translation will not bring the message given in the SL to the target reader.

On the other hand, knowing that Ildir Hazizi's translation of James Joyce's "Ulysses" is so far the only version in Albanian we cannot tell for sure how the translator made use of the *organizational procedures* which according to Nida (1964) consist of:

'constant reevaluation of the attempt made; contrasting it with the existing available translations of the same text done by other translators, and checking the text's communicative effectiveness by asking the target language readers to evaluate its accuracy and effectiveness and studying their reactions (pp. 246-47).'

The translator has to have a strategy while translating and as Krings (1986:18) defines translation strategy as "translator's potentially conscious plans for solving concrete translation problems in the framework of a concrete translation task".⁵⁷

Seguinot (1989) believes that there are at least three global strategies employed by the translators: (i) translating without interruption for as long as possible; and in our study has to do with the case of Penelope in Ulysses and typical in translating Joyce's works (ii) correcting surface errors immediately; (iii) leaving the monitoring for qualitative or stylistic errors in the text to the revision stage.⁵⁸

Whereas Loescher (1991:8) defines translation strategy as "a potentially conscious procedure for solving a problem faced in translating a text, or any segment of it."⁵⁹ The notion of consciousness is significant in distinguishing strategies which are used by the learners or translators. And the translator who would translate James Joyce's "Ulysses" has to strongly consider the technique of the stream of consciousness as typical of Joyce's style of writing. In this regard, Cohen (1998:4) asserts that "the element of consciousness is what distinguishes strategies from these processes that are not strategic"⁶⁰.

According to Venuti (1998:240), translation strategies "involve the basic tasks of choosing the foreign text to be translated and developing a method to translate it."⁶¹ In this case he employs the concepts of domesticating and foreignizing to refer to translation strategies of which the translator has made use of while bringing the text to Albanian.

As Newmark would write: "while translation methods relate to whole texts, translation procedures are used for sentences and the smaller units of language" (p.81). It is important to mention that the translator "Ithaca" by using the following methods of translation as depicted by Newmark⁶²:

⁵⁷ Krings, H.P. (1986). Translation problems and translation strategies of advanced German learners of French. In J. House, & S. Blum-Kulka (Eds.), *Interlingual and intercultural communication* (pp. 263-75). Tübingen: Gunter Narr.

⁵⁸ Seguinot, C. (1989). *The translation processes*. Toronto: H.G. Publications.

⁵⁹ Loescher, W. (1991). *Translation performance, translation process and translation strategies*. Tübingen: Gunter Narr.

⁶⁰ Cohen, A.D. (1984). On taking tests: what the students report. *Language testing*, 11 (1). 70-81.

⁶¹ Venuti, L. (1998). Strategies of translation. In M. Baker (Ed.), *Encyclopedia of translation studies* (pp. 240-244). London and New York: Routledge.

⁶² Newmark, P. (1988b). *Approaches to Translation*. Hertfordshire: Prentice Hall

- a. *Word-for-word translation*: in which the SL word order is preserved and the words translated singly by their most common meanings, out of context.
- b. *Literal translation*: in which the SL grammatical constructions are converted to their nearest TL equivalents, but the lexical words are again translated singly, out of context.
- c. *Faithful translation*: it attempts to produce the precise contextual meaning of the original within the constraints of the TL grammatical structures.
- d. *Semantic translation*: which differs from 'faithful translation' only in as far as it must take more account of the aesthetic value of the SL text.
- e. *Adaptation*: which is the freest form of translation, and is used mainly for plays (comedies) and poetry; the themes, characters, plots are usually preserved, the SL culture is converted to the TL culture and the text is rewritten.
- f. *Free translation*: it produces the TL text without the style, form, or content of the original.
- g. *Idiomatic translation*: it reproduces the 'message' of the original but tends to distort nuances of meaning by preferring colloquialisms and idioms where these do not exist in the original.
- h. *Communicative translation*: it attempts to render the exact contextual meaning of the original in such a way that both content and language are readily acceptable and comprehensible to the readership (1988b: 45-47).

In some cases, the omissions occurred in the translations do not make any trouble for the TL reader's comprehension of the ST, and that is why the translator, in case of intentional omission, had not needed to worry about his unfaithfulness to the Source Text. Nevertheless, the act of description may sometimes become paralyzed by the omissions made on the part of the translator. Generally speaking, we cannot see our way clear to claim that all of the omissions have been made intentionally and if so, to claim that we know exactly why the translator has used such procedure in a given situation. Whether or not it is the translator to lay the blame on for this is not known.

Example no. 1.

The superior, the very reverend John Conmee S. J. reset his smooth watch in his interior pocket as he came down the presbytery steps. Five to three. Just nice time to walk to Artane. What was that boy's name again? Dignam. Yes. Vere dignum et iustum est. Brother Swan was the person to see. Mr Cunningham's letter. Yes. Oblige him, if possible. Good practical catholic: useful at mission time.

Shembulli 1.

Kryedekani, së tepërmi reverend Xhon Konmi S.J., e rivendosi sahatin e lëmuar në hepin e brendshëm ndërsa zbriste shkallët e kishës presbiteriane. Kohë e bukur për një shëtitje deri tek Artejini. Si e pati emrin ai djali? Dignam, po. Vere Dignum et iustum est. Vëlla Suani duhet takuar për këtë. Letrën për Zotin Kaningam. Po. Ta detyroj, nëse mundem. Katolik i mbarë: shumë i vlefshëm në ditët e misionit.

Example no. 2

—Pilate! Wy don't you old back that owlin mob?

A zealous man, however. Really he was. And really did great good in his way. Beyond a doubt. He loved Ireland, he said, and he loved the Irish. Of good family too would one think it? Welsh, were they not?

O, lest he forget. That letter to father provincial.

Shembulli nr.2

-Pilat! Pse s'i mba larg ata njers këlthitës? Njeri i zellshëm sidoqoftë. Me të vertet. Dhe vërtet ka bërë të mira sipas mendjes së tij. S'ka pikë dyshimi. Ai e donte Irlandën thoshte, i donte irlandezët. Dhe nga familje e mirë, të shkonte mendja apo jo? Uelsianë më duket.

Example no. 3

Father Conmee sat in a corner of the tramcar, a blue ticket tucked with care in the eye of one plump kid glove, while four shillings, a sixpence and five pennies chuted from his other plump glovepalm into his purse. Passing the ivy church he reflected that the ticket inspector usually made his visit when one had carelessly thrown away the ticket. The solemnity of the occupants of the car seemed to Father Conmee excessive for a journey so short and cheap. Father Conmee liked cheerful decorum.

Shembulli nr. 3. *At Konmi u ul në një kënd të tramit, me biletën e kaltër rrasur me kujdes mes syrit të dorashkës së fryrë me lëkurë keci, ndërsa katër shilingat, një gjashtë pensëshe dhe pesë penitë rrëshkisnin nga pëllëmbëdorashka tjetër e fryrë Brenda kuletës së tij. Duke kaluar para kishës mbushur me shermashekë, ai u kujtua se faturinoja zakonisht vinte atëherë kur nga pakujdesia e hidhje biletën poshtë. Solemniteti i atyre që mbushnin vagonin At Konmit iu duk i tepërt për një udhëtim kaq të shkurtër e aspak të kushtueshëm. At Konmit i pëlqente dekori i gëzuesëm.*

Example no. 4

It was a charming day.

The lychgate of a field showed Father Conmee breadths of cabbages, curtsying to him with ample underleaves. The sky showed him a flock of small white clouds going slowly down the wind. Moutonner, the French said. A just and homely word

Shembulli nr. 4.

Ishte një ditë e magjishme.

Porta e madhe e një fushe i shfaqti at Konmit gjerësi me lakra që e nderuan me gjethet e tyre të mëdha. Qielli i shfaqti një tufë resh të bardha që shkonin ngadalë teposhtë erës. Moutonmer, thotë frëngu. Fjalë e ngrohtë dhe e drejtë.

Example no. 5

Corny Kelleher closed his long daybook and glanced with his drooping eye at a pine coffinlid sentried in a corner. He pulled himself erect, went to it and, spinning it on its axle, viewed its shape and brass

furnishings. Chewing his blade of hay he laid the coffinlid by and came to the doorway. There he tilted his hatbrim to give shade to his eyes and leaned against the doorcase, looking idly out..

Shembulli nr. 5

Korni Kellheri e mbylli librin e gjatë të llogarive dhe uli synë mbi një kapak drupishe arkivoli të vënë roje në një qosh. Drejtoi trupin, shkoi deri atje dhe si e rrotulloi rreth boshtit, shqyrtoi formën dhe xhinglat prej tunxi. Ende duke kafshuar fijen e kashtës, e shtriu kapakun e arkivolit aty ndanë dhe u avit drejt derës. Aty e anoi ca strehën e kapeles t'u bënte hije syve, u mbështët te karkasa e derës duke vështruar jashtë me përtesë.

Conclusions

Generally speaking, we can say that translating Joyce in general is a highly demanding work and the translator Ildir Azizi has completed it successfully. ‘Wandering Rocks’ of Ulysses by James Joyce is a difficult translation to deal with as a translator has to translate without interruption since the whole chapter lacks punctuation marks and traditional sentence structure. In my opinion the lack of punctuation is not done out of purpose by James Joyce as he has ironized with women who would talk, in the case of Molly Bloom think without interruption, but which actually brought the new tendency, the technique of the stream of consciousness. We're taken inside the consciousness of Molly, and to do so is *"to plunge into a flowing river. If we have hitherto been exploring the waste land, here are the refreshing, life-giving waters that alone can renew it"* (Blamires 608).

References

- Albakry, M. (2004). Linguistic and cultural issues in literary translation. Retrieved November 17, 2006 from <http://accurapid.com/journal/29liter.htm>
- Bell, R. T. (1998). Psychological/cognitive approaches. In M. Baker (Ed), *Routledge encyclopedia of translation studies*. London & New York: Routledge.
- Blamires, Harry. *The Bloomsday Book: A Guide through Joyce's Ulysses*. London:
- Cohen, A.D. (1984). On taking tests: what the students report. *Language testing*, 11 (1). 70-81.
- Culler, J. (1976). *Structuralist poetics: structuralism, linguistics, and the study of literature*. Cornell: Cornell University Press.
- Graedler, A.L. (2000). Cultural shock. Retrieved December 6, 2006 from <http://www.hf.uio.no/iba/nettkurs/translation/grammar/top7culture.html>
- Harvey, M. (2003). A beginner's course in legal translation: the case of culture-bound terms. Retrieved April 3, 2007 from <http://www.tradulex.org/Actes2000/harvey.pdf>
- Hervey, S., & Higgins, I. (1992). *Thinking Translation*. London & New York: Routledge.
- Jaaskelainen, R., (2005). Translation studies: what are they? Retrieved November 11, 2006 from <http://www.hum.expertise.workshop>.
- Jaaskelainen, R., (1999). *Tapping the process: an explorative study of cognitive and effective factors involved in translating*. Joensuu: University of Joensuu Publications in Humanities.
- Joyce, James, *Ulysses*, London: Penguin Books, 1992.

- Krings, H.P. (1986). Translation problems and translation strategies of advanced German learners of French. In J. House, & S. Blum-Kulka (Eds.), *Interlingual and intercultural communication* (pp. 263-75). Tübingen: Gunter Narr.
- Lawrence, Karen R., "Style and Narrative in the 'Ithaca' Chapter of Joyce's *Ulysses*", *ELH*, Vol. 47, No. 3. (Autumn, 1980), 559-574.
- Leppihalme, R. (1997). *Culture bumps: an empirical approach to the translation of allusions*. Clevedon: Multilingual Matters.
- Loescher, W. (1991). *Translation performance, translation process and translation strategies*. Tübingen: Gunter Narr.
- Newmark, P. (1988a). *A Textbook of Translation*. Hertfordshire: Prentice Hall.
- Newmark, P. (1988b). *Approaches to Translation*. Hertfordshire: Prentice Hall.
- Newmark, P. (1991). *About Translation: Multilingual Matters*. Clevedon, Philadelphia, Adelaide: Multilingual Matters Ltd.
- Nida, E. A. (1964). *Towards a science of translation, with special reference to principles and procedures involved in Bible translating*. Leiden: Brill.
- Richards, et al (1985). *Longman dictionary of applied linguistics*. UK: Longman.
- Seguinot, C. (1989). *The translation process*. Toronto: H.G. Publications.
- Venuti, L. (1998). Strategies of translation. In M. Baker (Ed.), *Encyclopedia of translation studies* (pp. 240-244). London and New York: Routledge.
- Zhongying, F. (1994). *An applied theory of translation*. Beijing: Foreign Languages Teaching & Research Press.
- Kiberd, Declan (16 June 2009). "[*Ulysses, modernism's most sociable masterpiece*](#)". *The Guardian*. London. Retrieved 28 June 2011.

Dr. Kristina Sheperi

Universiteti i Tiranës,
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja,
Departamenti i Gjuhës Angleze
kristina.sheperi@unitir.edu.al

Titulli: Roli i nënës në dramën e Juxhin O. Nillit dhe Trejsi Letsit

Abstrakt

Dramaturgjia amerikane shumë rrallë e sjell në skenë familjen amerikane si një familje të përsosur. Në fakt, drama si “Udhëtimi i gjatë i ditës për te nata” e Juxhin O. Nillit, apo “Gusht: Portret Familjar” e Trejsi Letsit na sjellin imazhin e një familjeje në kalbëzim e sipër. Një pjesë e mirë e studiuesve kanë përdorur qasjen feministe për të kuptuar zanafillën e problemeve dhe fajësojnë personazhet meshkuj për rrethanat në të cilat ndodhet familja. Për sa i përket rolit të nënës në dramë, O. Nilli dhe Letsi janë kritikuar se i kanë paraqitur nënat si të brishta, të padobishme dhe që ekzistojnë vetëm në funksion të personazheve meshkuj. Megjithatë, një shqyrtim më nga afër i secilës prej dramave, nën një këndvështrim tjetër, do të na bëjë të kuptojmë sesi vendimet apo zgjedhjet e nënës ndikojnë mbi subjektin e vetë dramës dhe anëtarët e familjes. Hulumtimi i lidhjes simbolike midis nënës dhe mjedisit ku ajo vendoset do të hedhë dritë më tej mbi rolin domethënës që secila nënë luan në dramën përkatëse. Edhe pse është filozofia apo këndvështrimi i babait që e ka krijuar sprovën me të cilën përballat secila familje, zgjedhjet e vendimet e Merit dhe Vajëletit janë përgjegjëse në mënyrë të drejtpërdrejtë për situatat që krijohen në familje. Krahas kësaj, nëna do të shërbejë si zëri i së vërtetës për të bijtë, duke iu treguar rrugën e daljes nga shtegu në të cilën ata vetë si prindër nuk mundën të dilnin.

Fjalë kyçe: roli i nënës, zgjedhje, vendime, familja amerikane

Hyrje

Duke qenë se shoqëria amerikane është një shoqëri që vlerëson familjen bërthamë dhe jo familjen e zgjeruar, e gjithë mënyra e jetesës rrotullohet rreth saj. Media, nga ana tjetër, e ka idealizuar familjen si foleja ku të gjithë kthehen kur kanë nevojë për siguri dhe mbështetje. Pra nuk është për t'u habitur pse kontributet më të mëdha të teatrit amerikan kanë në qendër familjen.

“Udhëtimi i gjatë i ditës për te nata” i Juxhin O. Nillit dhe “Gusht: Portret familjar” i Trejsi Letsit janë në vazhden e një sërë dramash amerikane që kanë në qendër familjen. Të dy këta dramaturgë e analizojnë familjen nga afër. Por këto familje janë shumë larg idealizimit që i bën media, në fakt ato e paraqesin familjen në shpërbërje e sipër. Nisur nga ky këndvështrim, natyrshëm lind pyetja: “Çfarë i ka ndodhur kësaj familjeje?”. Tek “Udhëtimi i gjatës i ditës për te nata” (1941), janë sekretet e vjetra

familjare dhe veset që e rrethojnë familjen Tajron në shtëpinë e tyre të mbërthyer nga mjegulla. Ndërsa, te “Gusht: Portret familjar” (2007), ribashkimi i familjes Ueston për zhdukjen dhe më pas vdekjen e patriarkut të tyre shkakton bjerrjen e asaj ç’ka mbetet nga familja në shtëpinë e tyre në Oklahoma. Për t’iu përgjigjur pyetjes se përse këto familje kanë arritur deri këtu, nevojitet një hulumtim i personazheve femra të secilës drame, në veçanti nënave.

Meri Tajron te “Udhëtimi i gjatë i ditës për te nata”

Ashtu si Juxhin O. Nilli konsiderohet babai i dramës amerikane, personazhi i tij Meri Tajron vendos standardet për figurën e nënës në dramën e familjes amerikane.

Shumë studies që kanë analizuar veprën e O. Nillit besojnë se ai nuk i kushton shumë vëmendje heroinës dhe e reduktojnë rolin e Merit në një personazh të nënshtruar dhe të brishtë. En Si Holli, p.sh., argumenton se Meri është thjesht një Madonë e brishtë, qëllimi i së cilës është të personifikojë virtutin për të shpëtuar meshkujt e familjes së saj. (Hall, 37). Po ashtu, Doris Nelson shprehet se personazhet femra të O. Nillit luajnë vetëm rolet e tyre biologjike (Nelson, 4). Lorin Porter mëton se Meri nuk ekziston për qëllimin e saj, por për përfitimin e personazheve meshkuj të cilët janë gjatë gjithë kohës të vëmendshëm se mos Meri i kthehet varësisë së drogës. (Porter, 38, 43-44).

E rritur nga një “nënë strikte” dhe një baba i marrosur pas saj, Meri u arsimua në manastir ku krahas studimeve teologjike dhe akademike, mësoi edhe pianon. E reja Meri që në fillim kërkonte një të ardhme të shndritshme, hyjnore. Fillimisht dëshironte të futej në manastir e të bëhej murgeshë, më pas zgjodhi të bëhej pianiste koncerti, ëndërronte të luante në skena elegante nëpër botë. (O’Neill, 106). Megjithatë, ajo e thyen premtimin kundrejt Zotit kur zgjedh të martohet me aktorin e famshëm Xhejms Tajron. Zgjedhja e saj motivohet nga pamja e tij e bukur dhe nga vëmendja që do të merrte pasi të martohej me të. Kjo është zgjedhja e parë e Merit nga shumë të tjera të cilat kanë çuar në situatën aktuale të familjes.

